



KONFERENCA KOMBETARE
EKZEKUTIMI
I VENDIMEVE GJYQESORE
TE FORMES SE PRERE
NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE
TE INDIVIDEVE

Organizuar nga
AVOKATI I POPULLIT
ne bashkepunim me
KOMITETIN SHQIPTAR TE HELSINKIT
19 Dhjetor 2003





Në fotot:
Nga Zhvillimet e punimeve
të Konferencës Kombëtare

“EKZEKUTIMI I VENDIMEVE
GJYQESORE TE FORMES
SE PRERE NE MBROJTJE
TE TE DREJTAVE TE INDIVIDEVE”.



PERMBAJTJA

1. Fjala e hapjes **Z. Ermir Dobjani**
Avokati i Popullit
2. Fjala e Ministrit te Shtetit,
Z. Blendi Klosi
3. Fjala e Zv.Ministrit te Drejtësisë,
Z. Sokol Hazizi
4. Fjala e Prokurorit te Përgjithshëm
Z. Theodhori Sollaku
5. Fjala e Z. Gjergj Teneqexhiu
Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë se Financave
6. Fjala e Zv.Ministrit te Rendit,
Z. Thoma Jano

KUMTESA

7. Individit, organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe respektimi i të drejtave të tyre. Të dhëna të nxjerra nga monitorimi i kryer nga Avokati Popullit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit,
Znj.Vasilika Hysi Znj.Alma Vokopola
8. Zyra e përmbartimit përballë individit. Problematika dhe perspektiva.
Z. Nasip Naci, Drejtor i Përgjithshëm i Përmbartimit
9. Gjendja dhe rëndësia e ekzekutimit të vendimeve të komisionit të shërbimit civil dhe të atyre gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike, në mbrojtje të të drejtave të individëve
Z.Roland Përmeti, Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil, mbajtur nga Z. Gojard Cerga.
10. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë në konceptin evropian
Z.Ledi Bianku, Qendra Evropiane e të drejtave te njeriut
11. Procedurat bankare për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Praktika dhe nevoja për ndryshime.
Z. Ardian Fullani, Kryetar i Shoqates se Bankierëve të Shqiperisë
12. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.
Znj. Brizida Gjikondi, Institucioni i Avokatit të Popullit
13. Problematikat kryesore gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë
Z.Detar Hysi, Kryetar i Zyrës se Përmbartimit Tiranë



14. Marëdhëniet e zyrës së rregjistrimit të pasurisë me zyrat e përbarimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.
Z. Artan Gjylbegu, Kryerregjistruer i Zyrës së Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme:
15. Problematika e organeve të qeverisjes vendore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.
Znj. Luljeta Nano, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
16. Kodi i Proçedurës Civile, dhe zbatimi i tij nga përbaruesit gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Eksperiencat e Institucionit të Avokatit të Popullit.
Z. Fredi Paskali, Institucioni i Avokatit të Popullit
17. Ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë nga këndvështrimi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit
Z. Njazi Jaho, Jurist, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
18. Roli i policisë së shtetit në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale. Probleme dhe perspektiva
Z. Fadil Canaj, Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit
19. Roli i prokurorisë në ekzekutimin e vendimeve penale dhe në mbikqyrjen e vuajtjes së dënimit.
Z. Kujtim Luli, Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme
20. Eksperiencat dhe ndërhyrjet e Avokatit të Popullit në drejtim të respektimit të të drejtave për të burgosurit
Z. Harallamb Bano, Institucioni i Avokatit të Popullit
21. Ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë në vendet e vuajtjes së dënimit. Probleme dhe Perspektiva.
Z. Arjan Bylykbashi, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve
22. Ekzekutimi i dënimeve plotësuese dhe gjobave nga zyra e përbarimit,
Z. Edmond Ademi, Inspektor i përbarimit në Ministrinë e Drejtësisë

Përfundimet dhe Rekomandimet e Konferencës.



FJALA E AVOKATIT TE POPULLIT,
ERMIR DOBJANI,

NE KONFERENCEN KOMBETARE ME TEME:

“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore
të formës së prerë
në mbrojtje të të drejtave
të individëve”

Të nderuar zotërinj,
Z. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Prokuror i
Përgjithshëm,
Të nderuar zotërinj Ministra,
Të nderuar kolegë, pjesëmarrës në këtë konferencë.

Procesi i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata publike shqiptare, veçanërisht kur prek të drejtat e njohura të individit, krijon një raport që shkon në përpjestim të zhdrejtë me shkallën e besimit të qytetarit tek shteti i tij. Kjo ka qenë një ndër arsyt kryesore pse Institucioni i Avokatit të Popullit, qysh në muajt e parë të veprimtarisë së tij në vitin 2000 e deri sot ka evidentuar mjaft ankesa dhe ka bërë publik faktin se ka qindra vendime gjyqësore, me një fature financiare të konsiderueshme të cilën shteti shqiptar, i përfaqësuar nga institucione qendrore dhe lokale i ka borxh shtetasve të tij. Pavarësisht nga përmirësimet e gjendjes nga viti në vit, mendoni se çfarë goditje shkatërruese i jep kjo dukuri shtetit të së drejtës që ne propagandojmë se po e ndërtojmë.

Ju ftoj t'i marrim gjërat ashtu sikundër është plotësisht e mundshme që ato të zhvillohen brenda realitetit shqiptar. Të gjithë po flasim dhe po dëshmojmë se duam ta ndryshojmë pozitivisht. Mendoni çfarë zhgënjimi ndjejnë ata qindra shtetas shqiptarë dhe familjet e tyre, kur pasi janë sorollatur dyerve të gjykatës disa vjet, derisa kanë marrë në dorë vendimin e saj që ua njeh të drejtën e dëmshpërblimit, pasi paguajnë edhe taksën për shpenzimet e përbarimit, nuk marrin



asgjë, me justifikimin se buxheti nuk ka para! Mendoni situatën që krijohet në kushtet e diskrecionit ende të gjerë të shefave për të emëruar dhe larguar nga puna, personin që ka fituar të drejtën me gjyq për t'u dëmshtëpërblyer e që duhet të rikthehet në të njëjtin vend pune apo detyrë, dhe, përsëri ministri, drejtori apo shefi nuk pranon rivendosjen e së drejtës së shkelur?

Po rastet, kur teksa fëmija pret të takohet me njërin nga prindërit e divorcuar? Jo më fëmija, por edhe një i tretë i rritur që mund të jetë i pranishëm rastësisht, as që e merr vesh se në të veërtetë kush është përmbaruesi, thua se ai është kthyer në polic?

Çfarë ndjesie të ngjallet në rastet kur përmbaruesi vendoset në pozicionin e "sandviçit", teksa në njërën dore mban një vendim gjykate që e detyron të veprojë, ndërsa në doren tjetër, ditën që do të veprojë, i vjen një vendim tjetër gjykate që e ndalon të kryejë veprimin, me arsyetimin e pezullimit të veprimeve përmbarimore, ose i nxirret përpara një shkresë administrative, pa folur pastaj për rastet kur shefi e urdhëron me telefon "të mos paraqitet në punë atë ditë që ka për të zbatuar X vendim", etj.etj. Këtë e vërteton anketimi i lirë i bërë pa identifikim personi, me rreth 100 përmbarues të vendit, nga të cilët rreth 25% janë përgjigjur se kanë ndërhyrje të organeve apo funksionarëve shtetërore në punën e tyre. Po t'i shtosh kësaj shifre edhe 15% që nuk kanë dashur t'i përgjigjen, shifra 40% është alarmante. Në të gjitha këto raste qytetari, i çoroditur nga labirinthi i ligjeve, që në thelb e tyre janë të mira, por që në fakt shpesh herë pengohen të zbatohen nga aktet nënligjore administrative, kupton se ndodhet në gjendjen juridike "zero", pra, sikur të mos kishte ndodhur asnjë proces gjyqësor. Në të gjitha këto raste qytetari shqiptar, i lodhur dhe i fyer, padyshim do të fillojë të humbasë besimin tek institucionet e shtetit të tij, do të ngrëjë zërin e protestës kundër keqpërdorimit të pushtetit nga zyrtarët e ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, do t'i akuzojë dhe etiketojë ata si të paaftë e deri të korruptuar. Dhe në fakt ata kanë të drejtë, sepse 27% e personave të anketuar, të cilët kanë patur punë me përmbaruesit, kanë thënë se përmbaruesit ju kanë kërkuar apo ju kanë paguar para përmbaruesve. Të gjithë ne që jemi të pranishëm e kuptojmë se në këto raste shteti akuzohet për keqadministrim të punëve të tij.

Pikërisht, duke synuar në rritjen e standarteve të mirëadministrimit



nga ana e administratës publike shqiptare, Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit menduan që të organizojnë këtë Konferencë Kombëtare, sepse rezulton se problemi i mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga gjyq-humbësit, institucionet buxhetore, po mbartet nga viti në vit, jo vetëm pa gjetur zgjidhje, por debiti po shtohet si nga vendimet gjyqësore të reja, ashtu edhe ato për pagimin e interesave ose fitimit të munguar. Nga ana tjetër, ka akoma mjaft probleme dhe ankesa edhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale.

Avokati i Popullit gjithmonë ka kërkuar dhe do të kërkojë zbatimin e nenit 143/3 të Kushtetutës si dhe të ligjeve në zbatim të saj sepse asnjë organ apo institucion i administratës publike nuk ka të drejtë dhe nuk duhet të japë porosi apo urdhër për të mos zbatuar vendimet gjyqësore. Vendimet e gjykatave në asnjë rast nuk mund e nuk duhet të bëhen objekt i ndonjë shqyrtimi apo vlerësimi nga asnjë organ tjetër, veçse sipas procedurave gjyqësore nga gjykatat e shkallëve më të larta. Çdo ide apo veprim i përfaqësuesve të pushteteve të tjera, legjislativit apo të ekzekutivit, për të bërë vlerësimin, nëse vendimet e gjykatave janë të drejta apo të padrejta dhe duhen zbatuar ose jo, nuk ka asnjë mbështetje kushtetuese apo justifikim, veçse janë të rrezikshme për shtetin e së drejtës dhe demokracinë. Por në veçanti, këto shfaqje janë të rrezikshme për të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Prandaj, kjo Konferencë Kombëtare, në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, synon të evidentojë:

1. A i njuh siç duhet administrata qendrore dhe lokale, (ku përfshihen dhe përmbauesit gjyqësore, drejtoritë e burgjeve dhe prokuroria) përgjegjësitë e veta ndaj individëve për të zbatuar si duhet dhe në kohë vendimet gjyqësore (civile dhe penale) të formës së prerë?

2. A janë individët të aftë që të njohin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre në lidhje me çfaredo lloj shkelje ligjore ose padrejtesie të kryer kundër tyre në fushën e mësipërme?

Konferenca do të synojë të rrisë ndërgjegjësimin e administratës publike lidhur me detyrimet e saj gjatë kryerjes së funksioneve të njohura me ligj, në zbatim të vendimeve të gjykatave. Në të njëjtën kohë do të nxjerrim në pah nevojat për përmirësimet në ligjet dhe



aktet nënligjore që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Për sa thamë më sipër janë vetëm disa pika ato që do të pasurohen edhe me propozimet e ndryshme që do të dalin nga diskutimet e pjesëmarrësve të tjerë, që janë të mirëpritur të japin kontributin e tyre.

Jo thjesht për t'ua kujtuar pjesëmarrësve në këtë konferencë, por edhe për të afirmuar edhe njëherë vullnetin e Avokatit të Popullit për t'u ndjerë një mekanizëm aktiv në proceset që Shqipëria është e detyruar të kalojë për realizimin e standarteve që parakupton integrimi në strukturat euro-atlantike, më lejoni që fjalën time të hapjes ta mbyll, duke iu referuar Rezolutës Nr. 3 të Konferencës së 24-t të Ministrave Evropiane të Drejtësisë mbi "Vënien në Zbatim të Vendimeve Gjyqësore konform Standarteve Evropiane", të mbajtur në Moskë më 4 dhe 5 tetor 2001. Në të thuhet: "...ekzekutimi siç duhet, efektiv dhe i arrirë i vendimeve gjyqësore është i një rëndësie kapitale për vendet anëtare, në mënyrë që ato të krijojnë, forcojnë dhe zhvillojnë një sistem gjyqësor të fortë dhe të respektuar".

Prandaj bëj thirrje që: - askush, në çfarëdo pozicioni qoftë, nuk mund dhe nuk duhet lejuar që një të drejtë të njohur të individit nga një pushtet jetik dhe i pazëvendësueshëm për ekzistencën e shtetit, sikundër është gjyqësori, ta pengojë me veprimin apo mosveprimin e tij apo të institucionit që përfaqëson dhe të bëjë që të drejtat e ligjshme të individit të bëhen të perealizueshme dhe iluzionare.

Faleminderit dhe punë të mbarë kësaj Konference Kombëtare, e treta që Avokati i Popullit realizon, që nga ekzistenca e tij më pak se katër vjeçare.



FJALA E MINISTRIT TË SHTETIT PRANË KRYEMINISTRIT

Blendi KLOSI

Është kënaqësi të përshëndes në emër të Kryeministrit këtë konferencë dhe organizatorët e saj, Avokatin e Popullit dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Qeveria Shqiptare me kënaqësi konstaton tek Avokati i Popullit një institucion që maturohet me hapa të sigurta në realizimin e misionit të tij, një institucion që gjithmonë e më shumë trajton problemet madhore, të cilat ndesh qytetari në marrëdhëniet me administratën, duke e bërë këtë në një këndvështrim konstruktiv, jo vetëm në trajtën e evidentimit të problemeve, por edhe me angazhime e propozime konkrete për zgjidhjen e tyre, duke marrë kështu rolin e një nxitësi në proceset e mirëqeverisjes dhe garantuesit të të drejtave të qytetarit.

Më lejoni gjithashtu të përsëris në emër të Kryeministrit mbështetjen tërësore për këtë institucion, i cili luan edhe një rol tjetër parësor, atë të afrimit të administratës drejt qytetarit dhe rritjes së besimit të qytetarit në qeverisjen e vendit.

Qëllimi i kësaj konference në të njëjtën kohë përbën edhe një nga objektivat kryesore të Qeverisë Shqiptare, të shprehur qartë në programin e saj politik, ku theksohet angazhimi për përfundimin e ekzekutimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda vitit 2005.

Çështja e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë ka konotacione në fusha të ndryshme, të cilat shtrihen që nga Administrata Publike lidhur me çështjet e mbrojtjes së të drejtave të vetë nëpunësve publikë, forcimin e organeve të zbatimit të ligjit, por dhe forcimi i procedurave administrative dhe buxhetore për të bërë të mundur realizimin e këtyre vendimeve duke e konsideruar zbatimin e tyre si pjesë të finalizimit në procesin e dhënies së drejtësisë.



Pikërisht, realizimi i këtij objektivi kërkon hartimin e politikave të tilla financiare, të mirëkoordinuara dhe të pasqyruara edhe nëpërmjet alokimit në buxhetin e shtetit të fondeve të veçanta, në funksion të implementimit efikas dhe të domosdoshëm nga institucionet përgjegjëse të këtyre vendimeve gjyqësore.

Qeveria Shqiptare ka hedhur hapa konkrete në këtë drejtim. Kështu, në vitin 2002, në funksion të këtij qëllimi janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 173 milionë lekë, në vitin 2003, 150 milionë lekë dhe për vitin 2004 janë parashikuar 250 milionë lekë (vetëm për dëmshpërblimin e pafajsive).

Ekzekutimi i këtyre vendimeve, sigurisht që përfshin edhe punën që bëhet për zbatimin e vendimeve penale në burgjet ose institucionet e tjera edukuese. Për këtë qëllim, këtë vit po realizohet strategjia e përmirësimit të kushteve të të dënuarve me heqje të lirisë në institucionet e riedukimit, siç është për shembull hapja e burgjeve të reja, largimi nga ambientet e paraburgimit në komisariatet e policisë i të dënuarve me vendim të formës së prerë, transferimi i dhomave të izolimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, masa të tjera që do të shpjegohen dhe nga Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

Natyrisht, duke pranuar përpjekjet që ka realizimi i këtyre masave mbi buxhetin e shtetit dhe situatës ekonomike në vend, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se zbatimi i tyre do të jetë një proces konstant dhe i pakthyeshëm.

Qeveria Shqiptare është e hapur dhe e gatshme të mirëpresë e të plotësojë të gjitha rekomandimet e kësaj konference, sepse qëllimi i çdo qeverisje është t'u shërbejë interesave të shtetasve të saj, zëdhënës dhe mbrojtës të të cilave janë edhe organizatorët e ndëruar të këtij takimi, Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.



FJALA E ZËVENDËSMINISTRIT TË DREJTËSISË

SOKOL HAZIZI

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm organizimin e kësaj Konference Kombëtare, ju sjell urimin dhe përshëndetjen personale të Ministrit të Drejtësisë.

Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore është pjesa më kryesore dhe më e rëndësishme e realizimit të së drejtës në një shtet ligjor, që ne pretendojmë të ndërtojmë. Ngrehina e shtetit të së drejtës nuk mund të funksionojë nëse vetë ndërtuesit e saj apo subjektet nuk realizojnë problemin më themelor të përfitimit materialisht të kësaj të drejte dhe të garantimit jo vetëm ligjor, por dhe të mbrojtjes së tyre.

Ministria e Drejtësisë, duke qenë se në brendi organizative dhe funksionale të saj mbart dy drejtime të realizimit material të së drejtës në funksion të zbatimit të ligjit dhe të vendimeve gjyqësore në fushën penale dhe civile, pra përpikmërisht përfaqësuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe të Përmbarrimit, mban përgjegjësi drejtpërdrejt në realizimin në tërësi të respektimit jo vetëm të vendimeve gjyqësore, por dhe të së drejtës në tërësi.

Në formë të përmbledhur dhe jo të mërzitshme, unë do të përpiqem që të citoj në mënyrë jo shumë të detajuar kontributin e Ministrisë sonë në këtë fushë.

Përsa i përket Ekzekutimit të Vendimeve Penale, përveç respektimit të tabelës ligjore në tërësi, pasojë e zbatimit të VKM. Nr./327, datë 15.05.2003 për transferimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, po punohet për zbatimin praktik të tij. Kështu janë përgatitur disa akte nënligjore (edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit), duke përcaktuar detyrimet e secilës prej palëve, si dhe një plan veprimi i përbashkët ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku përcaktohet konkretisht mënyra dhe koha e



kalimit për çdo komisariat, si dhe modalitetet e nevojshme, dhe për t'i dhënë zgjidhje praktike vështirësive apo problemeve të ndryshme që dalin.

Transferimi ka filluar nga data 1 korrik 2003, që do të bëhet gradualisht me faza. Marrja në dorëzim e ambienteve të paraburgimit do të bëhet në mënyrë të veçantë për çdo komisariat, sipas rradhës së marrjes në dorëzim, si dhe masave që duhet të merren dhe modalitetet e kryerjes së këtij dorëzimi, në bashkëpunim ndërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Rendit Publik. Aktualisht ka kaluar në varësinë tonë paraburgimi Vlorë, sipas aktit zyrtar të kalimit të datës 18 gusht 2003.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve do të jetë përgjegjëse për trajtimin e brendshëm dhe shoqërimin e tyre në gjykata, ndërsa regjimi i jashtëm, do të bëhet nga Ministria e Rendit Publik.

Në kuadrin e hapjes së institucioneve të reja, në korrik 2003 përfundoi ndërtimi i Institucionit të vuajtjes së dënimit Peqin; gjithashtu së fundi janë çelur fondet e nevojshme për vënien e tij në funksionim dhe po funksionon. Deri tani ne kemi realizuar tërheqjen e të gjithë të dënuarve nga ambientet e paraburgimit, duke mos harruar se si pasojë e investimit të Komisionit Evropian kanë filluar dhe punimet për rehabilitimin e Burgut të Lezhës, i cili mbaron në mesin e vitit 2004, duke zgjidhur përfundimisht dhe problemin e paraburgimit në tërësi.

Duke ngelur në diskutimin e rëndësishëm të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, dëshiroj të theksoj dhe punën e mirë të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe degëve të saj.

Në zbatim të programit të Qeverisë dhe planit të hartuar me ekspertët e projektit të Bankës Botërore, janë marrë një sërë hapash në drejtim të përmirësimit dhe forcimit të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor në nivel qendror dhe vendor.

Ndryshime pozitive janë arritur në gjashtëmuorin e parë të vitit 2003, krahasuar me vitin 2002 në këto aspekte.

1. Në atë organizativ, nëpërmjet krijimit dhe konsolidimit të strukturave si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë vendor, si dhe të përshkrimit të vendit të punës për to.

2. Në atë administrativ, nëpërmjet urdhërave, udhëzimeve,



orientimeve, shkëmbimit të informacionit dhe funksionimit të mekanizmit të ankesave, largimin, ndryshimin dhe zëvendësimin e punonjësve të paaftë dhe të korruptuar.

3. Në atë procedural, duke bërë njësimin, unifikimin dhe zbatimin e përpiktë të ligjit në shërbimin përmbarrimor, një ndarje të re të punës.

4. Në atë financiar, nëpërmjet përmirësimit të evidencave mbi të ardhurat e realizuara nga Zyra e Përmbarrimit dhe evidencat në lekë të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga Zyrat e Përmbarrimit.

Këto ndryshime janë bërë të mundura në sajë të koordinimit të punës së tre sektorëve përkatës të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, sektorit të Personel-Organizimit, Sektorit të Inspektimit dhe atij të Financë-Administrim-Buxhetit.

Si rezultat i kësaj pune dhe e këtij bashkëveprimi, vihet re një përmirësim i këtij shërbimi në një sërë komponentësh siç janë;

- Miratimi i Strukturës Organike të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.

- Hartimi, miratimi dhe prezantimi i Strategjisë së Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor.

- Unifikimi i praktikave përmbarrimore nëpërmjet formularëve tip me qëllim zbatimin e njëjtë të ligjit.

- Hartimi i Rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor, në plotësim dhe funksion të Ligjit "Mbi organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor".

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore me akte nënligjore, nëpërmjet urdhërave, udhëzimeve dhe projekt-vendimeve të ndryshme të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit.

- Është punuar në drejtim të rritjes së nivelit arsimor, profesional të përmbarruesve gjyqësorë.

- Janë përcaktuar kritere të forta në rekrutimin e përmbarruesve gjyqësorë, duke pranuar përmbarrues ata persona, të cilët kanë mbaruar arsimin juridik, dhe u është dhënë prioritet atyre studentëve që kanë mbaruar fakultetin juridik apo janë trajnuar brenda e jashtë vendit.

Si rrjedhojë e konsolidimit të pjesës profesionale dhe materiale të situatës në Përmbarrim, unë do të citoja dhe disa rezultate të këtij aktiviteti:



Gjatë vitit 2002, përqindja në ekzekutim ka qenë 48% dhe numri i çështjeve të ekzekutuara ka qenë 3700 çështje.

Për 6-mujorin e parë të vitit 2003 janë ekzekutuar 2781 çështje dhe përqindja në ekzekutim ka qenë 52%, ç'ka tregon rritje të ndjeshme të përqindjes në ekzekutim dhe të numrit të çështjeve të ekzekutuara.

Në muajin Maj, janë ngritur dy grupe pune nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, konkretisht në Tiranë, Vlorë dhe u punua në lidhje me çështjet e firmave piramidale të mbartura prej vitit 1999. Si rezultat i kësaj pune janë kryer veprime proceduriale dhe administrative, duke pushuar dhe refuzuar sipas Kodit të Proçedurës Civile, 2358 dosje lidhur me çështjet e firmave piramidale.

Këto çështje kanë qenë të mbartura në vite si rezultat i mosveprimeve të administratorëve të firmave piramidale, të cilët i kanë dërguar për ekzekutim në Zyrat e Përmbarrimit pa identitet të saktë të debitorëve. Nga ana tjetër, këto dosje u mbajtën në ekzekutim të vazhdueshëm nga Zyrat e Përmbarrimit dhe nuk u pushuan sipas 616/d të Kodit të Proçedurës Civile, gjë që tregonte qartë për pamjaftueshmëri profesionale të përmbarruesve gjyqësorë.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme u përgatitën formularë unifikues në lidhje me këto çështje dhe u trajnuan në një seminar 2 (dy) javor përmbarruesit gjyqësorë, të cilët do të merreshin me ekzekutimin e këtyre çështjeve, duke u unifikuar praktika e ndjekur në lidhje me këto çështje.

Në lidhje me ekzekutimin e çështjeve kur Shteti është debitor, Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor ka rritur ndjeshëm numrin e çështjeve në ekzekutim, kjo edhe pas Urdhërit Nr.98 datë 14.07.2003 të Kryeministrit mbi "Ngritjen e grupit të punës për evidentimin e vendimeve gjyqësore, të formës së prerë, me palë institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe për marrjen e masave për fillimin e ekzekutimit të këtyre vendimeve".

Vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2003 janë ekzekutuar tërësisht rreth 300 çështje dhe kanë mbetur për t'u ekzekutuar rreth 360 çështje, janë vendosur 37 gjoba dhe janë bërë 8 kallzime penale në Prokurori për personat që bëhen pengesë në zbatimin e ligjit, si në rastin e vendosjes së gjobës Drejtoreshës së Buxhetit në Ministrinë e Financave, Prefektit të Tiranës, Kryetarit të Bashkisë



së Tiranë, etj.

Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka përcakuar objektivat për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në masën 100% , deri në vitin 2005, për të cilat më hollësisht do të njiheni nga përfaqësuesit e tyre në këtë Konferencë.

Së fundmi, dëshiroj të transmetoj dhe njëherë vlerësimin e lartë që i bën Ministria e Drejtësisë kësaj Konference dhe bashkëpunimin e ngushtë që ka Institucioni ynë me Avokatin e Popullit për realizimin e detyrimit ligjor dhe natyror të së drejtave të njeriut.



FJALA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

Përshëndes dhe falenderoj organizatorët, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, për ftesën dhe iniciativën në organizimin e kësaj Konference Kombëtare, lidhur me ekzekutimin e vendimeve, që përfaqëson fazën përmbyllëse të veprimtarisë së aktorëve të sistemit të drejtësisë.

Në sistemin e drejtësisë penale, ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë dhe i atyre me ekzekutim të menjëhershëm, synon ndëshkimin dhe riedukimin e fajtorëve që kanë kryer vepra penale, rivendosjen e të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të të drejtave të subjekteve juridikë të cënuara nga vepra penale, si dhe në parandalimin e tyre.

Në këndvështrimin institucional, ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë është shumë i rëndësishëm, por dhe problematik, me shqetësimet që evidentohen herë pas here, si në kuadrin ligjor, ashtu dhe në praktikën e organeve të ngarkuara me urdhërimin, vënien në ekzekutim dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ç'ka është evidentuar në monitorimet, analizat dhe raportet e prokurorisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe të organizatave jofitimprurëse në këtë fushë.

Duke vlerësuar rëndësinë veçanërisht të madhe që ka kjo fazë e sistemit të drejtësisë penale, i fokusuar në etapat më të rëndësishme që lidhen me dënimet, ekzekutimin dhe mbikqyrjen e tyre, do të ndalem në disa vlerësime dhe nevoja për përmirësime në të ardhmen:

1. Vlerësoj se legjislati shqiptar në këtë fushë ka pësuar zhvillime dhe përmirësime të vazhdueshme, në përjasje me standartet ndërkombëtare të pranuar, duke iu përgjigjur në dinamikë nevojave dhe kërkesave në rritje për ndryshime dhe reformime në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të vuajtjes së dënimit, si dhe duke synuar garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut



në këtë fazë të rëndësishme të proçedimit penal.

2. Fenomenet e reja të kriminalitetit dhe angazhimet e Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit me BE-në, si dhe praktika gjyqësore në caktimin e dënimeve penale, në ekzekutimin e vendimeve penale dhe në mbikqyrjen e tyre, parashtrojnë nevojën për ndryshime, përmirësime në Kodin Penal, Kodin e Proçedurës Penale, Ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, etj, në përqasjen më të mirë ndërmjet tyre, duke synuar rritjen e efektivitetit të drejtësisë penale në luftën kundër kriminalitetit dhe parandalimin e tij.

3. Në praktikën gjyqësore, vlerësohet se jo në pak raste nuk respektohen kriteret ligjore në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe nuk ka strategji të një politike dënimi të studjuar dhe të unifikuar, si në nivel rrethi gjyqësor, nivel apeli apo dhe në shkallë vendi. Dënimet penale mendoj duhet të orientohen:

- drejt caktimit të llojeve dhe marsheve më të larta për krimet e rënda, si dhe;

- drejt caktimit të llojeve dhe masave më të ulta për kundravajtjet penale dhe krimet jo të rënda.

4. Kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e gjyqtarëve për caktimin e dënimeve alternative të dënimit me burgim dhe të masave edukuese për të miturit, duhet të bazohen në kriteret ligjore dhe të udhëhiqen nga dy parime kryesore, siç janë:

- dënimet gjyqësore duhet të jenë të drejta në mënyrë që të goditet krimi dhe jo shoqëria, si dhe duhet patur parasysh që

- jo vetëm vënia e kriminelëve pas hekurave e ul kriminalitetin në shoqëri.

5. Në praktikën e ekzekutimit të vendimeve penale, vlerësoj të domosdoshëm rritjen e rolit aktiv, veçanërisht të prokurorit, por edhe të aktorëve të tjerë: gjykatës, policisë së shtetit dhe organeve/institucioneve të tjera të ngarkuara me ekzekutimin dhe mbikqyrjen e tij:

- për të respektuar proçedurat dhe urdhëruar ekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, si dhe;

- për të forcuar mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, veçanërisht ato me gjobë dhe me burgim për krimet të rënda me autor në kërkim, me synim:

- për të shmangur këtë kategori personash të dënuar nga



mundësia për të vazhduar veprimtarinë kriminale;

- për të forcur rendin dhe sigurinë për shoqërinë, si dhe;
- për të transferuar në kohë në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe respektuar të drejtat e të dënuarve që ndodhen në paraburgim.

6. Në praktikën e vuajtjes së dënimit me burgim vlerësohet e domosdoshme trajtimi me dinjitet dhe respekt i të burgosurve, në veçanti i grave dhe i të miturve, duke i siguruar dhe garantuar të gjitha të drejtat e tyre dhe veçanërisht mundësinë për të punuar, me synim rehabilitimin dhe përgatitjen graduale të tyre për integrimin e mëvonshëm në shoqëri.

7. Vlerësoj të domosdoshme ngritjen dhe funksionimin e infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e ekzekutimit të alternativave të dënimit me burgim.

8. Për ekzekutimin e masave mjekësore, vlerësohet si detyra parësore për Ministrinë e Shëndetësisë, krijimi i institucionit për të sëmurët psikikë që kanë kryer vepra penale dhe qëndrojnë në sistemin e paraburgimit dhe/ose në spitalin e burgut. Ndërsa, për ekzekutimin e masave edukative, del detyrë për autoritetet shtetërore përkatëse, krijimi i institucionit edukativ të të miturve që kryejnë vepra penale dhe dënohen me masa edukuese. Marrja e këtyre masave, synon në trajtimin më të denjë dhe human të të sëmurëve psikik, si dhe në riedukimin e të miturve, duke i parandaluar nga tendencat për veprimtari të dënueshme.

9. Ritmi i shpejtë i reformës ligjore dhe i ndryshimeve të legjislativës në këtë fushë, shtrojnë nevojën e domosdoshme të trajnimit të aktorëve që ushtrojnë funksionet në këtë fazë, si: gjyqtarë, prokurorë, përmbarues gjyqësorë, oficerë të policisë gjyqësore, personelin e Administratës së Burgjeve, punonjës socialë në këto institucione, etj, për njohjen, kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit, si në praktikën gjyqësore, ashtu dhe në praktikën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të vuajtjes së dënimit. Këto masa synojnë për të shmangur paqartësitë dhe keqinterpretimet në praktikën gjyqësore dhe të ekzekutimit të vendimeve penale, për të rritur efektivitetin parandalues dhe vlerat edukative e humane të dënimit, si dhe për të unifikuar praktikën në këtë fushë.

10. Duke përfunduar, vlerësoj për të nënvizuar se:



- përmirësimi i kuadrit ligjor dhe akteve normative në këtë fushë, si dhe;
- forcimi i kontrollit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mbikqyrja në dinamikë e veprimtarisë së organeve/institucioneve të urdhëruara dhe/ose të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe vënia para përgjegjësisë disiplinore, deri dhe penale e personave që shkelin ligjet në këtë fushë; besoj se do të ndikojë ndjeshëm në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe në rritjen e besimit të komunitetit në sistemin e drejtësisë penale shqiptare.



PROÇEDURA E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE CIVILE ME PALË ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE. PROBLEMATIKA.

Gjergj TENEQEXHIU

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave

Në rradhë të parë, në emër të Ministrisë së Financave, dua të përshëndes Konferencën Kombëtare “Ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të individit”, e cila për vetë problematikën dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të individit merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Me këtë rast dua të uroj dhe të falenderoj Institucionin e Avokatit të Popullit, për organizimin e kësaj Konference dhe si mbrojtës i të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit të cilat preken nga veprimet apo mosveprimet e organeve të Administratës Publike . Gjithashtu, dua të përshëndes edhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit për kontributin e dhënë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të individit, si dhe për bashkë-organizimin e kësaj konference.

Ministria e Financave ka vlerësuar maksimalisht kontributin e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili me këmbëngulje të admirueshme ka ndjekur me sukses çështje dhe problematika që kanë lidhje të ngushta me respektimin e të drejtave të mohuara të individit. Kontributi i tyre në këtë drejtim ka qenë i vazhdueshëm dhe shpesh herë i frutshëm, gjë e cila faktohet në korrespondencat e panumërta dhe rezultateve që janë shkëmbyer midis institucioneve tona.

Problematika e vendimeve të gjyqësorit tonë është e shumëllojtte dhe shpesh herë e ndërlikuar, pasojë edhe e mungesës së akteve ligjore dhe nënligjore. Ajo ndërthuret edhe me efekte të jashtëzakonshme financiare, pasojë e veprimit apo mosveprimit të administratës. Prandaj, mendoj se është e rëndësishme të koordinojmë veprimet midis institucioneve tona, sidomos midis sistemit gjyqësor, Avokatit të Popullit, atij të Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Rendit Publik, asaj të Financës dhe të gjithë aktorët e tjerë.



Edhe konferenca e sotme mendoj se i shërben këtij qëllimi.

Praktika e punës tonë e viteve të fundit tregon se vendimet gjyqësore që prekin buxhetin vijnë në rritje. Këtu natyrshëm lind pyetja. Pse ndodh kjo?

- Mos kemi të bëjmë me veprime jo të mbështetura në ligj të titullarëve dhe administratës?

- Apo kjo ndodh në mungesë koordinimi midis Prokurorive apo Gjykatave!

Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësonte ndjeshëm ambientin e përgjithshëm në favor të respektimit të të drejtave të individit.

Nga pikëpamja e Ministrisë së Financave, problemi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka ndikime të konsiderueshme financiare, pra, ne dyfish ndiejmë përgjegjësinë, pasi çdo veprim apo mosveprim konform ligjit dëmton Arkën e Shtetit. Fondet e përdorura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që prej vitit 1998 (i referohen këtij viti pasi në këtë vit Qeveria miratoi VKM 335 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore) janë qindra milion lekë, të cilat po të ishin përdorur për shpenzime të tilla si investime apo mirëmbajtje, qoftë edhe për politikë pagash, psh në sistemin gjyqësor etj, do të kishin ndikim pozitiv në ekonomi.

Ministria e Financës ka qenë vazhdimisht e angazhuar në drejtim të respektimit të vendimeve të gjyqësorit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë në lehtësimin e zbatimeve të vendimeve të gjykatave. Kjo ministri ndërmori dhe miratoi VKM tashmë të famshme 335. VKM 335 duhet të zbatohet më tej dhe të zgjidhë edhe probleme që deri më sot nuk kanë gjetur zgjidhje. Gjithashtu së bashku me Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjithë "aktorët" e interesuar, duhet të punojmë për rregullimin e akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të gjyqësorit, e për rrjedhojë me respektimin e të drejtave të individit.

VKM 335 e qershorit 1998 ka përcaktuar kritere të qarta që jo gjithmonë e kudo kuptohen apo lexohen drejtë. Në mbështetje të pikës 2 të këtij vendimi, Ministria e Financave ekzekuton vendime gjyqësore që prekin buxhetin e shtetit. Kjo pikë e vendimit ka përcaktuar qartë kompetencat e Ministrisë së Financave për ekzekutimin e fondeve të vëna në dispozicion nga Parlamenti për



çdo vit buxhetor. Ajo zbaton vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me detyrimet e buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet që kanë institucionet buxhetore.

Po ky vendim përcakton detyrimet e institucioneve buxhetore, administrata përkatëse kanë shkaktuar dëme ndaj subjekteve apo individëve dhe këto dëme të vërtetuara nga Gjykata, përballohen nga buxhetet e këtyre institucioneve.

Dy vitet e fundit është vënë re një numër i madh vendimesh gjyqësore që duhen ekzekutuar dhe që prekin Buxhetin e Shtetit, sidomos vendime me objekt për kompesim për burgim të padrejtë.

Ky fakt nga njëra anë tregon se respektimi i të drejtave të individit po shkon në drejtimin e duhur, por nga ana tjetër mendojmë se eliminimi i rasteve të burgimit të padrejtë kërkon forcimin e bashkëpunimit të të gjithë institucioneve përgjegjëse, përfshi Ministria e Rendit Publik, Prokuroria, Gjykata, Ministria e Drejtësisë.

Vendimet gjyqësore për burgim të padrejtë kanë pësuar një rritje jo vetëm nga numri, por dhe nga impakti financiar që ato shkaktojnë në buxhet. Kjo edhe për faktin se është rritur vlera e kompesimit në ditë nga 1 mijë lekë në 5 mijë lekë.

Edhe për vitin 2004 parashikohen që fondet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të arrijnë në 250 milion lekë, duke u rritur në krahasim me vitin 2003 mbi 40 %.

Në vijim të nderuar zonja e zotërinj do të paraqes disa shqetësime lidhur me disa çështje specifike gjyqësore që nuk kanë gjetur zgjidhje deri më sot, për të cilat kërkohet zgjidhje.

Së pari, Ministria e Financave është ballafaquar me vendime gjyqësore që lidhen edhe me fitimin e munguar. Shtrohet pyetja, mbi ç'kritere mbështetet llogaritja e fitimit të munguar?

Programet financiare të subjekteve që paraqiten në organet tatimore nuk kanë asnjë përafrim me shumat e vendimeve gjyqësore të fituara. Interesat që përmbanin vendimet gjyqësore përafrojnë me nivele të skemave piramidale, duke konkuruar kështu edhe bankat.

Akoma vazhdojmë të ballafaqohemi me vendime, të cilat bien ndesh me ligjet në fuqi. Do të përmend problemet e pazgjidhura që kanë të bëjnë me nenin 6 të Ligjit 7698 "Për Kthimin dhe Kompesimin e Pronarëve" apo edhe raste të tjera.



Duhet të jemi të vetëdijshëm se ekzekutimi i këtyre vendimeve ka një ndikim të madh financiar për buxhetin e shtetit. Ne do të sugjerim që për zgjidhjen e këtyre problemeve të funksionojë një grup pune me ekspertë të fushave të ndryshme, me qëllim përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, të cilat për rrjedhojë do të sillnin përmirësimin e klimës dhe mbrojtjen e të drejtave të individit.

Institucionet buxhetore ballafaqohen me vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me shuma të konsiderueshme, të cilat në qoftë se nuk do të merren masat e duhura do të trashëgohen nga viti në vit, duke rënduar programet e tyre buxhetore. Për këtë arsye që përpara ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, titullarët e institucioneve të nxjerrin përgjegjësitë individuale për dëmet e shkaktuara ndaj individit apo subjektit privat.

Në përfundim, duke vlerësuar edhe njëherë rëndësinë e kësaj konference, dua të përgëzoj organizatorët si Institucion i Avokatit të Popullit, me të cilët kemi patur dhe kemi një bashkëpunim tepër të frutshëm, si dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Ministria e Financës shpreh edhe njëherë gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar me të gjithë institucionet e përfshira në gjetjen e zgjidhjeve sa më konkrete e në favor të individit.



FJALA E ZËVENDEËS MINISTRIT TË RENDIT PUBLIK

THOMA JANO

Është nder e kënaqësi e veçantë që në emër të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit, të mar fjalën në këtë veprimtari të rëndësishme të Institucionit të Avokatit të Popullit, institucion, megjithëse i ri dhe pa traditë në vendin tonë, ka krijuar tashmë profilin e tij në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të individëve përballë veprimeve ose mosveprimeve të padrejta të Administratës Shtetërore dhe të organeve të tjera.

Miratimi i Kushtetutës së re dhe ngritja e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të konsiderohen pa mëdyshje si një ndër arritjet më të spikatura në përmirësimin dhe konsolidimin e demokracisë së re shqiptare, në forcimin e shtetit të së drejtës, ku të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nuk duhet të kenë kundërthënie, por të harmonizohen me ato të shtetit dhe të shoqërisë dhe në rast konflikti, të zgjidhen nëpërmjet një procesi gjyqësor, të drejtë, të barabartë dhe transparent.

Në shoqëritë e sotme moderne po vërehet gjithnjë e më tepër tendenca e juridizimit të të gjitha formave e natyrave të marrëdhënieve: pothuaj çdo konflikt e gjen zgjidhjen në gjykatë, duke e bërë drejtësinë dhe gjyqtarin një personazh të dorës së parë.

Në veprimtarinë e Ministrisë së Rendit Publik dhe Policisë së Shtetit nuk mund të përjashtohen edhe raste të cënimeve të drejtave të individëve, qoftë brenda për brenda strukturave të saj, qoftë ndaj të tretëve. Dhe siç përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore, kur individit çmon se nuk e gjen të drejtën e tij në rrugë administrative, i drejtohet gjykatës.

Kështu për vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2003 MRP është ndodhur përpara shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor ndaj subjekteve fizike dhe juridike private në rastet e konflikteve gjyqësore të lindura nga: marrëdhëniet e punës; dëme shkaktuar të tretëve për faj të punonjësve të MRP dhe Policisë së Shtetit, (përgjegjësia e punëdhënësit, sipas nenit 618 të Kodit Civil). Ministria jonë ka kaluar për ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë, në çdo rast



kur në kuptim të nenit 442 të Kodit të Proçedurës Civile, brenda afateve proçeduriale ligjore, ka ezauruar të gjitha mjetet mbrojtëse ndaj vendimeve gjyqësore.

Për këtë arsye, në buxhetin e Ministrisë sonë është parashikuar si zë i veçantë "Shlyerja e detyrimeve të MRP ndaj personave fizikë e juridikë privatë, si detyrime që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë". Por theksojmë se vlera e këtij zëri në buxhetin ministerial është relativisht e vogël dhe e pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve ndaj këtyre personave. Duke patur një vlerë të kufizuar, një pjesë e detyrimeve nuk shlyhen për shkak të mungesës së fondeve, si rrjedhojë, jo të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të kenë ekzekutim të menjëhershëm, duke u mbartur kështu në vitin pasardhës.

Për t'a tejkaluar këtë situatë, Ministria e Rendit Publik, në mbështetje të nenit 21 të Ligjit 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të Administratës Shtetërore", ka depozituar pranë Ministrisë së Financave kërkesën për sigurimin e fondeve buxhetore për detyrimet ndaj personave fizikë e juridikë si zë i veçantë në buxhetin e vitit 2004.

Gjithësesi, thjesht për t'a ilustruar me shifra, nga viti 2000 deri në momentin që po flasim, Ministria e Rendit Publik, në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, u ka likuiduar personave fizikë e juridikë, 132 milionë e 530 mijë lekë të reja. Në këtë aspekt më lejoni të nënvizoj gatishmërinë e natyrshme të Institucionit tonë për të zbatuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, rolin e strukturave të përmbartimit, dhe në mënyrë të veçantë ndikimin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të Komisionerëve të tij.

Për t'a përfunduar, dëshiroj të theksoj se medalja ka dy anë: detyrimin ligjor për të zbatuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, të padiskutueshme nga asnjë instancë apo zyrtar përgjegjës, por edhe domosdoshmëria e minimizimit të rasteve që mund të finalizohen me një konflikt gjyqësor. Kjo e fundit arrihet nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë dhe profesionalizimit të instancave vendimmarrëse, nëpërmjet një veprimtarie profesionale tërësisht të bazuar në ligj dhe me standarte të larta e të paqortueshme etnike, si dhe nëpërmjet transparencës në krijimin, menaxhimin e drejtë dhe ndryshimin e marrëdhënieve të ndryshme juridike me personat fizikë e juridikë.

KONFERENCA KOMBETARE

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYEOSORE TE FORMES SE PRERE
NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE TE INDIVIDIVE



K U M T E S A



INDIVIDU, ORGANET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TYRE

Prof.as.dr. VASILIKA HYSI

Pedagoge e Fakultetit të Drejtësisë

Drejtoreshë ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Me lejoni t'ju shpreh faleminderimet tona për pjesëmarrjen në këtë konferencë dhe për diskutimin e një prej problemeve më të rëndësishme dhe që në të njëjtën kohë ka të bëjë me forcimin e mëtejshëm të shtetit të së drejtës. Zyra e Avokatit të Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit vendosën të bëjnë objekt diskutimi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore duke pasur parasysh sloganin se drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar.

Duke vlerësuar rëndësinë dhe ndikimin që ka funksionimi i sistemit të drejtësisë dhe i hallkave të tjera të tij në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, do të dëshironin të bënim objekt të këtij referati problemet që ekzistojnë në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe vlerësimin e dhenë nga shtetasit që pësojnë dëm nga zvarritjet dhe shkeljet e ligjit gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Në varësi të llojit të vendimit gjyqësor dhe të asaj çfarë përmban ai, ligji ngarkon disa organe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe kontrollin e këtij procesi. Një nga organet e ngarkuara me ligj për ekzekutimin e pjesës më të madhe të vendimeve gjyqësore është shërbimi i përbarimit gjyqësor.

Ligji 8730, datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor" në nenin 4 të tij sanksionon se "...ligjshmëria dhe objektiviteti si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutimin, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor". Dhe neni 5 të po këtij ligji sanksionohet se "...përbaruesi gjyqësor në ushtrimin e veprimtarisë së tij duhet të karakterizohet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi".

Ekzistojnë tregues të ndryshëm për të matur shkallën e zhvillimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi. Pa mohuar rolin që luajnë vetë strukturat kontrolluese dhe drejtuese të shërbimit përbarimor



gjyqësor ose organet të ngarkuara me ligj, ka edhe vlerësues të tjerë, ndër të cilët është edhe publiku.

Në këtë referat do të ndalemi tek publiku, pikërisht te shtetasit që janë në kontakt me këto organe dhe që janë një ndër vlerësuesit e këtij shërbimi. Njohja e opinioneve të tyre përbëjnë një një kontribut në vlerësimin me objektiv të problemeve të ndryshme.

Duke marrë shkas nga ankesat e shumta të shtetasve lidhur me mosekzekutimin e vendimeve si dhe problemet e tjera që lidhen me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në këtë fazë;

Duke vlerësuar faktin se puna e administratës publike, e institucioneve të ndryshme, pra dhe e organeve të drejtësisë nuk është në nivelin e duhur dhe organet e drejtësisë nuk i përgjigjen kërkësive të shoqërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit ndërmorën një studim për të njohur pikërisht problemet që mbart ky shërbim. Studimi u krye në 9 rrethe të vendit¹ dhe për këtë u intervistuan 445. Personat e intervistuar ishin shtetas të cilët kishin kontakte me zyrat e përmbartimit për shkak të çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme ose atyre të ardhura për ekzekutim gjatë vitit 2003.²

Për të vlerësuar objektivisht përfundimet e këtij studimi do të theksonin se ndaj 8.4% të personave të intervistuar ishte dhënë një vendim penal dhe pjesa me e madhe e të intervistuarve të tjerë ishin në pritje të ekzekutimit të vendime civile (58.6%) dhe familjare (20.9%). 68% e të intervistuarve janë meshkuj dhe 32% femra, kryesisht banues në qytet me moshë moshës 30- 50 vjeç (56%) ndër të cilët një pjesë e konsiderueshme me arsim të mesëm ose të lartë.

INDIVIDI DHE SHËRBIMI I PËRMBARIMIT GJYQËSOR

Puna e shërbimit përmbartimor dhe mënyrës së funksionit të saj perceptohet në mënyra të ndryshme nga publiku. Faktorë të ndryshëm ndikojnë në këtë vlerësim si njohuritë e personit rreth këtij shërbimi, marrëdhëniet e tij me këtë shërbim, natyra e çështjes që pret të zgjidhet, mënyra e komunikimit të stafit, profesionalizimi i tij dhe shkalla e informimit të shtetasit nga ana e punonjësit të shërbimit përmbartimor etj.,



Në përgjithësi është konstatuar vështirësi për realizimin e këtij studimi. Një pjesë e njerëzve hezitonin të flisnin në ambjentet e këtij shërbimi ose në prani të përmbauesve. Jo të paktë ishin ata shtetas që mendonin se sado studime të kryen, situata nuk mund të zgjidhet me problemet që mbart shërbimi përmbauesve. E theksojmë këtë, pasi ***mungesa e besimit e publikut tek organet përkatëse*** është një tregues negativ.

Pyetjes sonë se cili është ***mendimi juaj për mënyrën e funksionimit të zyrës së përmbaimit***, vetëm 3.8% pohuan se shërbimi është shumë i mirë, 37.5 % theksojnë se shërbimi është i mirë ndërsa 54.4% e tyre thanë është jo i mirë ose aspak i mirë.

Transparanca në ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe informimi i personit ndaj të cilit është dhënë një vendim në favor të tij janë elementë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në porcesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe mbarëvatjen e punëve në zyrën e përmbaimit. 16.2 % e të intervistuarve mendojnë se zyrat e përmbaimit janë transparente ndërsa 57.84% thonë se janë disa transparente dhe 21.6% aspak transparente.

Pra, sic del edhe nga intervistat, ka një mungesë të theksuar të transparencës dhe informimit të shtetasve për ecurinë e procesit të ekzekutimit të një vendimi, procedurat, tarifën e shërbimit, etj..

Korrupsioni është një ndër problemet e trajtuara në këtë vlerësim. 12.6% e të intervistuarve deklaruan se u është kërkuar para për të ekzekutuar vendimin e dhënë në favor të tyre. Megjithatë, 14.4% pohojnë se kanë paguar para, pasi kjo ose është kërkuar ose ata kanë dhënë vetë para që të mbarojnë punën.

RESPEKTIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAVE TË INDIVIDIT NGA ZYRAT E PËRMBARIMIT

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore ose ekzekutimi i tyre me vonesë çënon rëndë të drejtat e shtetasve. Është domethënë fakti se 86.5 % e të intervistuarve theksuan se gjatë ekzekutimit të vendimeve ka patur ***zvarritjet e të shumta***. Kështu, 69% e të intervistuarve thanë se ekzekutimi i vendimeve zvarritet 1 muaj deri në 1 vit, 22.4% pohuan se kjo zvarritje ishte prej 1-5 vjet dhe 3.9% e personave të intervistuar thanë se kishin mbi 5 vjet dhe vendimi nuk ishte ekzekutuar ende.



Kushtetuta e RSH i njeh të drejtën e personit *të ankohet në rastet e mosrespektimit të ligjit dhe shkeljeve së të drejtave.*

54 % e personave janë ankuar për mosekzekutimin e vendimit ne organet të ndryshme ose në disa organe në të njejtën kohë si tek titullari i institucionit (39.3%), në gjykatë (27.4 %), tek Ministria e Drejtësisë (15.5%). Krahas, këtyre organeve, shtetasit kanë përzgjedhur edhe institucionet ose organizatat e të drejtave të njeriut si Avokatin e Popullit (7.1%) dhe tek Komiteti Shqiptar i Helsinkit (1.8%).

Përbushja e detyrave dhe etika profesionale e punonjësve të këtij sistemi është një element shumë i rëndësishëm në mirëfunktionin i sistemit të drejtësisë. Etika duhet të karakterizojë çdo punonjës të administratës publike. Një ndër treguesit e vlerësimit të këtij raporti është edhe mënyra e trajtimit të ankesave dhe informimi i shtetasve. 75.7% e të intervistuarve kanë mbetur pak të kënaqur ose aspak të kënaqur me mënyrën e trajtimit të ankesës dhe vetëm 21.2% kanë mbetur të kënaqur me mënyrën sesi është trajtuar ankesa e tyre. Ndër arsytet që personat nuk janë të kënaqur janë:

Së pari, problemi i tyre nuk ka gjetur zgjidhje;

Së dyti, personat nuk janë informuar sa duhet rreth mundësive të zgjidhjes së problemit

Së treti, personat nuk janë trajtuar me respekt

Së katërti, personit i është kërkuar shpërblim (7.3 %)

INFORMIMI I SHOQËRISË PËR TË DREJTAT E TIJ

Rritja e aksesit të shoqërisë tek zyra e përmbarimit ka edhe anën tjetër të saj. Krahas përmirësimit të veprimtarisë së zyrës së përmbarimit, rendësi ka edhe shkalla e ndërgjegjësimit të shtetasve dhe informacionit që ato kanë në një fushë të caktuar. Ajo që dëshirojmë të nënvizojmë është se jo të gjithë personat që janë në kontakt me zyrat e përmbarimit njohin procedurat dhe rregullat e ekzekutimit të vendimeve. Kështu, vetëm 37.8% e të intervistuarve pohuan se kishin njohuri për procedurat e vënies në lëvizje të zyrës së përmbarimit. 61% e tyre pohuan se kishin njohuri të mjaftueshme ose nuk kishin fare njohuri. Gjithashtu, 51% e shtetasve që kanë kontakte me zyrën e përmbarimit nuk njohin sa duhet të drejtat e tyre.

Ky fakt na lejon të arrijmë në përfundimin se informimi i shoqërisë



për të drejtat dhe rrugët e realizimit të tyre është i nevojshëm. Shërbimi përbarimor duhet ta vlerësojmë seriozisht këtë çështje.

ÇFARË PRET SHOQËRIA NGA DREJTËSIA?

1. Eliminimi i zvarritjeve dhe ekzekutimeve me vonesë është një ndër kërkesat e theksuara me forcë nga shtetasit. 68% e tyre ose 306 persona theksuan nevojën e shpejtësisë në lidhje me ekzekutimin e vendimive.

2. Shërbimi përbarimor gjyqësor duhet të jetë më transparent dhe të informojë palët për ecurinë e ekzekutimit të vendimit (29.4%).

3. Etika e komunikimit duhet të përmirësohet (10.8%). Kjo kërkon një vemendje më të madhe nga ana e drejtuesve të lartë të këtij shërbimi dhe këshilli përbarimor

4. Lufta kundër shfaqjeve korruptive (15.1%) duhet të jetë një nga drejtimitet e punës së këtij organi. Shmangia e ndërhyrjet nga pala ose nga lart është një kërkesë tjetër e publikut;

5. Njohja dhe zbatimimi i ligjeve është një kërkesë tjetër e shtetasve si dhe kordinimi i veprimtarisë së organeve të ndryshme.

6. Në ekzekutimit të vendimeve rreth konflikteve familjare, është theksuar nevoja e pranisë së punonjës social për problemet familjare

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

1. Drejtori i përgjithshëm i shërbimit përbarimor duhet të kontrollojë zbatimin me rigorozitet të ligjit duke i kushtuar rëndësi të veçantë të etikës profesionale gjatë veprimtarisë përbarimore (kërkesë kjo e nenit 8 të ligjit në fjalë)

2. Këshilli përbarimor në procesin e vlerësimit të përbaruesve gjyqësor të marrë në konsideratë edhe vlerësimin e shtetasve për punën e përbaruesit gjyqësor.

3. Zyrat e përbarimit duhet ti kushtojnë më kujdes përgatitjes së informacioneve të nevojshme për publikun dhe afishimit të tyre në vende të dukshme. Në këtë drejtim, Universiteti, shkolla e Magjistratures dhe organizatat që zbatojnë projekte në fushën e gjyqësorit mund të kontribuojnë në këtë fushë.

4. Dhoma kombëtare e avokatëve ka një rol të veçantë në këtë



drejtim. Trajnimi i avokatëve, ofrimi i shërbimeve falas për njerëzit që nuk kanë mundësi financiare dhe kanë nevojë për asistencë.

INDIVIDIVI DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Krahas probleme që ekzistojnë në ekzekutimin e vendimeve civile, probleme të shumta ka edhe në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale.

Lidhur me këtë çështje u krye një studim tjetër me personat e arrestuar dhe të dënuar të ndodhen në të gjitha burgjet shqiptare dhe në komisariateve e rretheve kryesore të vendit. Gjithsej janë intervistuar 360 persona. Ndaj 86% të tyre ishte dhënë një vendim penal i formës së prerë.

Një ndër problemet e pranishme këtë fushë ka qënë mosekzekutimi i vendimeve penale dhe mbajtja e personave të dënuar në komisaritet e policisë. 43.9% e dënimeve penale nuk janë ekzekutuar në kohë. Ky problem është vënë re edhe një një sërë vëzhgimesh që ka kryer Komiteti Shqiptar i Helsinkit në kuadër të nismes antikorrupsion të shoqërisë civile (MSI-USAID). Vetëm 50 % e vendimeve penale janë ekzekutuar në kohë.

Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale dhe Kodi i procedurës penale e njej të drejtën personit të ankohet për shkelje të ligjit dhe të drejtave të shtetasve në këet fazë. 57% e personave janë ankuar për mosekzekutimin e vendimeve penale në kohë. Drejtuesit e administratës së burgut, prokuroria e rrethit ku ndodhet institucioni i riedukimit, Ministria e Drejtësisë kanë qënë organet më të preferuara për tu ankuar nga personat e dënuar. Të dënuarit kanë preferuar edhe Institucionin e Avokatit të Popullit (13.8) dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit (23%).

Problemet që lidhen me trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve do të jenë objekt trajtimi në një raport të veçantë

¹ Studimi u krye në rrethet Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, Kukës, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan dhe Korçë. Anketimi u realizuar nga juristë dhe korrespondentë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në këtë rrethe.

² Përzgjedhja e të intervistuarve u bë në bazë të rastit ndërmjet personave të cilët ishin në pritje të ekzekutimit të vendimeve të dhëna në favor të tyre. Përcaktimi i numrit të personave që do të të intervistoheshin dhe përpunimi i të dhënave të mblëdhura u krye nga INSTATI. Përfitojmë nga rasti t'i falenderojmë për punën mjaft të mirë që kanë bërë.



TE DHENAT E MONITORIMIT TE PERMBARUESVE GJYQESOR

ALMA FASKAJ (VOKOPOLA)

Institucioni i Avokatit të Popullit

Sistemin gjyqësor, në tërë kompleksitetin e tij, nuk mund ta shohim të ndarë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Ky përbën një element të rëndësishëm të tij në ato vende ku sundon shteti i së drejtës.

Rëndësia e realizimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, garantohet në të njëjtën kohë nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në mënyrë që të përmbushet ky kusht, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore duhet të kryhet në përputhje me ligjin dhe në menyrë të ndershme, të paanshme, të efektshme, transparente dhe proporcionale.

Në këtë proces, është e evidente, që përmbaruesit gjyqësor, të punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim që të përmbushin detyrimet e tyre ligjore, të cilat përkojnë me realizimin e të drejtës së individit.

Por natyrisht, veprimtaria e këtyre të fundit nuk mund të kuptohet e shkëputur nga angazhimi apo gadishmëria e tërësisë së organeve të tjera të administratës shtetërore, të cilat përpos faktit që e kanë detyrim ligjor bashkëpunimin me përmbaruesin gjyqësor për të realizuar ekzekutimin, jo në pak raste ndodhen në pozitat e palës e cila nuk respekton procedurat e përmbarimit.

Parë në këtë këndvështrim, dhe nga praktika e Institucionit të Avokatit të Popullit, u përvijua ideja për organizimin e kësaj konference e cila përveç faktit të paraqitjes së problematikës do të na jepte nëpërmjet një pyetëso, mendimet e përmbaruesve lidhur me çëshjet kryesore që lidhen me punën e tyre.

Kështu, në punën përgatitore të këtij aktiviteti u hartua një pyet sor i cili ju dërgua të gjithë zyrave të përmbarimit për të dhënë mendimet e tyre.

Nisur nga problematika aktuale, siç rezulton nga anketimi, kemi arritur në disa konkluzione të cilat ja bëjmë të ditura auditorit:

Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë 29 zyra të shërbimit përmbarimor, të cilat sipas ligjit Nr. 8730 datë 18.01.2001, kanë njëje



organizim unik dhe janë të centralizuara me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Gjithsej janë 29 zyra të shërbimit përbarimorë më 116 përbarues.

Të intervistuar kanë qënë 96 përbarues.

Të intervistuarit përbarues janë 16 femra dhe 80 meshkuj. Në krahasim me institucionet e tjera, ky është një raport deri diku i pranueshëm për kushtet e vendit tonë.

Lidhur me nivelin arsimor të tyre rezulton që nga 80 të intervistuarit, pra 83.3% të tyre, janë me arsim të larte Juridik. Vetëm 1 është me arsim të lartë të përfunduar jo juridik. Ndërkohe 15 të tjerët ose 15.6 % e të intervistuarve rezultojnë në vazhdim të studimeve të larta, dega juridik. Ky është tregues që niveli arsimor aktualisht është në përputhje me funksionet që ushtron përbaruesi gjyqësor. Nuk ka qënë mirë që Ligji i miratuar në vitin 2001 lejoji që të punonin si përbarues persona që nuk ishin diplomuar si juristë, kur ka të tillë, bile që kanë mbaruar edhe jashtë shtetit ka me dhjetra.

Vjetërsia në punë e përbaruesve paraqitet e tillë, 54ëerpbarues nga 96 të intervistuarit, pra 56.3% e të intervistuarve rezultojnë me vjetërsi pune me mbi 5 vjet ,17.7% rezultojnë me vjetërsi 1-3 vjet dhe po aq është dhe përqindja e përbaruesve me vjetërsi pune nga 3-5 vjet. Vetëm 8.3% e të intervistuarve rezultojnë me vjetërsi pune nën 1 vit. Mendojmë se këto të dhëna janë të pranueshme për të kërkuar ngritjen e standarteve të punës nga përbaruesit.

Përsa i përket akteve ligjore dhe nënligjore që pranohen që njihen më mirë nga përbaruesit, renditen sipas radhës: 1. Kodi i Proçedurës Civile, 2. Ligji Nr. 8730 date 18.01 2001 "Per organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor", si dhe 3. Kodi Civil. Më pak, gjithmonë sipas të dhënave të anketimit, njihen Ligji Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" si dhe Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Shkalla e njohjes të legjislacionit proçedural civil dhe të akteve të tjera lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutive, nxjerr në pah shkallën jo tepër të lartë të aftësisë së përbarueve .

Përsa i përket pyetjes për nevojën e ndryshimeve të domosdoshme në aktet përkatëse, rreth 68.5 % e të intervistuarve shprehin ose japin opinionin e tyre për të iniciuar ndryshime ose saktësime në



Kodin e Proçedurës Civile; 26% e tyre mendojnë se këto ndryshime duhen bërë në Ligjin 8730 datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit përbarimor" ndërsa 27.1% e të anketuarve mendojnë se ka nevojë për përmirësime në urdhrat dhe udhëzimet e adresuara shërbimit përbarimor.

Në këtë rast duhen sqaruar, se në përgjigjet e të intervistuarve, përsa i përket ndryshimeve që pretendojnë që duhen bërë në aktet përkatëse, nuk saktësohet se cila normë konkrete ka nevojë për ndryshime, saktësime apo përmirësime, etj. Por mendojmë se ky boshllëk mund të plotësohet më mirë nga thithja e mendimit, në format që do të vlerësojë si më të arsyeshme Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit, për t'ja relatuar organeve përkatëse që kanë të drejtën e nismës ligjvënëse.

Përsa i takon bashkëpunimit të shërbimit të përbarimit gjyqësor me organet shtetërore dhe publike, i cili në fakt përbën një detyrim ligjor për këta të fundit, parashikuar në nenin 30 të ligjit 8730 datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor", dhe pikën 3 të nenit 142 të Kushtetutës, vlerësohen në 44.8% të tyre si "të mira" dhe në 37.5% si "pak të mira". Ndërsa vlerësimi "Shumë i mirë", rezulton në vlera minimale, konkretisht në 5.2%. Është tepër e evidente, njëkohësisht dhe problematik niveli jo i kënaqshëm i bashkëpunimit midis sistemit përbarimor dhe administratës shtetërore dhe publike. Për më tepër, duke patur parasysh se në një shumicë dërmuese të rasteve debitore janë pikërisht këto organe.

Në antitezë me këto rezulton se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë janë në nivele të kënaqshme, që patjetër duhet përhëndetur dhe punuar për të patur të njëjtin nivel. Neni 523 i Kodit të Proçedurës Civile parashikon që kur përbaruesi i shikon të nevojshme praninë e organeve të rendit, përbaruesi kërkon ndihmën e policisë së rendit. Kjo dispozitë është shfrytëzuar nga shërbimi përbarimor në të gjitha rastet kur prania e këtyre forcave shikohet e domosdoshme në vendin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, me qëllim parandalimin e veprimeve të kundra ligjshme të palëve ose të konflikteve që mund të lindin, duke filluar nga lirimi i banesave dhe sipërfaqeve të tokës, me prishjen e



ndërtimeve të ndryshme. Pikërisht 46.9% e të intervistuarve e pranojnë këtë. Ky rezultat na bën të reflektojmë se pari ne lidhje me faktin nëse dispozita e lejon këtë gjë dhe nga ana tjetër në rast se po a vlerësohen nga përmbartësit gjyqësor të gjithë momentet e rëndësishme të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt tek femijet, të tilla si ato psikiko -emocional, gjatë ekzekutimit të vendimit. Mendoje se analiza e metejshme e këtij fakti në panele do të paraqesë rekomandimet konkrete.

Problemi më i mprehtë që del nga anketimi, është mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në të cilat debitoret janë institucionet buxhetore. Kjo është dhe pika më e dobët dhe e vështirë e tërë sistemit përmbartimor në marrëdhëniet procedurale-civile që krijohen me segmente të veçanta të administratës publike, të cilat në kundërshtim të plotë me frymën e ligjit nuk pranojnë ose hezitojnë t'i ekzekutojnë vullnetarisht urdhërimet e gjykatave. Sot detyrimet e këtyre institucioneve ndaj kreditorëve, arrijnë vlera të mëdha monetare dhe ende nuk ka një perspektivë të qartë për mënyrën dhe afatet e shlyerjes së këtyre detyrimeve. Konkretisht 95.8 % e të intervistuarve e pranojnë këtë gjë dhe evidencojnë si pengesë ekzistencën e udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe mungesën e fondeve. Nuk dimë se sa nga ky detyrim është planifikuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2004, duke shpresuar që në këtë Konferencë të bëhet i ditur ky fakt nga organet përkatëse.

Në të njëjtën kohë, në nivele problematike paraqitet edhe situata lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj personave juridike e fizike privatë. Rreth 90.6% e të intervistuarve pranojnë se kanë ndeshur pengesa për ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj personave fizike e juridike privatë. Vështirësitë në më të shumtën e rasteve kanë qënë për shkak të mungesës së të ardhurave dhe pasurive të këtyre të fundit, ndërkohë që dhe mungesa e të dhënave rreth adresës së saktë të debitorëve është një problem gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Kjo e fundit përbën një detyrim për gjykatën që në vendimin e dhënë prej saj të jepën saktë gjeneralitetet dhe adresën e saktë të dënuarit.

Në lidhje me raportin ekzekutim vullnetar-ekzekutim i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga anketimi evidencohet se rastet e ekzekutimit vullnetar janë të pakta, 19.8% e



të anketuarve e pranojnë këtë gjë, ndërkohë që 81 prej të intervistuarve, pra 84.4% e tyre pranojnë se në shumicën dërmuese të rasteve mbizotëron ekzekutimi i detyrueshëm.

Proçesi i ekzekutimit të detyrueshëm në pjesën më të madhe të rasteve ndeshet me mos kryerjen e veprimeve ose kryerjen e të kundërtës të asaj që ka vendosur gjykata, si dhe me refuzimin për të vepruar të debitorit, që pas-sjell gjoba dhe me kallëzime për ndjekje penale në prokurori, gjë të cilën e evidentojnë dhe të dhënat e pyetësorit. Kështu 38.5% e të intervistuarve vlerësojnë sanksionet me gjobë si mjet efikas detyrues, dhe 41.7 % evidentojnë kallëzimin

Në funksion të realizimit të një proçesi ekzekutimi sa më transparent dhe të paanshëm, Ligji Nr. 8730 datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor", parashikon në nenin 18 të tij rastet kur përmbaruesi është i detyruar të heqë dorë nga ekzekutimi i një çështjeje.

Nga të intervistuarit vërehet se 68.8 % e tyre nuk kanë hequr dorë nga ekzekutimi asnjëherë, ndërkohë që 14.6% kanë hequr dorë disa herë, dhe 16.7% nuk pranojnë të përgjigjen për këtë pyetje.

Anketimi tregon që gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përmbaruesit, nuk përjashtojnë ndërhyrjen e funksionarëve dhe organeve shtetërore për favorizime të njëjës apo tjetrës palë. Kështu nga 96 të intervistuar, 24 ose 25% prej tyre pranojnë se ka ndërhyrje të kësaj natyre të strukturave shtetërore, 59.4% e mohojnë këtë gjë ndërkohë që 15.6% nuk pranojnë të përgjigjen.

E rëndësishme është fakti që megjithëse përmbaruesit pra 25% prej të intervistuarve pranojnë se ka ndërhyrje, 87.5 % e këtyre të fundit mohojnë faktin që të jenë influencuar nga kjo ndërhyrje dhe vetëm një përqindje prej 4.2% pranojnë se ndërhyrjet kanë influencuar në punën e tyre. Ky tregues, pavarësisht kësaj shifre në dukje të ulet, është për t'u marrë në konsideratë dhe sinjalizim kthese, për të arritur në nivelin zero, pasi natyrisht që çënon rëndë pavarësinë e sistemit përmbarimor.

Përsa i përket pengesave që kanë ndeshur përmbaruesit gjatë ekzekutimit të vendimeve penale me gjobë dhe dënimeve plotësuese, 92.5% të tyre mosnjohjen e saktë të adresave, 13.4% parashitje si pengesë moskordinimin e punës me institucionet e tjera 9% dërgimin me vonesë të vendimit nga ana e prokurorit.



Është e pranueshme që për realizimin me sukses të detyrës së tyre përmbartuesit gjyqësore duhet të kenë infrastrukturën e nevojshme. Faktikisht, 89.6% e të intervistuarve mendojnë se nuk e kanë këtë gjë, ndërsa 81.3% mendojnë se mungesa e saj ul shpejtësinë dhe cilësinë e punës së tyre.

Në këtë rast nevojitet angazhimi i organeve shtetërore kompetente, ngritja e zërit veçanërisht nga Ministria e Drejtësisë, për të bërë të mundur krijimin e kushteve të punës të pranueshme për përmbartuesit. Kjo gjë do të ndikonte gjithashtu në rritjen e hapësirës së shërbimit nga ana e tyre.

Në të njëjtën kohë për rritjen e cilësisë së shërbimit përmbartuesit evidentojnë nevojën për trajnime mbi legjislacionin në fuqi si dhe komantar apo përmbledhje rastesh, me qëllim që praktikat pozitive të shërbejnë në punën e tyre.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

1. Organizimin e trajnimeve për të thelluar njohjen e legjislacionit lidhur me veprimtarinë e përmbartuesve.

2. Thithja e mendimit nga përmbartuesit në format që do të vlerësojë si më të arsyeshme Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, për t'ja relatuar organeve përkatëse që kanë të drejtën e nismës ligjvënëse, propozimet për ndryshimin e ligjeve përkatëse.

3. Ndërgjegjësimi i organeve shtetërore dhe publike për të rritur në nivelin e kërkuara bashkëpunimin midis kësaj të fundit e sistemit përmbartimor, si një faktor që ndikon ndjeshëm në ekzekutimin e vendimeve.

4. Përvijimi i një perspektive të qartë për mënyrën dhe afatet e shlyerjes së ketyre detyrimeve ku debitorë janë organet e administratës shtetërore.

¹ Neni 3 i Ligjit Nr. 8730 date 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit përmbartimor"



ZYRA E PERMBARRIMIT PERBALLE INDIVIDIT. PROBLEMATIKA DHE PERSPEKTIVA.

NASIP NAÇO

Drejtor i pergjithshem i permbarrimit

Përfitoj nga rasti dhe falënderoj Institucionin e Avokatit të Popullit i cili ne bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit kanë organizuar Konferencën Kombëtare me temë “ Mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në mbrojtje të të drejtave të individëve”

Më lejoni të paraqes para jush në mënyrë të përmbledhur, problematikën që kanë “Zyrat e përmbarrimit përballë individit dhe prespektiva e tyre deri në vitin 2005 “

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është hartuar dhe miratuar ligji Nr. 8730 datë 18.01.2001“Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor” dhe janë marrë të gjitha masat për realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e qeverisë gjatë kësaj periudhe, për të përmisuar ndjeshëm Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor, për të ndryshuar imazhin në këto zyra përmbarrimore .

Në nenin 2 të këtij ligji është përcaktuar edhe objekti i veprimtarisë ku thuhet se “Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshem të titujve ekzekutivë,në rastet e përcaktuara në K.Pr. Civile.”

Pas miratimit të këtij ligji dhe krijimit të Drejtorisë së Përgjithshme të përmbarrimit Gjyqësor, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë me Nr.2198, datë 25.03.2002 është miratuar struktura organike e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, prej 114 përmbarrues gjyqësor dhe një numër prej 16 vetash personel tekniko-administrativ, në 29 zyra përmbarrimore në rrethe,në nivel vendor.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, u organizua me një personel prej 7 inspektorësh dhe një numër prej 4 personash, personel tekniko-administrativë, në nivel qendror.

Drejtoria e Përgjithshme filloi të funksiononte duke kryer vetëm detyra me karakter administrativ si organizimi,drejtimi, bashkërendimi



kontrolli, duke siguruar zbatimin e njëjtë të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit, si dhe edukimin profesional dhe trajnimin e stafit përmbartues dhe unifikimin e praktikave përmbartimore.

Kjo Drejtori e "re" pasi evidentoi gjendjen faktike të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor dhe duke iu referuar zbatimit me efektivitet të ligjit, ka ushtruar një aktivitet shumëdimensional në këto drejtime:

- Në atë organizativ nëpërmjet krijimit dhe konsolidimit të strukturave e përshkrimit të vendit të punës.

- Në atë administrative, nëpërmjet urdhrave, udhëzimeve, orientimeve shkëmbimit të informacionit dhe funksionimit të mekanizmit të ankesave.

- Në atë procedural, duke bërë njësimin, unifikimin dhe zbatimin e përpiktë të ligjit në shërbimin përmbartimor, një ndarje të re të punës, largimin ndrydhimin dhe zëvendësimin e punonjësve të paafte dhe të korruptuar.

- Në atë buxhetor duke bërë përfundimisht shkëputjen nga administrimi i buxhetit gjyqësor të objekteve kapitale, paisjeve dhe mjeteve logjistike.

Për herë të parë për këtë shërbim u çel edhe buxheti i veçantë për vitin 2003 në varësi të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, për shpenzime për personelin, shpenzime operativ dhe në shpenzimet për investime.

Detyrë parësore për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor, mbetet krijimi i infrastrukturës së akteve ligjore dhe nënligjore të cilët do të mbushnin vakumin aktual në këtë drejtim dhe do ta shkëputnin përfundimisht nga sistemi gjyqësor në të gjithë sektorët dhe të bëhej realisht kalimi i këtij shërbimi totalisht në varësi të plotë të Ministrisë së Drejtësisë.

Është për t'u theksuar se nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Drejtësisë në dt. 26-27 Qershor 2002 në bashkpunim me ekspertë të Këshillit të Europës, është zhvilluar seminari me temë:

"Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor, misioni i të cilit është ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në K.Pr.Civile, organizimi dhe struktura organike e shërbimit përmbartimor gjyqësor"

Nga ky Seminar i cili ishte i pari për shërbimin përmbartimor gjyqësor



dolën edhe rekomandimet përkatëse, ndaj të cilave është kushtuar një vëmendje e vecanteënga ana jonë.

Shërbimi përbarimor Gjyqësor bazuar në programin e Ministrise së Drejtësisë, si dhe në programin dhe strategjinë dhe prioritetet e Këshillit të Ministrave të rekomandimeve të Eksperëve të Këshillit të Europës, të dala gjatë seminarit të organizuar i ka kushtuar nje vëmendje të posacme organizimit dhe funksionimit efektiv të sistemit të përbarimit gjyqësor, konsolidimit të infrastrukturës ,përbërjes dhe trajnimit të personelit të këtij shërbimi .

Për të bërë të mundur që;

1- Deri në vitin 2005 të bëhet ekzekutimin 100% i vendimeve gjyqësore.

2- Të largohen të gjithë përbaruesit gjyqësorë pa arësimin përkatës,të paaftë dhe të korruptuar.

3- Nga Qeveria ,Keshilli i Europës dhe projekti i Bankës Botërore, meret përsipër mbështetja logjistike, teknike dhe trajnuese, për shërbimin përbarimor gjyqësor.

Sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit Gjyqësor,ka hartuar dhe zbatuar një sërë masash organizative dhe ekzekutive, për përmbushjen e kuadrit ligjor dhe nën ligjor që do të plotësojë dhe persosë më tej infrastrukturën ligjore dhe nënligjore të ekzekutimit të titujve ekzekutivë do të permendim.

1- Eshtë përgatitur dhe miratuar “ Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përbarimit ”

Në bazë të kësaj rregullore janë bërë të gjitha emërimet e përbaruesve gjyqësore si dhe masat disiplinore të dhëna në adresë të tyre.

2- Eshtë përgatitur dhe po punohet Rregullorja e Brendëshme “Mbi funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor” në këtë projekt rregullore janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë të hollësishme,rregullat e organizimit dhe funksionimit të shërbimit përbarimor gjyqësor,marëdhëniet me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera publike dhe private.

Në këtë projekt rregullore do të rregullohen dhe përcaktohen më qartë mardhëniet midis Drejtorisë së Përgjithshme të Përbarimit me Zyrat përbarimore,mardhëniet Drejtor i Përgjithshëm me shefat e sektorëve dhe kryetarëve të zyrave përbarimore, si dhe



mardhëniet midis kryetarëve të zyrave përmbartimore ,përmbartuesve gjyqesor dhe personelit administrativ dhe teknik.

3-Eshte pregatitur dhe po punohet projekt-urdheri “ Mbi caktimin e tarifave përmbartimore”, pasi ne ligj eshte parashikuar se “ çdo veprim përmbartimor kryehet vetem kundrejt pagimit te tarifave perkatese”

Miratimi dhe zbatimi i ketyreve tarifave, do te beje te mundur krijimin e te ardhurave te konsiderueshme per Sherbimin Përmbartimor Gjyqesor.

4- Eshte pregatitur dhe po punohet projekt-udhezimi i perbashket i Ministrit te Drejtësisë dhe Ministri i Financave “ Mbi ndarjen e te ardhurave ,kriteret e procedurat e administrimit dhe te shperndarjes se tyre “

5- Eshte pregatitur dhe po punohet projekt-rregullorja “ Per sistemin e vleresimit te aftesive profesionale te përmbartuesve gjyqesor” bazuar kjo ne kriteret e cilesise ,te vellimit te punes ,te shpejtesise dhe te figures se tyre morale .

6- Eshte pregatitur dhe po punohet projekt-urdheri “ Mbi mbledhjen e te dhenave qe kane te bejne me ekzekutimin dhe administrimi i ketyre te dhenave “.

7- Eshte pregatitur dhe po punohet projekt-udhezimi “ Mbi bashkpunimin me organet e tjera “ ne kete projekt-udhezim jane parashikuar rregullat e hollësishme ne lidhje me bashkpunimin per kryerjen dhe permbushjen e detyres , me policine e shtetit,me policine ndertimore dhe policite e tjera ,si dhe me organet e pushtetit vendor dhe prefekturat.

8- Eshte pregatitur dhe po punohet per miratim e “ Kodit etik te përmbartuesit gjyqesor”

9- Nga ana e jone po punohet per pregatitjen e nje memorandumit bashkpunimi me subjektet e tilla si K.E.SH, A.T.Kredive,Drejtorine e Pergjithshme te Tatim-Taksave,dhe I.S.Shoqerore,Albtelekom etj,me cilat synojme ,marjen e angazhimeve te perbashketa dhe kordinimin e veprimeve ne veprimtarine ekzekutive te vendimeve gjyqesore.

(Keto projekt-rregullore do te kalojne per miratim,VETEM mbas konsultimeve dhe permisimeve te bera nga specialistet e kodifikimit prane kesaj Ministrie, Ekspertet trajnues te Keshillit te Europes ,dhe Konsulentet e projektit te Bankes Botrore)



Për këto arsye dhe për te patur rezultate sa më të larta, nga ana jonë është kërkuar edhe ndihma e eksperteve të Këshillit të Europës dhe Bankës Botërore për të kontribuar në drejtim të plotësisimit dhe përmirësimit, për kuadrin ligjor dhe nënligjor aq të domosdoshëm për mbarëvatjen dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor, një shërbim i ri dhe i pa kualifikuar.

Nga ana jonë po bëhen përpjekje që të kemi një bashkëpunim të frytshëm me Shkollën e Magjistraturës në drejtim të organizimit të seminarëve në të ardhmen

Pra nevojë e menjehershme dhe detyrë imediate e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, mbetet trajnimi i vetë stafit të përmbarruesve gjyqësor.

Për këtë arsye janë zhvilluar disa seminare në rang Republike dhe prefekturë të cilat kanë shërbyer në trajnimin profesional të personelit të sistemit përmbarrimor, gjyqësor pasi nisur nga vlerësimi i nivelit të tyre arsimor e profesional është arritur në konkluzionin se ky nivel lë shumë për të dëshiruar pasi (60-70 % e përmbarruesve gjyqësor nuk kanë arsimin e nevojshëm) atë juridik, ku rreth 35 % janë duke vazhduar shkollën me korispendence, rreth 30 % pa arsim perkates, atë Juridik ku keta të fundit janë larguar nga shërbimi përmbarrimor në zbatim të ligjit 8730 dt.18.01.2001.

-Gjithashtu në zbatim të ligjit nr.8730 datë 18.01.2001" Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor" dhe objektivave të percaktuara në programin e qeverisë gjatë kësaj periudhë, për të përmisuar ndjeshëm Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor, në drejtim të qytetarëve, për të ndryshuar imazhin në këto zyra përmbarrimore, u morën masat e duhura për largimin e përmbarruesve gjyqësorë të cilët nuk plotësonin kriteret e arsimit përkatës atë juridik të paaftësisë profesionale apo korruptive dhe janë larguar nga detyra 30 prej tyre nga ky shërbim.

-Janë plotësuar vendet vakante po në këto zyra dhe stafi i ri i emëruar, përmbarrues gjyqësor, është bërë në përputhje të plotë me ligjin e mësipërm dhe kandidaturat e emëruara janë përzgjedhur nga "Këshilli i përmbarrimit" dhe i janë paraqitur Ministrit të Drejtësisë për emërim.

Por duhet theksuar fakti, se në rreth 50% të stafit të ri, të emëruar përmbarrues gjyqësor, janë diplomuar apo trajnuar jashtë shtetit.



Në fushën e veprimtarisë procedurale në ekzekutim, për 9 mujorin e parë të vitit 2003, nga të dhënat statistikore të ndara sipas titujve ekzekutive rezultojnë të ekzekutuara tërësisht rreth 3.800 çështje, kur për vitin 2002 janë ekzekutuar rreth 3700 çështje të cilat janë publikuar edhe në "Vjetarin Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2002.

Nga rreth 2358 çështje me firmat piramidale të prapambetura nga vitet 1999,2000,2001 etj,janë ekzekutuar tërësisht edhe rreth 630 çështje ,61 janë refuzuar,2 çështje janë pezulluar,me vendim gjykate dhe 1665 çështje janë pushuar në bazë të nenit 616 të K.Pr.Civile, pasi nuk ka patur pasuri debitori,janë pushuar me vendim të gjykatës ,apo me kërkesë të Administratorve të shoqërive në administrim ,si saktësim identiteti,lirim detyrimi ,si dhe një pjesë e konsiderueshme ju është refuzuar administratorëve për kryerjen e veprimeve procedurjale pasi nuk ishin në përputhje me ligjin etj.

Në çdo rast,Administratorëve të shoqërive në administrim ju janë dërguar kopjet e vendimeve procedurjale të marra nga përmbarusit gjyqësor, si dhe dosjet përmbarimore jane arkivuar në përputhje me ligjin.

Për 2358 çështjet janë ngritur grupe pune ,me nga 10 përmbarues të komanduar nga rrethe të ndryshme, si në Zyrën Përmbarimore Tiranë edhe në zyrën përmbarimore Vlorë etj.

Duhet theksuar se me masat organizative të mara në tre muaj është kryer ai volum i madh pune dhe janë kryer veprime procedurale dhe administrative i barabartë me volumin e punës të kryer në 3 vjet nga zyrat e përmbarimit për këto çështje.

Në volumin e punës se kryer duhen llogaritur edhe rreth 4 125 çështje me pensionet ushqimore që jane me ekzekutim të vazhdueshëm,si dhe çështjet e pushuara për mungesë të pasurise së debitorit,apo të pezulluara me vendim të gjykates etj.

KONFERENCA KOMBETARE

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE TE FORMES SE PRERE
NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE TE INDIVIDIVE



Lloji i Titullit Ekzekutiv	Shteti debitor	Ceshtje Ne Total	Te mbartura	Te ardhura	Te Refuzuara	Rezull. Vend. Gjyqate	Ne ekzekutim	Ekzekutuar	Te pushuara		Gjohat e përmbarimit	Vjelja e Gjohave te përmbarimit	Kallzim Ndjek. Pen. N.320 KP	Pension Ushqimor
									Neni 61/c	Neni 61/d				
Detyrimet net e holla dhe ato kontraktuale	ATK	756	529	227	2	42	531	142	2	37	2	1	1	
	KESH	1126	972	154	70	18	527	186	8	317			17	
	F. Piramidale	2358	2297	61	61	2		630		1665				
	Te ndryshme	749	314	435	20	24	336	213	4	43	4	1	2	
	Detyrimet net e holla dhe kontraktuale private		1608	707	901	19	118	725	647	18	72	7		7
Gjohat Penale		1148	238	910	31	20	563	491	14	25	1		18	
TOTALI		13768	9412	4356	246	389	3136	3800	109	2335	90		80	4125



Të dhënat statistikore të mësipërme janë shqetësuese ,duke parë edhe prioritet e vendosura në programin e qeverisë.

Mbas këtyre të dhënave qëndrojnë qindra qytetarë të zhgënjyer, për problemet e tyre,për të ekzekutuar këto vendime gjyqësore që kanë mare formë të prerë.

Këta qytetare i kanë besuar drejtësisë, dhe i janë drejtuar asaj por kanë marë prej ZYRAVE PERMBARIMORE, një përgjigje të PA DREJTE siç është Neglizhenca dhe Mos Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në shumë raste.

PERSONELI

Vleresimi i gjendjes së personelit është bërë kryesisht, në raportet përmbarues gjyqësor, qytetar, raportin përmbarues gjyqësor,e numrin e çështjeve në ekzekutim, gjëndjen arsimore, nivelin e pagave dhe kushtet sociale.

Raporti përmbarues gjyqësor qytetar paraqitet 1 përmbarues gjyqësor për 29.217 banorë.

Të ndarë sipas çështjeve janë të mbartura nga viti 2002 dhe të regjistruara për vitin 2003 edhe rreth 11.243 çështje për 114 përmbarues gjyqësor e barabartë kjo me 98 çështje për çdo përmbarues gjyqësor për ekzekutim (Këtu janë llogaritur vetëm çështjet e mbartura nga viti 2002)

Nga sa më sipër, janë përpiluar akt-kontrollet përkatëse ku janë evidentuar problemet kryesore dhe është dalë me detyra konkrete për një ekzekutim më efikas e konform legjislacionit në fuqi si dhe janë marë masat konkrete,të karakterit disiplinor dhe të permisimit të gjendjes,të përmendur më sipër.

- Eshtë përfunduar përmisimi evidencave statistikor dhe është përgatitur unifikimi i veprimeve përmbarimore,duke përgatitur një dosje MODEL dhe shpërndarë gjithë zyrave përmbarimore,ku po vazhdon me përgatitjen e një manuali përkatës për përmbaruesit gjyqësor.

- Eshtë përgatitur me Qendrën e Publikimeve Zyrtare,një përmbledhëse legjislacioni në fushën e përmbarimit dhe u është



shpërndarë gjithë përmbauesve gjyqësor në shkallë vendi.

Si tjetër objektiv parësor përmendim përmirësimin e infrastrukturës dhe logjistikës në zyrat e përmbaimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit.

-Përgatitjen e projekteve për sigurimin e ambjenteve të përshatshme për punë dhe plotësimin me pajisje të tyre .

Në funksion të këtij objektiv janë realizuar nga drejtoria jonë një sërë takimesh me konsulente të Bankës Botërore (e cila ka akorduar grant-in prej 1 milion \$ duke përfshirë këtu edhe paisjet), I ndjekur monitoruar edhe nga përfaqësues të Bankës Botërore .

Gjatë muajit Nëntor 2003 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit ka përfunduar, paisjen e saj me mjete logjistike si kompjutera, për çdo specialiste në këtë drejtori ,fotokopje etj, dhe rreth 70 Kompjutera 30,fotokopje,30 fakse etj.

Është konsideruar si zyrë pilot dhe është kompletuar me paisje zyresh dhe 15 kompjutera zyra e përmbaimit Tiranë,2 fotokopje faks etj,dhe po vazhdon kompletimi i zyrës përmbaimore Durrës edhe kjo zyrë pilot.

-Evidentimi i shkaqeve për çështjet e mos ekzekutuara

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbaimit gjyqësor krahas krijimit të infrastrukturës së akteve ligjore dhe nën ligjore ka përcaktuar dhe evidentuar shkaqet, përsa i përket çështjeve të paekzekutuara,të cilat mendojmë se janë :

1-Mungesa e profesionalizmit (një pjesë pa arsimin përkatës për të cilat janë marrë masat përkatëse duke larguar një pjesë të konsiderueshme të tyre,)

2-Egzistenca e elementve korruptive (në një rast kallzim penal).

3-Mungesa e përkushtimit në punë dhe indiferentizmi i shfaqur në zyrat e përmbaimit, e organizimit të mangët të punës në zyrat përmbaimore, nga kryetarët e zyrave përmbaimore.(janë marrë masat përkatëse)

5-Mungesa e një kontrolli dinamik e të kualifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbaimit, dhe nga sektorët përkatës në këtë Drejtori.(janë marrë masat përkatëse)

6-Mungesa e respektit ndaj ligjit si nga përmbauesit gjyqësor, ashtu edhe nga qyetarët, persona fizikë,juridikë apo edhe nga institucionet buxhetore .



7-Mospajtimi dhe moszbatimi i institucioneve shtetërore (buxhetore) me urdhërat për zbatimin e vendimeve gjyqësore kur ata humbasin gjyqin, INJORIMI i vendimeve gjyqësore të formës së prerë prej këtyre institucioneve.

8-Mosmarja e të gjitha masave të duhura ligjore nga Përmbarsit Gjyqësor, për të siguruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

9-Mungesa e bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore.

10-Mungesa e një informacioni në linjë vertikale dhe horizontale, duke mos patur një sistem rrjeti informatik, brenda Shërbimit Përmbarsimor dhe me institucionet e tjera për marjen e informacioneve dhe të dhënave të çështjeve në ekzekutim.

11-Mungesa e një baze të nevojshme materiale, për mbarvajtjen normale të punës, e cila aktualisht mungon tërësisht dhe gjendja pothuajse e këtij shërbimi ka qenë e MJERUAR..

12-Mosplotësimi me literaturën e nevojshme juridike për të gjitha zyrat e përmbarsimit.

13-Moskuptimi dhe moszbatimi i ligjit për " sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i tarifave dhe shpenzimeve përmbarsimore, mos kuptimi dhe mos zbatimi i mjeteve të mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, kundërshtimi i veprimeve përmbarsimore, pezullimi i ekzekutimit të vendimeve, pushimi i ekzekutimit të vendimit etj.

Por një çështje që kërkon vëmendje të veçantë, pasi ka ankime të shumta për zyrat e përmbarsimit, për shkak të mosekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, për të cilën po punojmë për gjetjen e modalitetve të duhura në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve që kanë institucionet shtetërore (buxhetore) ndaj personave fizik dhe juridik.

Shkaqet e mosekzekutimit të këtyre vendime me institucionet buxhetore, mendojme se janë :

a-Institucionet buxhetore nuk zbatojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë, por i injorojnë ato, duke mos i zbatuar, dhe duke mos kërkuar fonde nga Ministria e Financave, i cili është edhe organi epror financiar i përcaktuar me ligj.

b- Mos çelja në asnjë raste e fondeve nga Ministria e Financave si organi epror financiar, pasi në shumë raste nuk i bëhet kërkesë për



çelje fondesh, nga institucionet buxhetore.

c-në asnjë rast nga pala debitore (institucionet buxhetore) nuk bëhet kërkesë pranë gjykatës për të shtyrë ekzekutimin apo për të kërkuar që të shlyhet me këste, (parashikuar kjo në bazë të nenit 517/2 të K.Pr.Civile.)

d-Mosmarja e të gjitha masave të duhura ligjore nga përmbaruesit Gjyqësor, (siç janë vendosja e gjobave neni 606 i K.Pr.Civile, dhe kallzimi për ndjekje penale, për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, parashikuar nga neni 320 i K.Penal.

-Rritja e efikasitetit të shërbimit të përmbarimit gjyqësor.

Të ndërgjegjshëm se në punën tonë ka vështirësi të shumta, por duke krahasuar dhe referuar edhe kontrolleve të ushtruara nga kjo Drejtori, ka një përmirësim të ndjeshëm nga Zyrat e përmbarimit, me të njëjten periudhë të vitit të kaluar.

Mendojmë se rritja dhe përmirësimi i ndjeshëm i ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore si dhe një punë më të kualifikuar dhe profesionale në të ardhmen do të jetë edhe :

a-Efikasiteti, përshtatshmëria dhe natyra bindëse e legjislacionit të ri, përmendimin këtu miratimin dhe zbatimin e ligjit 8730 datë 18.01.2001, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim dhe në funksion të ligjit.

b-Përzgjedhja e një stafi të ri në nivel qendror, profesionistë dhe energjik, të motivuar të cilët do të ushtrojnë një kontroll dinamik dhe të kualifikuar nga sektorët përkatës në këtë Drejtori dhe do merren me detajimin me hollësi të detyrave që dalin, si dhe ndjekja hap pas hapi deri në realizimin e tyre.

c-Forcimi i mekanizmave të kontrollit duke mënjanuar me kurajo civile, presionet e ndryshme, të cilat vijnë për të zvarritur ekzekutimet e vendimeve dhe abuzimi me to ç'ka do të dekurajonte luftën e nisur dhe do të demtonte imazhin e autoritetin shtetëror që ne ushtrojmë.

ç-Përzgjedhja e stafit drejtues siç janë kryetarët e zyrave përmbarimore në rrethe dhe rekrutimi i përmbaruesve të rinjtë me arsimin dhe kulturën juridike përkatëse, duke zhvilluar ndjeshëm konkurrencën në përzgjedhjen dhe marrjen në punë, duke rritur përkushtimin dhe duke luftuar indiferentizmin e shfaqur në zyrat e përmbarimit.

d-Bashkpunimi me organet e tjera shtetërore, si me institucionin



e Avokatit të Popullit, Avokatit të Shtetit, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, organeve të specializuara të shtetit për të luftuar egzistencën e elementeve korruptive.

e-Mospajtimi dhe mostolerimi ndaj institucioneve shtetërore (buxhetore) të cilët nuk zbatojnë vendimet gjyqësore kur ata humbasin gjyqin, mos INJORIMI i vendimeve gjyqësore të formës së prerë prej këtyre institucioneve, KUR SOT interesat e shtetit gjatë gjykimit mbrohen nga Institucioni i Avokatit të SHTETIT, duke marrë të gjitha masat e duhura ligjore nga Përmbartuesit Gjyqësor, për të siguruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (siç janë vendosja e gjobave neni 606 i K.Pr.Civile, dhe kallzimi për ndjekje penale, për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor , parashikuar nga neni 320 i K.Penal.

(Gjatë vitit 2002 janë vendosur 21 gjoba dhe 34 kallzime penale për pengim të ekzekutimit)

Ndërsa gjatë 9 mujorit të vitit 2003 janë vendosur rreth 90 gjoba dhe 80 kallzime penale për pengim të ekzekutimit.

Numër ky i barabartë me 5 vitet e fundit të Zyrrave përmbartimore.

é-Krijimi i një baze të nevojshme materiale dhe logjistike, për mbarvajtjen normale të punës , e cila aktualisht mungon tërësisht, dhe gjendja pothuajse ka qenë e MJERUAR,

Po punohet për përmirësimin e gjendjes nga buxheti i shtetit dhe (projekti i bankës botërore nga granti prej 1 milion dollarë i Bankës Botërore) .

f-Plotësimi me literaturën e nevojshme juridike për të gjitha zyrat e përmbartimit, njohja dhe respektimi i kushtetutes ,K.Civil, K.Pr.Civile dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat lidhen me veprimtarinë përmbartimore, si dhe me urdhërat dhe metodikat apo manualët e Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimit përmbartimor Gjyqësor si dhe Veprimtaria trajnuese e vazhdueshme për të gjithë shërbimin përmbartimor gjyqësor.

(Po bëhen përpjekje me Qendrën e Publikimeve Zyrtare për të gjetur mjetet dhe mundësitë financiare)

Duke mos dashur të zbehim të gjithë punën e shërbimit përmbartimor, ku përveç mangësive janë evidentuar edhe arritje e realizime në ekzekutimin e shumë vendimeve gjyqësore, e zgjidhjen e problemeve duke patur si orientim prioritetet e përcaktuara nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave për këtë shërbim,



rekomandimet e Këshillit të Europës, si dhe angazhimet që ka marrë vetë kjo Drejtori të cilat kanë si emërues të përbashkët ekzekutimin e plotë të titujve ekzekutivë deri në vitin 2005 në masën 100% të vendimeve gjyqësore.

Sa më sipër është vendosur nga Drejtoria e Përgjithshme, në kuadrin e planit të veprimit një vjeçar të saj, nisur nga studimi i statistikave, mundësive reale brenda këtij shërbimi, me synim për të mos patur asnjë dosje përmbarrimore të pa ekzekutuar për shkak të mungesës së përkushtimit në punë, indiferentizmit të shfaqur në zyrat e përmbarrimit, e organizimit të mangët të punës në zyrat përmbarrimore, është vendosur një numër minimal prej 50 deri 60 dosjesh përmbarrimore, realisht për tu ekzekutuar nga çdo përmbarrues gjyqësor, duke arritur në 2-fishimin e titujve ekzekutivë dhe mbritjen në 80% të shkallës së ekzekutimit në fund të vitit 2003.

Kjo do të realizohet me masat organizative të marra me unifikimin e praktikave përmbarrimore, me një mbeshtetje më të madhe logjistike si pasojë e projektit të Bankës Botërore, dhe investimeve të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2003 në shumën 100.000 lekë (të reja) dhe do të ekzekutohen minimumi rreth 5.000 çështje tërësisht, me të njëjtin numër përmbarruesish të miratuar, të cilat mendojmë se do të rrisin dukshëm forcën ekzekutive të këtij shërbimi me qëllimin e vetëm për të arritur atë objektiv të përcaktuar që deri në vitin 2005 të ekzekutohen 100 % vendimet gjyqësore, të regjistruara në zyrat përmbarrimore.

Përfundimisht, nisur nga misioni i shërbimit përmbarrimor gjyqësor, i cili është " ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë të dhënë nga gjykata, do të thosha se Zyrat e përmbarrimit Gjyqësor po mendojnë dhe po punojnë si "vazhdim integral i gjykatave "për zbatimin në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, të cilat kanë një ndikim SERIOZ në sigurinë dhe kredibilitetin e të gjithë sistemit ligjor, dhe çdo ditë ky Shërbim Përmbarrimor dhe 29 zyrat përmbarrimore në rrethe, po vihen në shërbim të plotë të qytetarëve, dhe po ndryshojnë imazhin e tyre.



GJENDJA DHE RËNDËSIA E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË KOMISIONIT TË SHERBIMIT CIVIL DHE TË ATYRE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NGA ORGANET E ADMINISTRATËS PUBLIKE, NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË INDIVIDËVE

ROLAND PËRMETI

Kryetar i komisionit të Shërbimit Civil

Ekzekutimi i vendimeve, si i atyre gjyqësore, ashtu dhe i vendimeve të KSHC-së, është një nga aspektet dhe treguesit më të rëndësishëm të efektivitetit të zgjidhjes së problemeve të qytetarëve dhe të dhënies së drejtësisë në përgjithësi, pasi vetëm në momentin e zbatimit të tyre, kryhet realizimi i të drejtave të pretenduara e të kërkuara, në organet kompetente, nga individët, personat fizikë, ata juridikë, etj. Ai është një nga shtyllat që mban në këmbë shtetin e të drejtës që pretendojmë se jemi duke ndërtuar.

Por, është rasti këtu, të themi se, në këtë kuadër të problemit kryesor të kësaj konference, atë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përfshihet dhe detyrimi për zbatimin e vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil, përsa kohë ky organizëm, në vetvete, paraqitet si një organ administrativ, me attribute të një gjykate të posaçme administrative apo pune.

Rëndësia e kësaj konference, që po trajton këtë problem të rëndësishëm, është edhe tek qëllimi i saj, i cili është dhe një nga objektet kryesore të Qeverisë Shqiptare, shprehur në programin e saj para Kuvendit të Shqipërisë në korrik 2002, në të cilin, ndërmjet të tjerave, parashikohet që brenda vitit 2005, të përfundojë ekzekutimi i të gjitha vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna në favor të individëve. Pikërisht, realizimit të këtij objekti, i ka shërbyer edhe çelja në buxhetin e shtetit, të një zëri të veçantë me shumë të vëna në dispozicion për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të kësaj natyre, direkt nga Ministria e Financave, veç atyre që ekzekutojnë nga buxhetet e tyre ministritë apo organet e tjera të Pushtetit Qendror apo Vendor.

Të gjitha ministritë, institucionet e tjera qendrore e lokale duhet të respektojnë nenin 143 të Kushtetutës Shqiptare ku thuhet se:



“Organet e shtetit janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Ky qëndrim kushtetues. Duhet mbajtur edhe ndaj vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe kërkesave dhe rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, me qëllim që të respektohen të drejtat e njeriut.

Nga ana e Komisionit të Shërbimit Civil, është treguar kujdes edhe në këtë drejtim dhe herë pas here janë kryer ndërhyrje e tërheqje vëmendje për zbatimin vullnetar të vendimeve të tij e të atyre gjyqësore, megjithatë, mund të thuhet se plaga e shpërfilljes dhe moszbatimit të tyre, nga drejtuesit e administratës, është prezent edhe tek ne.

Kështu, gjatë periudhës së vitit në vazhdim, janë trajtuar dhe iu është dhënë zgjidhje përfundimtare, më se 160 kërkesave dhe ankesave të nëpunësve të ndryshëm civilë.

Nga numri i përgjithshëm i tyre, janë zgjidhur në favor të ankuesve 59 çështje, ose afro 37% e tyre dhe këto vendime, të cilat, kryesisht, kanë shfuqizuar urdhërat e eprorëve për masa disiplinore ndaj nëpunësve të ndryshëm, është e nevojshme të zbatohen.

Prej këtyre vendimeve të dhëna në favor të ankuesve, vetëm 20 prej tyre, ose 34% janë zbatuar direkt nga organet administrative që u kundrejtohen.

Pjesa tjetër e vendimeve (pra 39 vendime) megjithëse në 16 raste, vendimet janë shqyrtuar dhe vënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë e për rrjedhojë janë kthyer në tituj ekzekutivë, nuk janë zbatuar. Si shkak për moszbatimin e këtyre rasteve, parashtrohet paraqitja e rekursit në Gjykatën e Lartë të RSH, gjë e cila kthehet në pengesë reale, për shkak se Zyrat e Përmbarimit, në shumicën e rasteve, nuk pranojnë të fillojnë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, kur është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, Kryesekretaritë e gjykatave, në raste të tilla, nuk japin vendimin, me shënimin “ka marrë formë të prerë”, të interesuarve.

Në fakt, një qëndrim i tillë nuk është i drejtë dhe duhet punuar dhe këmbëngulur për t’a ndryshuar. Në bazë të nenit 451 të Kodit të Proçedurës Civile, vendimet e Gjykatës së shkallës së dytë (pra, Gjykatës së Apelit) janë të formës së prerë dhe si të tillë, në bazë të nenit 510 të po këtij kodi, janë tituj ekzekutivë, gjë që do të thotë se, nuk ka asnjë pengesë për organet e ekzekutimit t’i zbatojnë ato.



Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, është institut më vehte i të drejtës dhe parashikohet se mund të aplikohet vetëm në rastet e përmendura në nenin 615 të Kodit të Proçedurës Civile dhe në asnjë rast dhe nga asnjë organ tjetër.

Pra siç shihet, moszbatimi nga organet përmbartimore, i titujve ekzekutivë, është një arbitraritet që nuk duhet të lejohet në të ardhmen.

Por vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil, nuk janë të detyrueshëm për zbatim vetëm kur lihen në fuqi nga organet kompetente gjyqësore. Në bazë të nenit 8 pika të Ligjit Nr.8549 dt.11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", vendimet e KSHC-së, marrë brenda kompetencës dhe në përputhje me Ligjin, "... janë të detyrueshëm për institucionet e Administratës Publike të nivelit vendor e qendror". Mirëpo, pavarësisht se në këtë dispozitë bëhet fjalë për një detyrim, pa ekuivok, për zbatimin e këtyre vendimeve, zbatimi i saj është pothuaj fakultativ, sipas dëshirës së drejtuesve të institucioneve, të cilëve u kundrejtohen këto vendime.

Kjo është e lidhur me mangësinë që ka Ligji "Statusi i Nëpunësit Civil", i cili pavarësisht se parashikon detyrimin për zbatimin e vendimeve të KSHC-së, nuk i quan këto vendime tituj ekzekutivë dhe si të tillë, ata, nuk mund të zbatohen në mënyrë të detyrueshme nga Zyrat e Përmbartimit. Mendojmë se është rasti këtu të themi që ka ardhur koha, të rishikohet formulimi i kësaj dispozite të Ligjit Nr.8549 dt.11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", duke u parashikuar shprehimisht në të që, "vendimet e KSHC-së janë tituj ekzekutivë" dhe rruga e kundërshtimit të tyre të jetë ajo e kundërshtimit të titujve ekzekutivë. Ky trajtim mbështetet dhe nga përmbajtja dhe parashikimet e dispozitave të neneve 130 deri 134 të Kodit të Proçedurave Administrative, të cilat rregullojnë pikërisht ekzekutimin e akteve administrative.

Si raste tipike të moszbatimit, "me kokëfortësi" të vendimeve të KSHC-së, të kthyer në tituj ekzekutivë, mund të përmendim: vendimi për nëpunësin A.Mertiri me Ministrinë e Ekonomisë; vendimi për nëpunësin J.Dule po me Ministrinë e Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike; vendimi për nëpunësit H.Murati e V.Gjika me Bashkinë Vlorë; I.Kaduku me Ministrinë e Financave; A.Bajraktari me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, etj.



Ky problem, theksojmë se, është shumë i rëndësishëm, sepse moszbatimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil në përgjithësi dhe sidomos në ato raste kur janë lënë në fuqi edhe nga gjykatat, ka dëmtuar dhe vazhdon të dëmtojë në shuma të konsiderueshme buxhetin e shtetit, pasi siç thamë dhe më sipër, nisur nga natyra e konflikteve që trajton ky organizëm, në shumicën e rasteve, për të njëjtin vend pune paguhen 2 persona. Dhe, për më tepër, kjo ndodh jo për shkak të padijenisë së ligjit, por të kokëfortësisë së drejtuesve të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore e lokale që duan të kenë në vendet e punës, me status të nëpunësit civil, ata persona që duan ata, por jo nëpunësit që janë caktuar aty sipas Ligjit “Statusin e Nëpunësit Civil”.

Komisioni i Shërbimit Civil është i hapur dhe i gatshëm të mirëpresë e të plotësojë të gjitha rekomandimet e kësaj Konference, sepse në fund të fundit, qëllimi ynë i përbashkët është t’u shërbejë interesave të qytetarëve shqiptarë, zëdhënës dhe mbrojtës të të cilëve janë edhe organizatorët e konferencës, Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.



EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE ELEMENT THELBËSOR I SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË NË KONCEPTIN EUROPIAN

LEDI BIANKU

Qendra Europiane e te Drejtave te Njeriut

Do doja ta filloja perceptimin e fjalës që më është dhënë në këtë takim me dy shprehje të vjetra latine të shndërruara tashmë në aksioma filozofike mbi domosdoshmërinë por edhe mënyrën rregullimit ligjor të një shoqërie. Sipas këtyre shprehjeve "*Ubi societas, ibi jus*", dhe "*Ubi jus, ibi remedium*".

Këto nocione më shkonin ndër mend diku nga viti 1998 kur fillova të lexoj faktet e çështjes Horsby kundër Greqisë e cila kishte kaluar për gjykim dhe ishte dhënë vendimi nga Gjykata e Strasburgut më 19 mars 1997. Shkurtimisht për dijeninë e atyre që nuk e kanë lexuar përderisa një pjesë mund edhe ta njohin tashmë jo vetëm si çështje themelore në jurisprudencën e Strasburgut por edhe për faktin se është përkthyer dhe botuar në shqip.

Çështja kishte të bënte me dy shtetas britanikë të cilët kërkonin të ngrinin një shkollë në gjuhë të huaj në ishullin e Rodit në Greqi dhe faktet e çështjes janë si më poshtë:

Z. David Hornsby dhe Znj. Ada Ann Hornsby kanë lindur në Mbretërinë e Bashkuar respektivisht më 1937 dhe më 1939. Ata jetojnë në ishullin e Rodit dhe që të dy janë mësues të kualifikuar të anglishtes.

Më 5 qershor 1984 kërkuesi i dytë iu drejtua Dodecanese Autoritetit të Arsimit të Shkallës së Dytë me qëllimin që të marrë një autorizim për të ngritur një shkollë private për gjuhë të huaj (frontistirion) në Rod. Megjithatë, ajo ishte informuar ndërkaq që, në përputhje me legjislacionin grek në fuqi, asnjë autorizim i tillë nuk mund tu jepej shtetasve të huaj.

Më 15 mars 1988 Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane e deklaroi legjislacionin përkatës si në kundërshtim me Traktatin e K.E.E. Më 1 prill 1988 kërkuesit paraqitën dy kërkesa të reja, të cilat gjithashtu nuk u pranuan nga autoritetet arsimore duke u mbështetur



në të njëjtat arsye si më 1984.

Më 8 qershor 1988 kërkuesit paraqitën në Gjykatën e Lartë Administrative dy padi me objekt shpalljen si të paligjshme vendimet e Drejtorit Dodecanese të Arsimit të Shkallës së Dytë. Në vendimin e saj të 9 majit 1989 Gjykata e Lartë Administrative vendos që, në përputhje me gjykimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, shtetas të shteteve anëtare të Komunitetit Europian nuk mundeshin të ndaloheshin, duke filluar që nga 1 janari 1981, të ngrinin shkolla private në gjuhë të huaj në Greqi për shkak të faktit se ata nuk ishin shtetas grekë.

Në 8 gusht 1989 kërkuesit i u drejtuan por pa sukses Autoritetit të Arsimit të Shkallës së Dytë që të vepronte në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë administrative dhe tu jepte atyre autorizimin që ata kërkonin. Më 28 mars 1990 ata filluan procedurat kundër Drejtorit të Arsimit të Shkallës së Dytë si dhe kundër disa zyrtarëve të tjerë dhe më 14 nëntor 1990 ata i u drejtuan autoritetit të Gjykatës Civile të Shkallës së Parë të Rodit duke pretenduar kompensim për pësimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale si dhe për fitim të munguar. Më 3 korrik 1992 ata ngritën një padi tjetër për kompensim në Gjykatën Administrative të Rodit.

Një sërë letrash që i ishin dërguar Ministrit të Arsimit nga ana e kërkuesve si dhe nga ana e vetë Drejtorit të Arsimit të Shkallës së Dytë të Rodit nuk morën përgjigje.

Më 10 gusht 1994, me anë të një Dekreti Presidential nr. 211/94, shtetasit e vendeve anëtare të Komunitetit Europian fituan të drejtën që të ngrinin shkolla private në gjuhë të huaj me kusht që ata të kalonin një një provim në gjuhën dhe në historinë greke. Më 20 tetor 1994 Ministria e Arsimit e ftoi Drejtorin e Arsimit të Shkallës së Dytë që ta merrte në konsideratë rastin e kërkuesve nën këndvështrimin e këtij dekreti.

Kur mbarova së laxuari faktet e çështjes mendova se me siguri avokatët e çiftit Hornby do të pretendonin për shkelje të Nenin 13 të Konventës – pra mungesën e mjetit efektiv. Dhe ndërkohë që po vrisja mendjen se me cilin Nen tjetër të Konventës mund ta kishin lidhur shkeljen e Nenit 13 përderisa ai nuk mund të përdoret më vehte si bazë juridike për habinë por edhe për kuriozitetin ende më



të madh shoh pretendim për shkelje të Nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Natyrisht që kush e ka parasysh pak a shumë Nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e ka të qartë se në këtë Nen flitet për gjykim të drejtë, pra për barazi palësh dhe mjetesh në dispozicion të tyre, gjykatë të krijuar me ligj dhe të pavarur e të paanshme, të drejtë për avokat edhe kryesisht ose për tu mbrojtur vetë, gjykim të shpejtë dhe publik, paraqitje provash dhe dëshmitarësh, të drejtë për përkthim në gjuhën e preferueshme, dhe elementë të tjerë të konsideruar si përbërës të Nenit 6. Megjithatë nuk ka asgjë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si element më vehte të procesit të rregullt gjyqësor. Në këtë pikë konsistonte edhe habia e kurioziteti im në referimin që avokatët e Horsnby kishin bërë në Nenin 6 të Konventës. Pra çështja ishte nëse Gjykata do të arrinte që të konstatonte zbatueshmëri të këtij Neni dhe në vijim shkelje apo jo të tij në lidhje me pretendimin për mosekzekutim të vendimit gjyqësor.

Interpretimi që Gjykata i bënte çështjes në fjalë bëri që përsëri t'i referohesha shprehjes latine *ubi jus ibi remedium* por ndërsa perceptimi im fillestar ishte që mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore e bënte mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm në rezultat pra lidhej me elementin *remedium* të shprehjes latine, një nga paragrafet e vendimit të Gjykatës më bëri të kuptoja që ekzekutimi i vendimit gjyqësor ka të bëjë me vetë termin *jus* pra me të drejtën si koncept. Më lejoni t'jua riprodhoj këtë paragraf ku Gjykata shprehet se: "Kjo e drejtë (e drejta për një proces të rregullt ligjor) do të ishte iluzion në qoftë se rendi juridik i një shteti anëtar të Konventës do të lejonte që një vendim gjyqësor me karakter përfundimtar dhe të detyrueshëm të ngelej pa u zbatuar në dëm të ndonjërës nga palët. Në fakt, nuk mund të pretendohet që Neni 6 § 1 të përshkruante në detaje garancitë procedurale – barazinë, karakterin publik dhe zhdërvjelltësinë – që u njihen palëve dhe të mos mbrojtë vënien në jetë të vendimeve gjyqësore; në qoftë se ky Nen do të kishte të bënte vetëm me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave dhe me mënyrat e zhvillimit të proceseve gjyqësore kjo gjë do të rrezikonte të krijonte situata të papajtueshme me parimin e përparësisë të së drejtës (se shtetit të së drejtës) të cilin shtetet palë janë angazhuar ta respektojnë duke



ratifikuar Konventën. (...) Ekzekutimi i një vendimi, i cilësdo gjykatë qoftë, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e 'procesit' në kuptimin e Nenit 6" § 40

Për ta qartësuar më tej këtë botkuptim të saj in në paragrafin vijues Gjykata shton se "në qoftë se organet e administratës refuzojnë ose nuk veprojnë për ekzekutimin e një vendimi ose vonojnë ta bëjnë këtë gjë, garancitë e Nenit 6 nga të cilat përfitojnë palët gjatë fazës gjyqësore të procedurës do të humbisnin çdo arsye të ekzistencës së tyre".

Më lejoni ta them më troç këtë *obiter dicta* të Gjykatës së Strasburgut. Në qoftë se të nderuar përfaqësues të organeve të ngarkuara me ligj për zbatimin e vendimeve gjyqësore, nga kreu në fund, nuk jeni në gjendje të ekzekutoni vendimet gjyqësore, kursejini kohën, paratë dhe energjitë individëve nën juridiksionin e shtetit shqiptar që të mos duken nëpër gjykata. Veçse atëhere mos predikoni zbatim të Kushtetutës dhe të parimin suprakushtetues të shtetit të së drejtës.

Këtë qëndrim Gjykata e ka përforcuar edhe më tej në vendimin e saj *Immobiliare Saffi kundër Italisë*, ku ajo shton se organet shtetërore të cilave u takon me ligj të ekzekutojnë vendime gjyqësore "ndërhyjnë në një procedurë ekzekutimi të një vendimi gjyqësor, një ndërhyrje e tillë nuk mund të ketë për pasojë pengimin, shfuqizimin ose vonesën në mënyrë të tepruar të ekzekutimit, dhe aq më pak, të verë në dyshim thelbin e këtij vendimi".

Në një vendim të 26 tetorit 2000 në lidhje me çështjen *Hassan dhe Tchaouch kundër Bullgarisë* Gjykata e Strasburgut është më e drejtpërdrejtë me organet shtetërore duke iu referuar vendimeve që nuk zbatohen prej tyre. Ajo shprehet se "Shteti i së drejtës, njëri prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike është pjesë përbërëse e tërësisë së Neneve të Konventës dhe kupton detyrën e çdo shteti ose autoriteti publik që të bindet ndaj një vendimi gjyqësor që i drejtohet atyre."

Në vendimin e saj të parë kundër Rusisë më 7 maj 2002, në lidhje me çështjen *Burdov* ashtu edhe në vendimin tjetër të 23 tetorit



2003 në lidhje me çështjen *Timofeyev kundër Rusisë*, Gjykata shprehet se duke zvarritur zbatimin e vendimeve gjyqësore autoritetet vendase shkelin parimin e shtetit të së drejtës të cilin kanë marrë përsipër të respektojnë që në momentin kur kanë ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga ana tjetër, është shumë domethënëse shembulli i Komisionit Europian i cili vendosi t'i kërkojë *Gjykatës së Luksemburgut të gjobisë Italinë* me 309.730 € gjobë për ditë deri në ekzekutimin e një vendimi të kësaj Gjykate që ka të bëjë me trajtimin diskriminues të ish lektorëve të gjuhëve të huaja në disa universitete italiane.

Vendimi i 2 tetorit 2003 në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës të *Qufaj Co. Shpk kundër Shqipërisë* natyrisht që tregojnë që edhe ne na erdhi radha për të marrë ndëshkimin përkatës në Strasburg. Por kam përshtypjen se problemi këtu tek ne është edhe më problematik nga pikpamja konceptuale. Kjo për disa arsye:

Së pari: konceptimi i parimit të ndarjes së pushteteve dhe përparësisë të së drejtës.

Qëndrimi i parlamentit shqiptar i cili deklaroi haptazi mosrespektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me çështjen Rakipi nuk është asgjë tjetër veçse mosrespektim i parimit të shtetit ligjor pra edhe të kushtetutës. Parlamentarët tanë të cilët ende flasin në kuadrin e sovranitetit parlamentar nocion i denjë për organizimet parlamentare shtetërore deri në vitet 20 të shekullit të kaluar duhet të lexojnë ndoshta vendimin e Gjykatës së Lartë amerikane në lidhje me çështjen Madison kundër Marbury 1803, ku një vendim gjyqësor ishte i detyrueshëm për Kongresin dhe Presidentin. Në këtë kuadër edhe më sqarues duket vendimi i Gjykatës së BE në lidhje me çështjen Partia e Gjellbër kundër PE (1986) ku Gjykata shprehet se nuk ka asnjë akt me pasojë juridike që të mund t'i shpëtojë kontrollit të kushtetuetshmërisë. Pra që çdo akt që krijon pasojë juridike i nënshtrohet kontrollit kushtetues gjyqësor dhe zbatimi i tij i nënshtrohet kontrollit nga organet gjyqësore. Ky do të ishte një kriter bazë për një shtet të së drejtës që respekton ndarjen e pushteteve.



Pra, mendoni kur parlamentarët tanë, ose politikanët në përgjithësi, nuk respektojnë vendimet e gjykatave që i drejtohen atyre, si mund të pretendojmë në një botkuptim të përgjithshëm të publikut për domosdoshmërinë absolute të respektimit të këtyre vendimeve.

Së dyti: raporti zgjidhje politike dhe zgjidhje ligjore apo gjyqësore.

Është një raport që në Shqipëri, për fat të keq, ka anuar gjithmonë nga zgjidhjet politike. Duke filluar që me skemat piramidale e duke mbaruar me zgjedhjet e fundit. Nuk po i referohem historisë së shkuar për tu ndaluar tek kjo e reja e cila është edhe e tashme në një masë të madhe. Protestat e PD dhe të mbështetësve të saj sado legjitime, arrihen deri aty sa eklipsuan aktin që efektivisht çonte në mosnjohjen e zgjedhjeve – vendimin e Kolegjit Zgjedhor.

Ky vendim apo edhe të tjera (ato të GJK më 2001) u komentuan pastaj si të padrejta si dhe gjyqtarët që i dhanë u quajtën të korruptuar. Dhe nuk gjetëm asnjë interpretim kritik juridik për këto pretendime siç bëjnë doktrinën në të gjithë botën, duke ngritur në piedestal prezumimin e padrejtësisë së vendimeve gjyqësore përfundimtare. *Jean Bodin*, do ta quante me siguri shkelje të sovranitetit në shtetit. E si mund të pretendojmë pastaj respektim me bindje të vendimeve gjyqësore nga ana e individëve, apo edhe më keq, që individët të mos e shohin vetgjyqësinë si zgjidhjen më efektive.

Së treti: koncepti i imunitetit dhe mossuksedimit institucional.

E ushqyer me filozofinë monarkike *apres moi le deluge* ose *historia fillon nga unë*, institucionet shqiptare e kanë jo vetëm të vështirë të pranojnë se nga pikpamja administrative mund të ngarkohen me përgjegjësi, por aq më keq, kur është rasti, që përgjegjësia administrative e institucionit është e ndarë nga ajo jo e personit që eventualisht e përfaqëson atë. Apo edhe të përgjigjen për akte të kryera nga institucioni që përfaqësojnë përpara se ata të zgjidheshin apo emëroheshin si përfaqësues të tij – pra suksedimi i përgjegjësisë administrative. Dhe për pasojë vijmë në situata si ajo e çështjes Qufaj, ku duket se Shqipëria do deklarohet përgjegjëse për shkelje të të



drejtave të njeriut sepse Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave zihen se nuk e dinë se kush duhet të paguajë pasojat e një akti që ka cënuar sipas gjykatave shqiptare interesat e të tretëve. Shëmbuj të tjerë të ngjashëm në praktikën e administratës shqiptare ka sa të duash.

Së katërti: zbatimi i vendimeve të gjykatave ndërkombëtare.

Angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë e më konkrete sidomos në planin e të drejtave të njeriut dhe të integritit evropian. Këto angazhime po shoqërohen edhe me struktura administrative dhe juridiksionale vendimet e të cilave janë ndërkaq dhe do të jenë në të ardhmen drejtpërdrejt të detyrueshme dhe tituj ekzekutivë në sistemin juridik shqiptar. Shembulli shqiptar në këtë drejtim përdoret për keq në manualët e së drejtës ndërkombëtare duke patur parasysh mosrespektimin e vendimit të Gjykatës së Hagës mbi incidentin e Kanalit të Korfuzit. Dhe ka rrezik që referenca të mund të përsëritet po të kemi parasysh sidomos Gjykatën e Strasburgut apo edhe etapat e ardhshme të integritit evropian. Në këtë drejtim, pa u ndalur specifikisht në dispozitat përkatëse të Kodeve të procedurës, do të sugjeroja që një rishikim përkatës, për momentin vetëm në lidhje me vendimet e Gjykatës së Strasburgut dhe në përputhje me reformën që po bëhet ndërkaq në Strasburg do të ishte i domosdoshëm. Nga ana tjetër përgatitje specifike të organeve të gjyqësorit dhe administratës në këtë drejtim duhen thelluar akoma më tej.

Më lejoni ta mbyll me një konkluzion në të cilin më bënë të arrij katër momentet e lartpërmendura: Shteti i së drejtës dhe kushtetueshmëria nuk janë koncepte voluntariste që nga momenti i zgjedhjes konceptuale kushtetuese që kemi bërë, dhe aq më pak diskrecionare. Ato janë botkuptime mazhoritare themelore të një demokracie reale pa të cilat kjo e fundit nuk mund të ekzistojë, dhe që fillojnë nga pranimi i perceptimit se një individ apo një grup i caktuar në një shoqëri demokratike duhet të pranojë si të ligjshme edhe një zgjidhje që nuk përshtatet me interesat apo botkuptimet e tij personale apo edhe të grupit përkatës.



PROÇEDURAT BANKARE PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE PRAKTIKA DHE NEVOJA PËR NDRYSHIME

ARDIAN FULLANI

Kryetar i Shoqatës së Bankierëve

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë e juridikë mbi shumat e llogarive të tyre bankare është parashikuar në nenet 593 deri në 600 të Kodit të Proçedurës Civile (K.Pr.C.).

Bazuar në nenin 600 të K.Pr.C. dhe në Ligjin 8269 dt.23/12/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, kjo e fundit ka nxjerrë një udhëzim, i cili është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i saj me Vendimin nr.43 datë 31.03.1999 dhe që i drejtohet të gjithë personave juridikë që kryejnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë të liçensuar nga Banka e Shqipërisë. Nëpërmjet këtij udhëzimi rregullohen proçedurat bankare që lidhen me ekzekutimin e detyrimeve të konsideruara si tituj ekzekutivë sipas përcaktimit të nenit 510 të Kodit të Proçedurës Civile (K.Pr.C.).

Si rezultat i disa problemeve, të cilat u evidentuan në praktikë gjatë zbatimit të këtij udhëzimi, bankat e nivelit të dytë në bashkëpunim dhe me Zyrat e Përmbarrimit dhe Ministrinë e Drejtësisë arritën ndryshimin e udhëzimit “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka”, miratuar me Vendimin Nr.43, datë 11.06.2003 të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Ky udhëzim i ri ka përmirësuar mjaft punën dhe praktikën për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, fillimisht duke ndarë momentin e vënies së masës së bllokimit të llogarisë me sekuestrimin e saj. Pika më e rëndësishme në këtë udhëzim është vendosja e afateve për çdo veprim të kryer nga ana e bankës apo nga veprimet që duhet të ndërmerret Zyra e Përmbarrimit. Gjithashtu po në këtë udhëzim për herë të parë janë përcaktuar qartë afatet, kushtet dhe hapat që duhen ndërmerret nga të dyja palët në rastin e pezullimit të kërkesës/urdhërit për vënien e sekuestrimit në llogaritë bankare.

Duke qenë se sipas neneve 593 dhe 594 të K.Pr.C. Zyra e Përmbarrimit ka të drejtë të kërkojë të informohet dhe/ose të



urdhërojë bllokimin e llogarive të debitorit nga të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë në Udhëzimin e sipërpërmendur urdhëron të gjitha Bankat që menjëherë, por jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës për informim dhe/ose urdhërit të bllokimit të njoftojnë me shkrim Zyrën e Përmbarrimit mbi llogarinë-të e debitorit dhe sipas rastit të bëjnë bllokimin e tyre deri në shumën e kërkuar (neni 3.3 pika a dhe b) e udhëzimit.

Sidoqoftë, detyrimin e Bankës për të vepruar sa më sipër, Udhëzimi e lidh me disa kushte formale që duhet të përmbajë kërkesa për informim dhe/ose urdhëri i bllokimit. Më konkretisht sipas nenit 3.2 të udhëzimit përcaktohet se kërkesa/urdhëri duhet të përmbajë:

a) të dhëna të sakta për identifikimin e klientit ku sipas rastit janë:

1-emër, mbiemër, atësi, datëlindje dhe adresë – për individ

2- emërtim dhe numrin e vendimit të rregjistrimit në regjistër tregtar për persona fizikë dhe juridikë

3-emërtim dhe numrin e aktit përkatës për njohjen e personalitetit juridik – për persona të tjerë juridik.

b) shumën maksimale të detyrimit për t'u paguar

c) afatin e vlefshmërisë së bllokimit të llogarisë.

Pas kalimit të fazës së parë të njoftimit dhe bllokimit të llogarisë së debitorit me kërkesë të Zyrës së Përmbarrimit procedohet me vënien e sekuestros mbi pasuritë e debitorit dhe pas kalimit të shumës së bllokuar në favor të kreditorit.

Edhe kjo fazë është e lidhur me disa kërkesa dhe kushte që duhet të përmbajë Urdhëri i Zyrës së Përmbarrimit për vënien e sekuestros. Kështu, siç parashikohet në nenin 4 të Udhëzimit kërkesa/urdhëri i Zyrës së Përmbarrimit për vendosjen e masës së sekuestros duhet të përmbajë:

A.

1-Të dhënat e identifikimit të debitorit të lartpërmendura

2-Shumën e saktë të detyrimit në të cilën, bazuar në nenin 525 të K.Pr.C., përfshihet detyrimi principal (sipas rastit me interesa dhe/ose kamat vonesa), si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të kryera gjatë ekzekutimit, të cilat janë parapaguar nga kreditori.

3-Të dhënat e sakta për emërtimin, numrin e llogarisë dhe bankën, në të cilën do të kalojë shuma e sekuestros.



4-Rradha e preferimit sipas nenit 605 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

B.Vendimin gjyqësor, si dhe çdo akt tjetër, i cili në zbatim të nenit 510 të K.Pr.C. konsiderohet si titull ekzekutiv.

C.Dokumentin që vërteton lajmërimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe marrjen dijeni të tij.

Lidhur me format standarte për sekuestrim dhe bllokim duhet të citoj se vihet re një përpjekje për përmirësim të tyre nga ana e Zyrave të Përmbarrimit, megjithëse në praktikë ka akoma disa probleme për evidentimin e saktë të subjekteve (kreditor/debitor), lidhur me gjeneralitetet apo të hënata e duhura për identifikimin e saktë të tyre.

Dokumentacioni i lartëpërmendur që i drejtohet Bankës duhet të jetë sipas rastit origjinal, i notuar, njësuar me origjinalin nga sekretaria e gjykatës ose kopje të vërtetuara me vulë të Zyrës së Përmbarrimit.

Brenda tre ditëve nga marja e kërkesë/urdhërit për sekuestro nga Zyra e Përmbarrimit së bashku me dokumentacionin përkatës të lartëpërmendur, Banka kontrollon rregullsinë në formë dhe përmbajtje të praktikës, duke vendosur sipas rastit në këtë formë:

1.Kur konstaton parregullsi – vendos kthimin zyrtarisht Zyrës së Përmbarrimit gjithë praktikën së bashku me vërejtjet e konstatuara. Në këtë rast, llogaria e debitorit mbahet e bllokuar edhe 10 ditë të tjera kalendarike nga dita e nisjes së përgjigjes. Në mungesë të një përgjigjeje nga Zyra e Përmbarrimit brenda afatit 10-ditor kërkesë/urdhëri i sekuestros do të konsiderohet i pabërë ndonjëherë. (neni 5.1 i Udhëzimit).

2.Kur vlerëson se gjithçka është në rregull – vendos sekuestron mbi llogarinë e debitorit. Këtu duhet patur parasysh se Banka respekton rradhën e preferimit të parashikuar në nenin 605 të Kodit Civil, pra nuk pezullon pagimin e kredive që paguhen me preferim ndaj kërkesë/urdhërit për sekuestro (ku sipas rastit mund të jenë kreditë e punëtorëve, kreditë e sigurimeve shoqërore, kredi që rrjedhin nga shpërblime në rast vdekjeje apo dëmtim shëndeti, kreditë e Shtetit etj).

Në rast se shumica e disponueshme në llogari në ditën e kryerjes së veprimeve nuk është e mjaftueshme për të plotësuar të gjithë



shumën e detyrimit veprohet me vënien të sekuestros pjesore deri në shumën e disponueshme në llogari. Me këtë veprim, Banka konsideron të mbyllur praktikën dhe sipas rastit informon Zyrën e Përmbartimit ose krediton llogarinë e saj (neni 5./5 i Udhëzimit).

Zyra e Përmbartimit mund të rikërkojë vënien e sekuestros për praktika të kthyer në të njëjtën Bankë apo banka të tjera, por duke nisur gjithë procedurën e nga e para.

Ndërkohë kur Banka është në pamundësi që brenda 3 ditëve punë të vërë sekuestron mbi llogarinë e debitorit, për mungesë gjendjeje apo për shkak preferimi sipas nenit 605 të Kodit Civil, ajo e kthen praktikën pa veprim dhe njofton Zyrën e Përmbartimit jo më vonë se dy ditë pune pas afatit 3 ditor.

Përsa i përket procedurave të pezullimit të ekzekutimit të kërkesë/urdhërit të Zyrës së Përmbartimit, Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë ka pasur një referim të gabuar në bazën ligjore të K.Pr.C., i cili mund të sillte probleme në praktikë, gjë që me bashkëpunimin e palëve është korrigjuar tashmë me Vendimin Nr.78 datë 17.09.2003 të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë, duke përcaktuar qartë afatet, kushte dhe hapat që duhen ndërmarrë nga të dyja palët në rastin e pezullimit të kërkesë/urdhërit për vënien e sekuestros në llogaritë bankare.

Kështu në nenin 6.1 të Udhëzimit parashikohet se pezullimi i kërkesë/urdhërit për vënien e sekuestros mund të pezullohet me një vendim gjykatë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, në përputhje me nenet 206, 471, 479 dhe 615 të K.Pr.C.

Duhet të theksoj këtu se për herë të parë trajtohen dhe përcaktohen qartë në Udhëzimin e Bankës së Shqipërisë, procedurat e pezullimit të ekzekutimit të kërkesë/urdhërit të Zyrës së Përmbartimit, duke mos u lënë shkak interpretimeve që mund të bëjnë vetë bankat, duke ju referuar K.Pr.C. Edhe praktika për këto raste ka proceduar në mënyrë normale, si për Bankat, ashtu dhe për Zyrat e Përmbartimit.

Ne shpresojmë se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke futur një mentalitet të ri pune, jo vetëm në strukturat shtetërore të këtij lloji, por edhe tek vetë bankat dhe tek klientët e tyre.



MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE GJATË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE

BRIZIDA GJIKONDI

Institucioni i Avokatit të Popullit

Mendoj se tema që ne do të debatojmë, për disa nga ju nuk është dhe shumë e panjohur, pasi prej kohësh Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një fushatë sensibilizimi në shumë drejtime për njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe kjo është pasqyruar jo vetëm në korrespondencat tona ndërinstitucionale por dhe në median elektronike dhe të shkruar.

Për fat të keq në Shqipëri nuk ekziston ende një kod për të miturit ose më mirë një përmbledhje unike që të përfshijë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me të miturit, dispozitat që ekzistojnë në lidhje me të miturit janë të shpërndara në shumë akte të ndryshme ligjore duke të krijuar idenë e një fjalëkryqi, ndaj është ende e vështirë të krijosh një bazë ligjore të mirëfilltë për të miturit, pasi ende në Shqipëri në vendin e paradokseve ku ka akte ligjore dhe për mirërritjen e gjësë së gjallë nuk është krijuar një ligj, i cili të ketë objekt të tij mbrojtjen e të drejtave të të miturve. I vetmi akt i mirëfilltë ligjor që për objekt të tij ka mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është Konventa "Për të drejtat e fëmijës" e ratifikuar nga shteti shqiptar në vitin 1992. Konventë e cila pak njihet dhe akoma më pak zbatohet.

Edhe po të lexohet me kujdes Strategjia Kombëtare për Fëmijët (e hartuar nga qeveria shqiptare) e cila duhet të zbatohet përgjatë viteve 2001-2005, shihet se referimet ligjore jepen për mbrojtjen e të drejtave të të miturve ndër rreshtat e ligjeve si nr.8432 datë 14.12.1998 "Për Azilin", ligjin "Për Gjendjen Civile", Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin Penal etj.

Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese....



Neni 3, paragrafi i I-rë, i Konventës Mbi të Drejtat e Fëmijëve e ratifikuar prej mbi 10 vjet nga shteti shqiptar.

Në paragrafin e III-të të Nenit 9, të po kësaj Konvente, përcaktohet: Shtetet palë (të kësaj Konvente) respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njeri prind ose nga të dy prindërit, që të mbajë marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 54 i saj sanksionon :
Fëmijët...kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti..

Kodi i ri i Familjes në nenin 2 sanksionon.

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat në vendimet e tyre duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Si dhe në nenin 6 paragrafi i fundit sanksionohet:Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme..

Sa më sipër duke ju kërkuar ndjesë, ja u citova për të bërë të mundur krijimin e një kuadri për realitetin konfliktual që ndodh në Shqipëri ndërmjet Interesave të fëmijëve (të mbrojtura me ligj) dhe strukturave jo efikase duke përfshirë, institucionet publike, private autoritetet administrative dhe organet legjislative, të cilat në shumë raste bëhen shkak për shkeljen e këtyre të drejtave. Respektivisht Zyrat e Përmbarrimit në rrethe, në rang Republike janë nga shkaktarët dhe iniciueset e një zinxhir shkeljesh, vuajtjesh dhe traumash psiko sociale që u shkaktohen të miturve. Vendimet e ekzekutimit të marra nga gjyqësori në bazë të të cilave procedohet nga Zyrat e Përmbarrimit kur për objekt të tyre janë, pensionet ushqimore, marrja e fëmijës në besim (term i ri sipas K.F) takimet e fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar me vendim gjykate etj., në shumicën e rasteve, trajtohen nga përmbarruesit si marrje forcërisht e një sendi ose objekti dhe jo si një subjekt që ka mbrojtje të posaçme me akte ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Një thënie e vjetër romake thotë se është detyrë të jesh



gjithmonë prind edhe sikur mos jesh më bashkëshort. E citova këtë, pasi mendoj se prej kohësh në Shqipëri një pjesë e shoqërisë, sidomos familja si një strukturë e saj po kalon një krizë të mirëfilltë identiteti dhe morali. Dëgjojmë shpesh për fëmijë që shiten dhe trafikohen nga vetë prindërit, përdhunohen, vriten dhe reagimi mbetet gjithmonë në kuadër të një shqetësimi mediatik dritëshkurtër, duke harruar se e gjithë shoqëria shqiptare nga strukturat e saj shtetërore dhe deri tek shoqatat jo fitimprurëse kanë përgjegjësinë e tyre për këtë realitet.

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit u depozituan disa ankesa që në pamje të parë kishin të bënin vetëm me një mos ekzekutim vendimi nga ana e Zyrrave të Përmbarrimit kompetente për ta bërë. Mbas hetimit rezultoi se problematikat ishin më të mprehta dhe në mes ishin jo pak, por shkelja e të drejtave të fëmijëve.

Nga hetimi dhe verifikimi rezultoi se:

1. Duke filluar nga strukturat gjyqësore, ato të policisë së rendit, deri tek Zyrrat e Përmbarrimit në rang vendi, u konstatua se orientoheshin pak ose aspak nga aktet ligjore (gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre) kur objekt ose subjekt i procedurave ishin të drejtat e fëmijëve.

2. Ka mos kuptim ose abuzim me kompetencat që i jep ligji nga ana e Zyrrave të Përmbarrimit kur bëhet interpretimi dhe zbatimi i nenit 523 të K.Pr.Civile që titullohet "*Ndihma nga Policia e Rendit*" i cili përcakton qartë se:

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme që të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit për të kërkuar sendet e tij që ndodhen në to, përmbarruesi gjyqësor në rast nevojë kërkon ndihmën e policisë së rendit.

Kam krijuar bindjen nga shumë raste që kam asistuar se marrja e një fëmije forcërisht me asistencën e forcave të Policisë është dështim dhe një minus i madh për Zyrrat e Përmbarrimit. Nuk rresht së menduari se vetëm puna dhe ndërgjegjësimi i palëve në konflikt nga ana e Përmbarruesve përkatës për pasojat dhe traumat psiko sociale që vijnë tek një i mitur, do sjellë një efikasitet më të madh



tek zbatimet e vendimeve gjyqësore kur objekt ose subjekt i tyre janë të miturit.

Nuk shmang nga përgjegjësia, që për mua është kryesore, Gjyqtarët që gjykojnë këto çështje civile, të cilët në mos njohje dhe të akteve ligjore dhe të Konventës së sipërcituar nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur problematikave që kanë të bëjnë me një nga subjektet të brishtë siç është fëmija. Mjafton të lexosh një vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe do shohësh që këtij subjekti i cili mbrohet me ligj i kushtohen vetëm disa fjalë kur në të njëjtën kohë në shtetet fqinje si Itali, Greqi faqe të tëra të vendimeve të Gjykatave të të Miturve i kushtojhen psikologjisë, mirërritjes dhe përcaktimit saktësisht të të gjitha detyrave dhe pastaj të të drejtave të prindërve kundrejt këtij fëmije. Shpresoj që hyrja në fuqi e Kodit të ri të Familjes do të sjellë risi dhe përgjegjshmëri në zbatimin e tij jo vetëm në organet e gjyqësorit por dhe në të gjithë ato struktura të cilat do të kenë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

Gjithashtu duke ju rikujtuar statistikën, ku rezulton se një pjesë e fëmijëve që vijnë nga divorcet janë kontigjent për jetën e rrugës, emigracionit, trafikimit etj si dhe duke dashur t'ju nënvizojë faktin se dhe kur menaxhohet me kujdes divorci dhe pasojat e tij nga ana e strukturave kompetente për fëmijët, ky (divorci) mbetet një nga momentet më të vështirë dhe delikate të jetës së tyre pasi forcërisht ata detyrohen të humbasin një pjesë të jetës së tyre të identitetit, pa qenë ata shkaktarë.

Një pjesë jo e vogël e prindërve në Shqipëri nuk paguajnë pensionet ushqimore dhe kjo vjen veç të tjerash dhe nga mos impenjimi serioz i disa prej përmbaruesve por dhe nga papërgjegjshmëria e prindërve të cilët përballë apatisë të strukturave shtetërore bëjnë aleancë të heshtur në kurriz të bukës së fëmijëve të tyre.

Duke patur parasysh interesat e fëmijëve për këto raste proçedohet me dorën e hekurt të ligjit dhe të të gjithë strukturave ligjore si polici, prokurori, etj deri sa të jepen shembuj konkret se si realisht shteti shqiptar zbaton çka ka ratifikuar dhe çka ka sanksionuar në aktet e tij ligjore dhe nën ligjore.

Ligji nr. 8730 datë 18.01.2001 "Për Organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor" në nenin 21 të tij shpreh se



Përmbauesit gjyqësorë janë të detyruar të njohin, të respektojnë dhe të zbatojnë Kushtetutën, Kodin e Prc.Civile, Kodin Civil dhe akte të tjera ligjore dhe nën ligjore që lidhen me veprimtarinë përmbaimore ...

Jo vetëm në rastet e sipërcituar por dhe në raste të tjera formimi juridik dhe rrjedhimisht profesional i përmbauesit gjyqësor le për të dëshiruar.

Mjafton që Përmbauesit të kishin parasysh nenin 12 të Konventës së Mbrojtjes së Fëmijëve që shprehet se...fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative që ka të bëjë me të ...si dhe shumë nene të Kodit të vjetër të Familjes

Takimi me prindin në radhë të parë duhet të jetë kënaqësi për fëmijën dhe për pasojë dhe për prindin e divorcuar.

Sado i manipuluar të jetë ai nga njëri prind, ka rrugë dhe mjete jo të dhunshme dhe jo traumatike që zgjidhin këto procedura pasi fëmija nuk është objekt pronësie dhe nuk është e drejtë autori ose një e drejtë ekskluzive e njerit apo tjetrit prind.

Në të gjithë botën e emancipuar në këto procedura të dhimbshme siç është shpërbërja e një familje ka struktura realisht efikase të krijuara nga shteti pasi ardhmërisë së shtetit i shërbejnë.

Ngritja e qendrave të kujdesit social të qyteteve, qendra të cilat ndihmojnë në përzgjedhjen sa më të shpejtë se me cilin nga prindërit duhet të rrijë fëmija duke u mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët nga shteti shqiptar (2001-2005) por ecuria e saj le për të dëshiruar.

Mendoj se ka ardhur koha që pranë Zyrave të Përmbaimit në fundjave dhe në muajt e takimeve vjetore të jenë prezent dhe punonjës social, të cilët mund të mbështeten financiarisht nga OJF-të të cilët duhet të punojnë me prindërit për ti ndërgjegjësuar ata për të mirat që sjell një mbarëvajtje e takimeve të fëmijës për interesat psikosocial dhe të ardhmen e tij.

Nga ana e Zyrës së Avokatit të Popullit janë hartuar Rekomandime për Ministrin e Rendit dhe atë të Drejtësisë, por mendoj se ka ardhur koha që ky Rekomandim ti dërgohet dhe



Kryeministrit Nano (duke patur parasysh që ky i fundit ka kryesuar hartimin e strategjisë kombëtare për fëmijët 2001-2005), këto rekomandime përmbanin përveç sensibilizimit në lidhje me të drejtat e fëmijëve raste konkrete shkeljesh dhe abuzimi me kompetencat nga ana e strukturave të Përmbarrimit dhe forcave të policisë. Të tëra rastet e cituara u zgjidhën vetëm falë këmbënguljes së Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimit të disa prej Zyrave të Përmbarrimit, si ajo e Kukësit dhe e Tiranës.

Duke dashur realisht zgjidhjen e këtyre problematikave mendoj se ka ardhur koha që Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit konform kompetencave që i jep ligji, respektivisht paragrafi b i nenit 8 të Ligjit "Për Shërbimin Përmbarrimor", të marrë masat për nxjerrjen e udhëzimeve dhe metodikave për trajtimin në përgjithësi të çështjeve në ekzekutim.. me pak fjalë të udhëzoj dhe të unifikojë mënyrën se si do të procedohet në rastet, kur objekti i ekzekutimit është një e drejtë e cila ka të bëjë me fëmijën si ...e drejta e takimit, pensionit ushqimor, e ndenjes me prindin i cili e ka në besim etj.

Mendoj se përtej studimeve të realizuara nga disa OJF, kur realiteti fton dhe tregon një të vërtetë tjetër, ka vend për një bashkëpunim dinamik real dhe me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe shumë struktura të tjera që në Strategjinë e qeverisë për fëmijët shqiptarë përmenden shpesh por realisht ndjehen pak.



PROBLEMATIKA KRYESORE] GJATE EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE GJYQESORE CIVILE TE FORMES SE PRERE

DETAR HYSI

KRYETAR I ZYRËS PËRMBARIMORE TIRANË

Duke falenderuar pjesëmarrësit në këtë takim,

Duke gjetur me vend dhe të domosdoshëm zhvillimin e takimeve të tilla për ngritjen e problematikave dhe,

Duke shpresuar në zgjidhjen e problemeve të shfaqura gjatë ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë parashtroj:

Megjithë ngritjen e nivelit të punës dhe aksesit tonë tek njerëzit, gjatë punës hasim në vështirësi, të cilat bëjnë që kredibiliteti i Zyrës sonë të bjerë në sy të publikut, por pavarësisht problemeve me punën tonë jemi munduar të zbatojmë me korrektësi Kodin e Procedurës Civile dhe Udhëzimet e dala nga Drejtoria e Përgjithshme.

Për të renditur disa nga problemet të para sipas objektit përmendim:

Duke e filluar me praktikat ku ne hasim më shumë vështirësi

1. Në dosjet ku shteti është debitor vërehet se;

a) institucionet buxhetore nuk bëjnë shlyerjen e detyrimit në të holla ndaj kreditorit dhe zvarrisin ekzekutimin

b) vendimet e gjobave të vendosura nga përmbaruesi për këtë qëllim në shumicën e rasteve rrëzohen nga gjykata.

c) Kallzimet penale të bëra për këtë qëllim në shumicën e rasteve pushohen nga organi i prokurorisë.

d) Kërkesa e bërë për çeljen e fondeve nga organi epror në shumicën e rasteve nuk gjen përgjigje.

Për sa përmendëm më sipër, dosjet ku institucionet buxhetore janë debitorë janë dosjet që zgjasin më shumë në afat kohor për t'u ekzekutuar nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

Vlen për t'u përmendur se në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me detyrime për pagimin e pagës së një viti pune ku titullarët e



institucioneve buxhetore, duke mos zbatuar me korrektësi ligjin, zgjidhin kontrata pune në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme ligjore, gjë që bën që institucioni i tyre pra shteti të pagujë shuma të konsiderueshme.

2. Duke bërë një përmbledhje për çështjet ku shteti është kreditor p.sh., dosjet me kreditor KESH, A.T.K. Firmat Piramidale, etj.

a) një problematikë të përbashkët kanë mosparaqitja pranë Zyrës së Përmbartimit të të dhënave të mjaftueshme për debitorin p.sh.: adresat e tyre dhe gjeneralitete, gjë e cila pengon vazhdimin e procedurave nga ana e përmbartuesit gjyqësor dhe për pasojë janë marrë një sërë vendimesh refuzimi nga ana jonë.

3. Dosjet me objekt "Takim fëmijë" paraqesin problem në rastet kur fëmijët janë në një moshë mbi 78 vjeç dhe nuk dëshirojnë të qëndrojnë me personin me të cilin ka vendosur gjykata. Në raste të tilla, ekzekutimi i detyrueshëm është me pasoja dhe sjell tronditje për fëmijën dhe në shumicën e rasteve, duke shqyrtuar gjendjen psikologjike ose duke marrë parasysh traumën që mund t'i shkaktohet fëmijës dhe për të mos i shkelur të drejtat e tij, zbatimi i vendimit është bërë i pamundur, po kështu janë dhe rastet kur gjykata i jep të drejtën e takimit të fëmijës njerit prej prindërve, ku fëmija i manipuluar nga prindi tjetër nuk pranon të takojë prindin, i cili të drejtën e takimit e ka fituar me vendim gjykate.

Në këto raste, problemi më i madh është se nga ana jonë nuk mund të vendoset as sanksion mbi palën që mban fëmijën, pasi në zbatim të vendimit ai e nxjerr në takim, por është vullneti i fëmijës, i cili nuk pranon të shkojë tek prindi tjetër dhe në rastet kur nga ana jonë është vendosur sanksioni gjobë me pretendimin se me sjelljen e tij, prindi ka ndikuar tek fëmija dhe kështu bëhet i pamundur ekzekutimi i vendimit të gjykatës në këto raste nga gjykata janë rrëzuar vendimet tona.

E ngrita këtë si rastet tona më problematike se duke mbrojtur të drejtën e fëmijës për të mos e marrë atë forcërisht, nga ana jonë nuk zbatohet e drejta e kreditorit, i cili takimin me fëmijën e ka të përcaktuar në vendim gjykate.

4. Paraqitja për ekzekutim e gjobave penale me afat kohor të zgjatur pengon ndërhyrjen e përmbartuesit për ekzekutim të detyrueshëm dhe për pasojë koha e mbajtjes së dosjes është tej



afateve të parashikuara nga K.Pr.C. gjithashtu problem në praktikat e vendimeve penale janë se nga ana e sekretarisë gjyqësore nuk përcaktohet masa e shpenzimeve gjyqësore se në çfarë shume është duke u ditur se këto i janë ngarkuar të pandehurit, kjo shumë është një humbje nga buxheti i shtetit dhe tjetër problem është mungesa e adresës së të pandehurit dhe pse jo shpesh herë janë debitorë dhe të pandehur me banim jashtë vendit.

5. Në dosjet kontraktuale private është hasur problem në rastet ku vetë kreditori nuk paguan sipas ligjit shpenzimet përmbartimore apo nuk kryen veprime, të cilat sipas ligjit mund t'i kryejë edhe vetë ai.

Por, duke parë statistikat vërehet se më shpejt ekzekutohet praktika me detyrime kontraktuale midis palëve se në rastet kur kërkohet ndihma ose bashkëpunimi i një institucioni tjetër p.sh: në rastet kur kërkohet verifikimi dhe vendosja e masës së sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit lindin probleme me “Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, pasi duke i mirëkuptuar edhe këtë të fundit, jo të gjitha pronat janë azhornuar dhe nuk është përfunduar akoma rregjistrimi sipas ligjit për pasuritë e paluajtshme ose në rastet ku me vendim të formës së prerë është vendosur lirimi i një ambienti, duke prishur një objekt edhe në këto raste pavarësisht se në bazë të Ligjit 8730 datë 18.01.2001 nga ana e Policisë së Ndërtimit duhet të gjejnë mbështetjen me punëtorë dhe mjete, vlen për të dëshiruar në bashkëpunimin me ta.

Nuk i ngejmë këto probleme për të hequr përgjegjësitë apo zvogëluar detyrën që bie mbi ne, por me një bashkëpunim më të mirë do të kishim mundësi t'i afronim individëve dhe të interesuarve një shërbim më të mirë dhe me shumë akses tek drejtësia.

Duke parë gamën e gjerë të titujve ekzekutivë që janë pranë Zyrës sonë, vërejmë se edhe problemet janë të shumta, pra këto që përmendëm nuk janë të vetmet probleme që ka Zyra e Përmbartimit në përmbushje të misionit të saj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, por mendojmë se me punën tonë dhe ndihmën tuaj do të bëjmë të mundur kapërcimin e vështirësive.



MARRËDHËNIET E ZYRAT E RREGJISTRIMIT TE PASURISE ME ZYRAT E PËRMBARIMIT PER EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQESORE

ARTAN GJYLBEGAJ

Kryeregjistruesi

Jemi sot këtu në këtë aktivitet të rëndësishëm të ftuar nga ana e Avokatit të Popullit, për të bërë prezent dhe për të shpjeguar marrëdhëniet e Zyrave të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me Zyrat e Përmbarimit, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Që në hyrje të këtij diskutimi më lejoni t'ju bëj prezent faktin se ZORPP nuk është ajo që mund të shihni në emisionin "Fiks Fare" dhe në disa gazeta, ndoshta dhe pa emër të shtypit të përditshëm, të cilat vetëm anatemojnë pa të drejtë këtë zyrë. Puna e saj është shumë më e gjerë, me angazhime serioze dhe me objektiva të përcaktuara qartë dhe drejt nga Ligji Nr.7843 datë 13.07.1994 "Për Rregjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", ndryshuar me Ligjin 8090 datë 21.02.1996, si dhe vendimeve respektive të Qeverisë.

Nisur nga fakti që jam emëruar me cilësinë e titullarit të kësaj zyre, jo më shumë se para 6 muajsh, që në fillim, me seriozitetin dhe me transparecën më të plotë kam shpallur kriteret që duhet të kenë titullarët e zyrave, bazuar kjo dhe në VKM Nr.173 datë 07.03.2003, duke deklaruar hapat që titullarë të zyrave duhet të jenë vetëm persona të cilët gëzojnë aftësi në jurisprudencë dhe në hartografi. Në këtë këndvështrim, më lejoni t'ju them se jemi ne të parët, që duhet të zbatojmë vendimet gjyqësore të formës së prerë, ato të cilat me të drejtë kërkon t'i zbatojë Zyra e Përmbarimit, institucion i rëndësishëm ky në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por në të njëjtën kohë nuk mund të lëmë pa përmendur se janë këto dy zyra, institucione të shtetit të së drejtës, të cilat duhet të veprojnë vetëm në dhe për zbatim të ligjit.

Të paktën gjatë kësaj periudhe 6 mujore, ZRPP Tiranë ka patur rreth 70 praktika të ardhura nga Zyra e Përmbarimit, si urdhëra për rregjistrim, ashtu dhe bllokime e sekuestro etj, të cilat janë vlerësuar



nga ana jonë. Në disa raste, nga ana jonë, Zyrës së Përmbarrimit zyrtarisht i është dhënë njoftimi, se për të kryer veprimet e nevojshme pranë ZRPP-ve duhet të paraqitet vetë qytetari për të prerë aplikimin, si dhe për të paguar tarifën përkatëse të veprimit konform VKM 292 datë 24.04.2003. Kam konstatuar se në përgjithësi marrëdhëniet e ZZRPP-ve si në Tiranë, ashtu dhe në rang republike kanë qenë të mira dhe korrekte me përjashtim të kohëve të fundit, ku janë vënë re disa probleme nëpërmjet shtypit, shqetësime për të cilat ju garantoj se asnjëherë ZQRPP-ja nuk është vënë në dijeni zyrtarisht.

Në mënyrë të habitshme jam vënë në dijeni nga një apo dy gazetat tendencioze shtypi për një peticion që përmbarruesit e Zyrës së Tiranës i kanë dërguar Kryeministrit, fakt i cili më bën të besoj që janë anashkaluar institucionet shtetërore.

Më duket jashtëzakonisht i pamotivuar fakti që harrohen institucionet shtetërore, ku një zyrë vendore përmbarrimi (Zyra e Tiranës), pa njoftuar zyrën e saj eprorë, siç është Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtor i cili ka për titullar Ministrin e Drejtësisë, i cili nga ana e tij ka titullar Kryeministrin, si dhe pa njoftuar zyrtarisht ZQRPP-në ankohet tek Kryeministri për një X problem të një kreditori, duke kapërcyer kështu të gjitha hallkat e sistemit hierarkik të shtetit.

Mund të përmenden këtu gjashtë apo shtatë praktika të veçanta, për të cilat Zyra e Rregjistrimit, jo vetëm i ka vënë në lëvizje, por dhe ka kryer veprimet në një kohë që në mënyrë jokorrekte nga përmbarrues të caktuar jepen në shtyp mendime kontradiktore, si dhe nxiten njerëzit të japin opinione të pavërteta.

ZQRPP me cilësinë e titullares së sistemit, si dhe 35 zyrat vartëse të saj të shpërndara në të gjitha rrethet janë totalisht të hapura dhe do të jenë gjithmonë transparente për zbatimin me korrektësi dhe në kohë të të gjithave vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formën e prerë, por kjo asesi nuk mund të thotë që Sistemi i ZRPP-së të ekzekutojë vendime të cilat janë m të pazbatueshme, që bien në kundërshtim me Ligjin "Për Rregjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

Vendime të tilla, të cilat janë marrë nga gjykatat në kundërshtim të hapur me Ligjin 7698 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave të ish-pronarëve" në kapërcim të atyre limiteve të saktësuar dhe të përcituar në këtë ligj, janë dhe do të jenë totalisht të pazbatueshme



nga Zyrat e Pasurive të Paluajtshme. Vetëm në një vështrim të thjeshtë të Ligjit “Për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave” dhe konkretisht të neneve 4, 5 ku thuhet qartë se ky ligj nuk përfshin pasuritë e paluajtshme në formën e tokës të trajtuar nga Ligji Nr.7501 “Për Tokën”, bën që vendime të tilla gjyqësore, të dhëna për një sipërfaqe toke të ndarë tashmë sipas Ligjit 7501, të jenë të pazbatueshme. Nga ana tjetër, në kundërshtim me nenet 7.1 dhe 7.2 të Ligjit 7699 datë 21.04.1993 “Për Kompesimin në Vlerë të Tokës Bujqësore”, Ligji i cili ka parashikuar saktësisht 2 kriteret:

1. Moskthimin fizikisht të këtyre sipërfaqeve kur ato bien brenda vijave kufizuese të zonës që i është dhënë përparësi për zhvillimin e turizmit sipas VKM88 datë 01.03.1993.

2. Në të gjitha rastet, kthimin jo më shumë se 1.000. m², kërkohet rregjistrim i këtyre pasurive.

Ndodhur para këtij fakti shtrohet pyetja si mund të ekzekutohen vendime të formës së prerë në shkelje flagrante të ligjit, kur gjykatat të bazuar në këto ligje kthejnë fizikisht sipërfaqe të lira 30-40 mijë m².

Më lejoni të konstatoj se nga ana e Zyrate të Përmbarrimit kur titullarët e Zyrate të Rregjistrimit nuk kanë zbatuar urdhërime të tilla absurde, në shkelje flagrante të ligjit ndaj tyre është vënë masa e gjobës.

ZQRPP është dhe do të jetë gjithmonë e hapur, transparente vetëm për zbatimin e detyrimeve që i rrjedhin asaj nga ligji dhe jo nga etjet spekulative të të ashtuquajturve kreditorë apo të përmbarruesve të veçantë, të cilët kërkojnë zbatimin e të pamundurës, të të pazbatueshmes, sikurse përmenda vendime të tilla gjyqësore.

Më lejoni të konstatoj se për hir të angazhimeve të përbashkëta shtetërore, ZQRPP dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të rrisin më tej bashkëpunimin institucional. Le të shërbejë ky seminar për marrjen e angazhimeve të tilla dhe për bashkërendimin më të mirë të punës në të ardhmen midis këtyre dy institucioneve.

Duke ju respektuar për ftesën që na keni bërë, duke vlerësuar angazhimin e Institucionit tuaj si Avokat i Popullit, si dhe duke respektuar dhe prezencën e të tërë të pranishmëve në sallë, ju uroj për vazhdimësinë e punimeve të këtij seminari, si dhe ju garantoj se Institucioni i ZQRPP-së do të jetë gjithmonë tribunë e parë e zbatimit e të kërkesave ligjore.



PROBLEMATIKA E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

LULIETA NANO

Drejtoresh e Drejtorisë Ekonomike Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Organet e qeverisjes vendore (Bashki, Komuna dhe Qarqe) rezultojnë me një numër të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore të palikujduara.

Sipas të dhënave që disponohen, gjendja rezulton:

1. Në 16 Bashki totali i detyrimeve të vendimeve gjyqësore është rreth 72 milion lekë.

2. Në 19 Komuna rezultojnë me rreth 16.7 milion lekë detyrime nga vendimet gjyqësore.

3. Në 3 Këshilla Qarqesh rezultojnë me rreth 4.2 milion lekë detyrime nga vendime gjyqësore.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore konstatohet se nga bashkitë janë shlyer detyrimet në shumën 22 milion lekë ose rreth 30% e totalit të detyrimeve. Ndërsa nga ana komunave rezulton të jenë shlyer rreth 25% ndaj totalit të detyrimeve ose rreth 4.2 milion lekë. Këshillat e Qarqeve kanë ekzekutuar rreth 190 mijë lekë.

Në aspektin e llojit të detyrimit këto përfaqësojnë detyrime për pagesën e pagave për pushim të padrejtë nga puna, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale etj.

Një problem serioz i evidentuar në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga ana e njësive të qeverisjes vendore është pamjaftueshmëria e fondeve për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Referuar legjislacionit për këtë problem në zbatim të VKM Nr.335, datë 02.06, 1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 02.02.2001 në të cilin përcaktohet që detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore përballohen nga organi i qeverisjes vendore, me fondet e miratuara ose me të ardhurat e realizuara gjatë vitit buxhetor.




Në këtë kuptim, shlyerja e detyrimeve financiare nga vendimet gjyqësore kryhet mbas analizës dhe vendimit të këshillit përkatës të nj.q.v.

Vlen të përmendet se në një pjesë të njësive të qeverisjes vendore rezulton që ato janë bërë një "amortizim" gradual të këtij borxhi, megjithatë gjendja e këtyre detyrimeve të pashlyera është ende shqetësuese.

Në Bashki, rezultojnë të paekzekutuara 97 vendime gjyqësore në shumën 50 milion lekë. Në komuna 23 vendime gjyqësore në shumën 12.5 milion leke dhe në Qarqe 4 vendime gjyqësore në shumën 4milion lekë.

E paraqitur grafikisht rezulton:



II. Më shqetësuese paraqitet gjendja ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore të trashëguara nga ish Këshillat e Rretheve në vlerën 27 milion lekë. Në zbatim të Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 75, Prefekti i qarkut kryen funksionet e ish këshillave të rretheve. Në këtë kuadër të gjitha detyrimet nga vendimet gjyqësore që kishin këshillat e rretheve u transferuan në prefekturat e qarqeve. Këto përfaqësojnë vendime që nga viti 1994 dhe ende rezultojnë të pashlyera. Në zbatim të legjislacionit përkatës, këto detyrime duhet të përballohen nga buxheti i prefekturave, por rezulton që këto të fundit e ushtrojnë aktivitetin në kushtet e një buxheti të shtrënguar. Mjafton të përmendim faktin që për vitin 2003 buxheti i Prefekturave i miratuar me ligjin vjetor, përfaqësonte 60% të nevojave për shpenzime të këtyre institucioneve. Nga analiza e ecurisë së ekzekutimit të këtyre detyrimeve rezulton se nga ana e prefekturave nuk është kryer shlyerja e këtyre detyrimeve (me përjashtim të Prefekturës Elbasan, e cila ka



ekzekutuar këto vendime në shumën 780 mijë lekë).

Sa trajtuam më sipër me qëllim përmbushjen e detyrimit kushtetues, sipas të cilit “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”, është e nevojshme që nga ana e Buxhetit të Shtetit të kryhet alokimi i fondit, prej 27 milion lekë me destinacion ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të trashëguara nga ish këshillat e rretheve. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet e mundur përmbushja e detyrimit në mbrojtje të të drejtave ligjore të individit.



KODI I PROCEDURES CIVILE DHE ZBATIMI I TIJ NGA PERMBARUESIT GJATE EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE GJYQESORE CIVILE. EKSPERIENCA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT

FREDI PASKALI

Institucioni i Avokatit te Popullit

Konferenca Kombëtare mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një detyrim kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, patjetër që është një nismë për t'u përshëndetur dhe që tregon impenjimin e tyre për trajtimin e një problemi që shqetëson një pjesë të shoqërisë tonë.

Përmbartuesi gjyqësor është një organ unik dhe i centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, i cili me ligj është i ngarkuar për të kryer veprime rigorozisht të përcaktuara procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë dhe titujve të tjerë ekzekutivë. Si i tillë ai është një nga subjektet e marrëdhënieve juridike procedurale civile dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij përfaqëson autoritetin shtetëror.

Në bazë të pikës 13, të nenit 6, të Ligjit nr.8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", shërbimi përmbartimor është në vartësinë dhe drejtimin e kësaj Ministrie. Në Nenin 17 të të njëjtit Ligj, përcaktohen kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, si institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që sipas ligjit ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve civile dhe titujve të tjerë ekzekutivë.

Ndërsa në Ligjin Nr.8730, datë 18.1.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor" përcaktohen rregullat e organizimit të këtij sistemi, kriteret që duhet të përmbushin personat që emërohen në detyrën e përmbartuesit gjyqësor, statusin që gëzojnë, rregullat e procedimit disiplinor ndaj tyre dhe të marrëdhënieve me institucionet e subjektet e tjera publike dhe



private. Dhe për t'a konsideruar optimalisht të kompletuar legjislacionin në fushën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, përmendim edhe pikën 3 të Nenit 142 të Kushtetutës, që përmban detyrimin e organeve të shtetit që të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Gjykimi civil është një proces që përbëhet nga dy faza:

Faza e parë është ajo e deklarimit të fitimit të të drejtës, ndërsa faza e dytë është ajo e rivendosjes plotësisht të saj. Por, njohja nga ana e gjykatës e së drejtës të shkelur, nuk është në vetvete e mjaftueshme për ta rivendosur atë, prandaj është e nevojshme ndërhyrja e një organi tjetër kompetent, që ka detyrimin dhe mjetet e duhura shtrënguese ligjore për arritjen e qëllimit. Ky organ ekzekutues është pikërisht përbaruesi gjyqësor, i cili detyron me mjete ligjore të përcaktuar rigorozisht qartë, personin (debitorin) që ka shkelur ose mohuar të drejtën, që të përmbushë detyrimin e tij të përcaktuar në një titull ekzekutiv, duke siguruar kështu respektimin e ligjit.

Në përputhje me parimin e disponibilitetit, procesi i ekzekutimit gjyqësor të titujve ekzekutivë, fillon me kërkesën e kreditorit.

Në ushtrimin e funksionit të tij, përbaruesi merr të gjitha masat që ekzekutimi të përmbushet në mënyrë vullnetare nga debitori, si parandalim i mëtejshëm i mosmareveshjeve. Në rast të kundërt, zbaton dispozitat proceduriale për ekzekutim të detyrueshëm duke përdorur edhe mjetet ligjore shtrënguese.

Përbaruesit gjyqësorë, veprimtarinë e tyre proceduriale e kanë të sanksionuar qartë në dispozita ligjore, konkretisht në K.Pr.Civile, pjesa e katërt, e titulluar "Ekzekutimi i Detyrueshëm".

Këtu janë përcaktuar titujt ekzekutivë, urdhëri i ekzekutimit e gjykata kompetente që e lëshon, kompetencat tokësore të përbarimit gjyqësor, lajmërimi për ekzekutim vullnetar, fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm, ndihma që kërkohet nga policia e rendit, ekzekutimi në fusha të veçanta, vënia e sekuestros e shitja në ankand e sendeve të sekuestruara, ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore e mbi llogaritë bankare, mjetet e mbrojtjes ndaj veprimeve të përbaruesit, deri te pezullimi e pushimi i ekzekutimit. Njohja dhe zbatimi i mirë i këtyre dispozitave nga përbaruesi, së bashku me objektivitetin dhe respektimin e të drejtave të garantuara të subjekteve përkatëse proceduriale, përbën



bazën për një ekzekutim të shpejtë të titujve ekzekutivë.

Në pamje të parë, lidhur me detyrën e përmbaruesit gjyqësor, të krijohet mendimi i gabuar se është një punë relativisht e lehtë, jo me ndonjë përgjegjësi të madhe dhe që mund të kryhet me një bagazh të vogël njohurish nga fusha e drejtësisë, kryesisht me ato që përmbajnë dispozitat e fundit të Kodit të Proçedurës Civile, Neni 510 e vijues.

Por në fakt nuk është kështu. Kryerja e kësaj detyre kërkon në rradhë të parë përkushtim, këmbëngulje në zbatimin e normave proçeduriale për ekzekutimin e shpejtë dhe të saktë të titullit ekzekutiv, dhe ajo që është më kryesorja: njohje shumë të mirë të ligjit proçedural dhe material civil. Përmbaruesi gjyqësor duhet të jetë një civilist i mirë, siç do përpiqem t'a argumentoj më poshtë në relacion me disa praktika përmbarimore, të ketë njohuri të plota për institute të tilla, si përfaqësimi, parashkrimi, trashëgimia, detyrimet, mbi mënyrat e mbrojtjes së pronësisë, mbi kontratat, afatet, etj.

Përmbaruesi, në çdo çështje konkrete ndodhet para disa "kurtheve", nga të cilat do të veçoja:

1) Trysnia e parë që ndjen, është ajo e kreditorit me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim, i cili pas një stresi dhe kalvari të gjatë seancash gjyqësore me vite, gjykimesh e rigjykimesh në të tre shkallët e gjyqësorit, gjatë të cilave ka konsumuar pjesën më të madhe të durimit, pret ekzekutim sa më të shpejtë të të drejtës së fituar.

2) Nga ana tjetër ndeshet me mungesën e vullnetit të debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të tij, me presione dhe kërcënime, me ndërhyrje të personave të ndryshëm, me veprime që mundohen t'a pengojnë atë duke mos pranuar e njohur vendimin e gjykatës (për fat të keq kjo ndodh edhe me titullarë të organeve të Administratës Publike, për mungesë të formimit të tyre juridik, por dhe mos denjimit të marrjes së mendimit të juristëve të tyre), me kundërshtime të veprimeve të përmbaruesit duke patur në shume raste edhe "ndihmën" e gjykatës që pezullon ekzekutimin, me largimin nga vendi i banimit, me fshehjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme me lloj lloj marifetesh që çojnë në pamundësinë financiare të shlyerjes së detyrimit, etj. Një lëkundje sado e vogël e përmbaruesit në fazën e ekzekutimit çon në zgjatjen disa mujore të veprimeve të mëtejshme.



3) Me vështirësi të që dalin gjatë procesit të ekzekutimit, nga dífektet që përmban vetë dispozitivi i vendimit gjyqësor të formës së prerë.

4) Niveli i përgatitjes profesionale të vetë përmbanuesit dhe nuk ka shkak për t'a fshehur në raste të veçanta: nga tërësia e integritetit moral të tij.

Në këtë kontekst, dëshiroj, gjithnjë me sensin e mirë për përmirësimin e praktikës përmbanimore, të evidentojmë disa mangësi të kësaj veprimtarie nga shqyrtimi i ankesave adresuar në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Fillimisht dua t'i bëj të ditur auditorit faktin, që ankimet kanë ardhur duke u shtuar nga viti në vit, për dy vitet e fundit kanë kapur shifrën e afro 250 ankesave, tepër domethënëse, që tregon se në këtë fushë ka probleme që shqetësojnë kreditorët, kryesisht të tilla që kanë të bëjnë me zvarritje të pajustificuara në kohë. Pikërisht këto reagime të cilat në shumicën e tyre kanë rezultuar të bazuara, janë parë dhe ndjekur nga ekspertët tanë me tërë seriozitetin që kërkojnë, duke i shqyrtuar me përgjegjësi rast pas rasti, me frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi si me Zyrat e Përmbanimit në rrethe, ashtu edhe me Drejtorinë e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, që si produkt kanë sjellë në shumë raste, shpejtimin e procedurave në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Veçanërisht situatë e vështirë është krijuar prej kohësh për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ndërmarrje, organe dhe institucione buxhetore, me argumentin se mungojnë fondet e duhura. Prej më se pesë vitesh nuk po gjen zgjidhje ky problem i mprehtë jo vetëm ligjor, por edhe social, i shoqëruar edhe me rënien e besimit ndaj organeve përmbanimore dhe krijimin shpesh edhe të situatave konfliktuale me të. Sot debiti i krijuar ndaj kreditorëve ka kapur shumën të mëdha, për të cilat duhet menduar dhe gjetur rrugët nga organet përkatëse shtetërore financiare për t'i likuiduar sa më shpejt. Këto shqetësime dhe të tjera shkelje të të drejtave dhe ineresave të ligjshme të gjyq-fituesve, janë edhe qëllimi i organizimit të këtij seminari të gjerë me pjesëmarrjen edhe të shumë strukturave shtetërore që kanë përgjegjësi të tyre ligjore në këtë fushë, gjatë të cilit shpresojmë të evidentohen mangësitë e karakterit subjektiv, por edhe të rritet shkalla e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit të tyre në



zbatimin e kërkesave të nenit 142/3 të Kushtetutës.

Ku qëndrojnë praktikisht këto mangësi subjektive të stafit përbarimor, veçanërisht të karakterit profesional, gjatë procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë?

Në shumë raste, si nga gjykatat ashtu edhe nga përbaruesit, nuk ka koncept të saktë juridiko-procedural për vendimin gjyqësor të formës së prerë, si titull ekzekutiv, parashikuar në pikën "a" të Nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë, shpesh vlerësohen si tituj ekzekutiv dhe për ta lëshohet nga gjykata edhe Urdhëri i Ekzekutimit për Zyrën e Përbarimit. Nuk është e vërtetë që të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë që kanë zgjidhur një çështje në themel, janë tituj ekzekutivë. Tituj ekzekutivë janë vetëm ato vendime gjyqësore të formës së prerë që janë detyruese, të tilla si: "detyrimin e prishjes së murit", "lirimimin e banesës", "detyrimin e kthimit të një shume të hollash", "detyrimin për kthimin në vendin e mëparshëm të punës", "detyrimin e takimit çdo të shtunë me fëmijën", "detyrimin e pagimit të pensionit", etj, etj.

Vendimet e vërtetimit gjyqësor të faktit juridik, paditë e njohjes, vendimet gjyqësore të anulimit të akteve administrative, etj, nga vetë natyra e tyre janë vendime deklarative dhe mund të shërbejnë në disa raste, si bazë për dhënien më vonë të një vendimi gjyqësor detyrimi. Më paradoksale janë lëshimet e Urdhërave të Ekzekutimit nga gjykatat, për vendimet gjyqësore të formës së prerë, ku është vendosur rrëzimi i padisë. Është e çuditshme të mendosh, se çfarë do të ekzekutojë përbaruesi në kësi rastesh, kur marrëdhënia juridike që është kërkuar të krijohet, ndryshohet apo të shuhet nëpërmjet gjykimit, nuk është pranuar; e thënë ndryshe: kur palët janë në të njëjtën gjendje juridike, në relacion me njëri-tjetrin, sikur të mos ishte ngritur padia.

Këto praktika gjyqësore të gabuara, përveç se janë tregues, në rradhë të parë, të mangësive të formimit profesional të gjyqtarëve përkatës, problem që nuk është objekt i kësaj Konference, por edhe shtojnë artificialisht sasinë e dosjeve përbarimore. Neve sot na intereson praktikisht pjesa që i takon Zyrës së Përbarimit. Si duhet të veprojnë në këto raste përbaruesi kur ka një Urdhër Ekzekutimi për rrëzimin e padisë? Duhet t'a mbajë në duar pa ditur se ç'të bëjë



me të, apo duhet të ndërmarrë veprime të bazuara në ligj për të zgjidhur gabime të tilla të praktikës gjyqësore?

Përmbartuesi nuk mund të vendosë mos pranimin e këtij Urdhëri, pasi vlerësimi i bazueshmërisë në ligj i vendimit gjyqësor (Urdhëri i Ekzekutimit) nuk është atribut i tij, por i një gjykate më të lartë se ajo që e ka dhënë. Prandaj përmbartuesi do t'a rregjistrojë kërkesën dhe do hapë dosje përmbartimore. Por nuk do të kryejë asnjë veprim, me përjashtim të marrjes së vendimit për të refuzuar veprimet, në bazë të Nenit 610 të K.Pr.Civile. Në këtë mënyrë i hapet rruga ankimit në gjykatë, nga e cila kërkohet edhe pezullimi i ekzekutimit deri në përfundim të gjykimit. Por nga ana tjetër mund të udhëzohet debitorit të kërkojë në rrugë gjyqësore pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, bazuar në Nenin 609 të K.Pr.Civile.

Probleme ka edhe në ato raste, që nuk janë të pakta, kur vendimet gjyqësore të formës së prerë kanë mangësi të tilla që praktikisht nuk mund të ekzekutohen, p.sh. :

a. Në to nuk janë përcaktuar sipërfaqet e tokave të liruara, kufijtë, shumat që detyrohen për t'u kthyer, masa totale e pagës që punëdhënësi debitor detyrohet t'i kthejë të larguarit nga puna e të tjera pasaktësi.

Vihet re që përmbartuesi, në vend që t'a udhëzojë kreditorin që të bëjë në gjykatën kompetente ndreqjen e gabimeve, plotësimin ose sqarimin dhe interpretimin e vendimit (nenet 312, 313, 313 të K.Pr.C.) bën veprime në "boshllëk" që vetëm zvarrisin ekzekutimin, ose çojnë në konsumimin e afateve të ankimit, duke e parashkruar atë. Ka ndodhur që edhe të ekzekutohen këto vendime gjyqësore, megjithë mangësitë e tyre të sipërpërmendura, duke çuar në tejkalim ose zvogëlim të detyrimit konkret të gjykuar.

b. Në rastet kur debitorit është person juridik që faktikisht është shpërndarë ose ka falimentuar. (Neni 592 i K.Pr.C.)

Në këto raste zakonisht përmbartuesi vendos pezullimin e çështjes dhe e lë ashtu pambarimisht. Vërtet në këto raste, pika "c" e K.Pr.C., parashikon pezullimin, por kjo masë merret që kreditorit t'i jepet koha e duhur për të bërë zëvendësimin e debitorit me personin të cilit i kanë kaluar ligjërisht të drejtat dhe detyrimet. Kështu në Zyrën e Përmbartimit Vlorë vazhdojnë që këtë disa çështje të tilla ndaj debitorit, ish N.B. Kote, e cila prej vitesh nuk ekziston. Prandaj



nënvizova më lart domosdoshmërinë e njohjes së mirë të ligjit material civil nga përmbartuesi, i cili të jetë i aftë profesionalisht të zgjidhë edhe këto situata.

Duhen përmendur edhe rastet kur përmbartuesit gjyqësorë e pushojnë ose pezullojnë çështjen përmbartimore në kundërshtim me dispozitat përkatëse të K.Pr.Civile. Kështu në çështjen përmbartimore që i takon kreditores Z.H. përmbartuesi gjyqësor pasi ka konkluduar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, ku urdhërohet detyrimi i debitorit të sigurojë një distancë prej 2 metrash të themeleve të ndërtimit të tij nga banesa e kreditores, nuk mund të ekzekutohet pasi prishja e themelit rrezikon shembjen e shtëpisë tjetër, të kreditores, vendos pushimin e çështjes. Ky rast nuk mund të pushohej, pasi nuk parashikohet në asnjë nga pesë rastet e parashikuara në Nenin 616 të K.Pr.C. për pushimin e ekzekutimit. Mendimi ynë për rastin në fjalë, bërë të ditur me shkrim Zyrës së Përmbartimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, ka qene se: "...sugjerojmë që rastin konkret, (që) Zyra e Përmbartimit t'a diskutojë me Drejtorinë e Përgjithshme për t'i dhënë zgjidhje ligjore, pasi vendimin e pushimit ...e vlerësojmë si jo të rregullt. Mund të shikohet hapësira e Nenit 610 të K.Pr.C. ku përmbartuesi mbi bazën e mendimit të ekspertëve, të marrë vendim për refuzimin e kryerjes së veprimeve konkrete, duke i hapur kështu rrugë nëpërmjet ankimit të kreditorit shqyrtimit gjyqësor ku do të hetohen pasojat që mund të vijnë nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv, dhe me vendimin e saj gjykata do të urdhëronte veprimet konkrete që duhen kryer".

Më shumë çështje pushohen për pamundësi të gjetjes së pasurisë së debitorit, të insovabilitetit të tij, por që nga dokumentacioni që përmban dosja përmbartimore nuk të bind, pasi në të mungojnë aktet verifikuese për gjetjen e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme si nga ZRPP, nga zyrat e taksë-tatimeve, nga bankat e nivelit të dytë, nga organet përkatëse të qarkullimit rrugor për pasjen e mjeteve motorrike, etj. Ka edhe raste kur pushimi i çështjes bëhet duke ju referuar Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor", që është një ligj organik dhe jo proçedural.

E drejta jonë proçeduriale në fazën e ekzekutimit, u njeh palëve në proçes që të mbrohen nga veprimet e padrejta të përmbartuesit, si



dhe për të ndrequr gabimet që mund të bëhen gjatë kësaj faze. Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve janë parashikuar në nenin 609, pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, neni 610, kundërshtimi i veprimeve të përbaruesit gjyqësor e neni 612 i K.Pr.Civile, padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë. Problemi i njoftimeve të akteve është problem i vjetër, si për gjyqësorin, ashtu edhe për sistemin përbarimor, megjithë përmirësimet e bëra. Kjo për shkak të mos respektimit të dispozitave përkatëse të K.Pr.C. për njoftimet, (nenet 128-144) veçanërisht kur personat nuk gjenden në vend banimin e tyre ose familjarët nuk pranojnë të marrin në dorëzim njoftimin.

Mendoj se mangësitë e të metat në aktivitetin e zyrave të përbarimit, veçanërisht zvarritjet në ekzekutim, vijnë si për shkaqe objektive edhe të karakterit subjektiv paftësi profesionale, shkallë e ulët e përgjegjësisë, moszbatimi i normave procedurale. Dua të theksoj se pjesa e Kodit të Proçedurës Civile që bën fjalë për ekzekutimin e detyrueshëm, pra legjislati i proçedurial civil është i saktë, i zbatueshëm dhe nuk është bërë pengesë, të paktën deri tani, në praktikën e përditshme të zyrave të përbarimit, pavarësisht ndonjë saktësimi që mund të bëhen.

E shikoj të arsyeshme të përforcoj edhe një herë, në kushtet e pranisë së përfaqësuesve të nderuar të organeve të ndryshme shtetërore, qëndrimet e disa segmenteve të Administratës Publike, në tërë vertikalishtin e tyre, në kundërshtim me parimin e ndarjes, balancimit dhe respektimit të pushteteve, për të mos ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Praktika të tilla janë të pakonceptueshme, në kundërshtim të plotë me dispozitat Kushtetuese dhe me pretendimet për ndërtimin e një shteti të të drejtës, dhe që çenojnë rëndë dhe haptazi të drejtat e individit. Më e theksuar ky qëndrim reflektar, është në disa ZRPP që nuk duan të rregjistrojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë për kundërshtimin e vendimeve të KKK të Pronave, në bazë të nenit 27/ a të Ligjit Nr.7698, datë 15.4.1993 "Për Kthimin e Kompensimin e Pronave ish Pronarëve", apo ai i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, që urdhërimin gjyqësor për rimarrjen në punën e mëparshme të kreditorit A.B. nuk e ekzekuton sipas dispozitivit.

Një nga mangësitë kryesore në aktivitetin e Zyrave të Përbarimit, që ka dhënë e jep ndikimin e tij negativ, është mungesa e Rregullores



së Funkcionimit të tyre, detyrim që rrjedh nga pika 2 e Nenit 10 të Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor". Përveç të tjerave, kjo mungesë ka sjellë që të mos ketë uniformitet në dosjet përmbarrimore, nuk janë përcaktuar akoma se cilat duhet të jenë aktet e domosdoshme që duhet të ketë një dosje përmbarrimore, procedurat për të mundësuar kalimin për vazhdimin e ekzekutimit të dosjes nga një përmbarrues tek tjetri brenda të njëjtës zyrë, si do ndërtohen marrëdhëniet përmbarrues-përgjegjës i zyrës, etj. probleme që lindin gjatë praktikës së përditshme.

Duhet rritur më tej përgjegjësia në punën e çdo përmbarruesi, rritja e shkallës së përkushtimit ndaj detyrës, zbatimi e respektimi rigoroz i ligjit. Të gjitha këto do të konvergojnë në rritjen e forcimit e autoritetit të organit, si dhe të respektimit e besimit në opinionin publik. Rrugët për të arritur këtu mund të jenë të ndryshme, por nga më kryesoret janë ridimensionimi i organizimit të punës brenda Zyrës së Përmbarrimit. Duhet të zënë shumë vend seminarët zonale, analizat për zëra të veçantë pune, studimet e përgjithësimet për praktikën përmbarrimore në shkallë rrethi apo më gjerë. Rol përparësor ka kryetari i zyrës, i cili duhet të ketë autoritetin e duhur, shpirtin e veprimit e të kërkesës së llogarisë, sidomos për aftësimin profesional, bazuar këto në akte ligjore e nënligjore.

Për të motivuar më tej punën e përmbarruesit gjyqësor, mund të shikohet mundësia që për ekzekutimin e detyrimeve të veçanta, ose për një vëllim të caktuar çështjesh të ekzekutuara gjatë vitit, përmbarruesi të shpërblehet me shtesë page, të sanksionuar me akte normative.

Të punohet dhe kërkohet për plotësimin e nevojave aktuale të tyre për zyra, me ambiente për mbajtjen e sendeve të sekuestruara, me mjete kancelerie, me makina shkrimi dhe mjete lëvizëse etj, të cilat faktikisht janë të mëdha, por mëse të domosdoshme.

Në këtë parashtrim u cekën disa probleme të aktivitetit të zyrave të përmbarrimit në relacion me ligjin dhe individët, të dala gjatë shqyrtimit të ankimeve adresuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe disa mendime modeste për t'u përmirësuar në të ardhmen.

Pavarësisht që u përqendruam tek disa mangësi të këtyre zyrave, dua të theksoj se sistemi i përmbarrimit gjyqësor, ka në bagazhin e saj shumë shembuj e praktikë të mirë; pavarësisht nga pengesat që ndesh, puna e saj si nga pikëpamja sasiore e cilësore këtë vit është dukshëm shumë më e mirë se vitet paraardhëse.



EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE TË FORMËS SË PRERË NËN KËNDËVËSHTRIMIN E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

NIAZI JAHO

Këshilltar ligjor në Komitetit Shqiptar të Helsinkit

KSHH e ka vlerësuar problemin e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë si një çështje të rëndësishme që ka të bëjë me të drejtën e shtetasve. Është kjo arsyeja që në këtë drejtim janë kryer disa vëzhgime në kuadrin e nismës së shoqërisë civile kundër korrupsionit dhe në zbatim të projektit të mbështetur nga MSI dhe USAID.

Mendojmë se nga pikëpamja ligjore problemi është i qartë: vendimin që ka marrë formë të prerë, gjykata duhet t'ia dërgojë menjëherë prokurorit dhe ky i fundit menjëherë duhet të urdhërojë ekzekutimin e tij.

Gjatë vëzhgimeve¹ tona është konstatuar se në përgjithësi ligji njihet e megjithatë janë vënë re vonesa si në zbardhjen e vendimeve dhe në dërgimin e tyre prokurorive. Vonesa janë vënë re në lëvizje të këtyre vendimeve nga ana e prokurorit. Për ta ilustruar këtë, po jap disa të dhëna që i përkasin vitit 2002. Gjykata e Tiranës ka dhënë 320 vendime penale ndaj personave të arrestuar, 58 vendime me arrest shtëpie, 539 vendime kundër personave të gjykar në gjendje të lirë dhe 76 vendime kundër personave në mungesë.

Sipas nenit 462/5 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i gjykatës vihet në zbatim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë. Në ligjin e vitit 1998 për ekzekutimin e vendimeve penale thuhet se: Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe që nuk janë ankuar ose ushtruar recurs, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi ka marrë formë të prerë. Si janë zbatuar këto dispozita? Afati është respektuar për 273 vendime ndërsa është shkelur në 428 ose përkatësisht përqindja e zbatimit të afateve ligjore është 37.6%, ndërsa e moszbatimit të afateve është 62.4%.

Me interes është analiza e nxjerrjes së urdhërave nga prokurori. Prokurori, sipas ligjit duhet që jo më vonë se 48 orë të dërgojë



urdhërin e ekzekutimit për personat e paraburgosur, ndërsa për personat me gjykim në gjendje të lirë, brenda 72 orëve nga ardhja e vendimit. Nuk e shoh të nevojshme të jap shifra, por fakti është se vonesa ka patur edhe në nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit nga prokurori. Veç kësaj, janë konstatuar shkelje të nenit 465 të K.Pr.P i cili kërkon nga prokurori që në urdhërin e ekzekutimit të përmbajë identitetin e të dënuarit, vendndodhjen e tij, llojin dhe masën e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht, pjesën e dënimit të mbetur, ose neni 463/3 i K.Pr.P ku thuhet se prokurori, pasi bën llogaritjet, nxjerr urdhërin si edhe njofton të dënuarin dhe mbrojtësin e tij.

Gjatë veprimtarisë së KSHH-së janë vënë re gjithashtu raste kur në urdhërin e ekzekutimit që i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk përcaktohet institucioni konkret, gjë që kërkon neni 22 pika 4 i ligjit mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Në këtë drejtim ka munguar bashkëveprimi i dy organeve të mësipërme. Kjo vihet re në mosinformimin nga ana e prokurorit të gjykatës mbi ecurinë e vendimeve edhe në mungesën e nismës nga ana e gjykatës për të konfirmuar ekzekutimin e vendimeve.

Gjatë vëzhgimit ka rezultuar gjithashtu, se një numër i konsiderueshëm të dënuarish me vendim të formës së prerë, janë mbajtur në kushte të paraburgimit nga 1 muaj, deri në 2 vjet, madje midis tyre ka patur edhe të mitur. KSHH për këtë gjendje ka reaguar publikisht dhe ka kërkuar zbatimin e ligjit.

KSHH ka patur parasysh pengesat objektive, por këto pengesa është i detyruar t'i kapërcejë shteti, ndërsa i dënuari ka të drejtë të ngrrejë zërin, të ankohet, për të mos thënë se në raste të veçanta kjo është bërë shkas për të kaluar në veprime të padëshiruara deri edhe në greva urie. Kohët e fundit ky problem, falë ngritjes së burgjeve d.m.th shtimit të kapaciteteve është zbutur por jo eliminuar. Sipas të dhënave të fundit që ka KSHH-ja nga rreth 400 persona me vendim të formës së prerë që qëndronin në paraburgim, numri i tyre ka zbritur në 214 dhe aktualisht në 140.

Lidhur me këtë çështje është diskutuar nëse kanë të drejtë të dënuarit që kanë vazhduar ose vazhdojnë të qëndrojnë në kushtet e paraburgimit, megjithëse ndaj tyre është dhënë vendimi dënim me burgim i formës së prerë që të kërkojnë të çdëmtohen ose t'ju



përllogaritet koha që padrejtësisht kanë qëndruar në paraburgim sipas nenit 57 të Kodit Penal d.m.th. një ditë paraburgim baraz me një ditë e gjysëm burgim.? Kam menduar po e kanë këtë të drejtë.

Janë shfaqur mendime se duhen bërë shtesa apo ndryshime në ligj. Sigurisht kjo do të ishte më e rregullt dhe më e përshtatshme, ndërsa unë kam mendimin se një ankesë e tillë në gjykatë edhe në mungesë të një dispozite të tillë të shprehur duhet të zgjidhej në favorin e ankuesit sepse efektivisht ai ka pësuar , atij i janë shkelur të drejtat dhe nuk do të ishte e drejtë të arsyetohet kur të dalë ligji. Në fund të fundit në ligj janë caktuar afate shumë të shkurtëra për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Gjykata nuk mund të refuzojë kërkesën me arsyetimin se kjo vonesë ka ndodhur për arsye objektive.

Gjatë vëzhgimeve ndonjë nga prokurorët ka ngritur çështjen se si duhet vepruar në ato raste kur gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të të pandehurit ndërsa prokurori e ka apeluar atë, d.m.th. kur vendimi nuk ka marrë formë të prerë - kur ekziston mundësia që Gjykata e Apelit të vendosë ndryshe.

Kam mendimin se vendimi për lirimin e menjëhershëm duhet zbatuar, pavarësisht nga vendimi i Gjykatës së Apelit - ndryshe të gjithë ata që me vendim gjyqësor do të liroheshin duhet të qëndronin në gjendje paraburgimi derisa të shqyrtohej çështja në Gjykatën e Apelit, gjë që do të ishte e kundraligjshme dhe do të cënontë parimin e ligshmërisë dhe të stabilitetit ligjor.

Në bazë të ligjit është shërbimi i Zyrës së Përmbartimit institucioni që realizon ekzekutimin e vendimeve për dënimet me gjobë, megjithëse është prokurori ai që kryen veprimet paraprake dhe lëshon urdhërin e ekzekutimit. Edhe në këtë drejtim vihen re vonesa.

Në përfundim:

- Kam mendimin se afatet për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë mund të zgjatëshin (kuptohet duke bërë ndryshime në ligj).

- Është e nevojshme gjithashtu që neni 22 i ligjit mbi ekzekutimin e vendimeve penale duhet të formulohet në mënyrë të prerë. Në këtë nen parashikohen veprime paraprake të prokurorit, ndërsa



dërgimi i vendimeve penale të formës së prerë duhet të jetë në mënyrë kategorike në kompetencën e gjykatës.

- Dokumentacioni lidhur me rrugën që ndjek ekzekutimi i dënimeve penale mendoj se duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Ai duhet të jetë i kompjuterizuar dhe lehtësisht i kontrollueshëm.

- Ka vend të shikohet edhe problemi i dhënies së dënimeve me gjobë. Jo se nuk duhet të jepen, por në mjaft raste del nevoja që ato të konvertohen ose të mos zbatohen se për arsye të ndryshme nuk gjenden personat.

Një problem tjetër me interes për tu trajtuar është problemi i komisionit të pavarur konsultativ. Sipas ligjit pranë Ministrisë së Drejtësisë të ngrihet dhe të funksionojë një komision i pavarur konsultativ. Ky komision do të shikonte zbatimin e ligjit mbi ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimin e të dënuarve. Ky komision do të shqyrtonte dhe ankesat e ndryshme si dhe do të bënte rekomandime. Ky komision nuk ka funksionuar dhe do të sygjerojë që komisioni të ringrihej se i ka mbaruar mandati. Ministria e Drejtësisë të krijojë kushte për funksionimin e komisionit, ndërsa Këshilli i Ministrave në zbatim të ligjit të vendosë trajtimin e tyre, masën e shpërblimit.

Këto ishin disa nga problemet që menduam të trajtojmë në këtë diskutim.

¹ Këto të dhëna janë mbedhur nga vëzhgimet e kryera nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në kuadër të zbatimit të projektit " Ekzekutimi i vendime penale. Nxitja e frymës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse–element i rëndësishëm për respektimin e të drejtave të shtetasve, mbështetur nga MSI me mbështetjen e USAID-it.



ROLI I POLICISË SË SHPETIT NË PROCESIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE, PROBLEMET DHE PERSPEKTIVAT

Kryekomisar FADIL CANAJ

Zëvendës drejtori i Përgjithshëm

Kjo konferencë organizohet në një kohë kur strukturat e shtetit janë të angazhuara në drejtim të thellimit të reformave ligjore e institucionale që përafrojnë integrimin e vendit tonë në strukturat europiane. Në këtë aspekt vlen të përgëzohen organizatorët e kësaj konference për objektin e zgjedhur në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të individëve.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 142 pika 3 thuhet se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Një detyrim i tillë ngarkon Policinë e Shtetit në ato raste kur kemi të bëjmë me vendime penale të formës së prerë, në të cilat parashikohet si dënim penal me burgim, por dhe dënime plotësuese të parashikuara në Ligjin 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Në këtë ligj krahas procedurave e detyrimeve të organeve të tjera janë parashikuar dhe dispozita që ngarkojnë me detyra policinë, kështu;

* Policia realizon ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji:

- me burgim kur janë gjykuar në gjendje të lirë nga gjykatat;
- ato me gjendje arresti, përderisa sistemi i paraburgimit është në varësi të Ministrisë së Rendit Publik;
- dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 3, 7 dhe 8 të nenit 30 të Kodit Penal;
- mbështet kërkesën e subjekteve të tjera ose me iniciativë, policinë gjyqësore, ushtarake, përmbarimin e subjektet shtetërore.

* Policia kryen dhe ekzekutimin e menjëhershëm parashikuar në nenin 21 të Ligjit “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale”, që bën fjalë për vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të



gjykuarit nga dënimi, ose pushimin e gjykimit të çështjes, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirin e menjëhershëm, për të cilat policia ka realizuar me kohë të gjitha detyrimet ligjore.

- Ekzekutimin e detyrueshëm me burg sipas parashikimit të nenin 25
- Kërkimin e realizuar në bazë të nenit 247 dhe 504 të Kodit Penal që për vitin 2003 deri më sot numri i ekzekutimeve është 703 persona.
- Dërgimin në vendin e vuajtjes së dënimit sipas nenit 26, përderisa sistemi i paraburgimit është në varësi të Ministrisë së Rendit Publik.
- Ndalimi për të drejtuar automjetet sipas nenit 37 i Ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.
- Ndalimin e qëndrimit në një territor të caktuar sipas nenit 38, po aty.
- Nxjerrja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ekzekutim të masës mjeksore neni 45 (ndodhen në gjendje të lirë, por dhe në gjendje arresti).
- Ekzekutim i masës edukuese kur ajo nuk bëhet në mënyrë vullnetare, neni 46.

Si në aspektin ligjor dhe funksional, detyrimet e ngarkuara me ligj, Policia e Shtetit ka qenë e angazhuar tërësisht t’i realizojë në kohë dhe në përputhje me standartet e pranuar nga shteti shqiptar.

Duke iu referuar ekzekutimit të vendimeve penale, me kërkesë të përmbartimit për këtë vit, policia ka qenë e pranishme në mbi 1700 raste.

Vendime të formës së prerë të gjykatës për autorë të veprave penale të gjykuar në gjendje të lirë e të dënuar me burgim janë ekzekutuar 829.

Janë ekzekutuar vendime për mjekim të detyruar e mbyllje të detyruar në institucione të reabilitimit.

Janë ekzekutuar të gjitha vendimet e formës së prerë me burgim të dhëna nga gjykatat në gjendje arresti, si dhe ato të parashikuara në nenin 21 të Ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Duke iu referuar legjislacionit, detyrimeve institucionale të Policisë së Shtetit, problematik është kalimi i plotë i sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, si një detyrim tashmë ligjor.

Masat e marra në zbatim të vendimit të K.M. “Për kalimin e



sistemit të paraburgimit” në kushtet ku sistemi i paraburgimit ndodhet në mjediset e Komisariateve të Policisë dhe e gjithë infrastruktura dhe trajtimi janë si më parë, ka krijuar vështirësi për strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Këto vështirësi kanë bërë që nga ana e tyre të mos zbatohen detyrimet e përbashkëta për kalimin e sistemit të paraburgimit (vetëm si shërbim i brendshëm) brenda 3 mujorit të parë të vitit 2004.?!

Jemi të ndërgjegjshëm se ky kalim i detyruar nuk është zgjidhja për kalimin e sistemit të paraburgimit, por zgjedhja e pranuar e komentit, e cila kërkon të bëhen studime e investime në drejtim të zgjidhjes në afatet optimale.

Një problem me të cilën përballet policia është ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë me burgim. Duke iu referuar të dhënave statistikore për vitin 2003 në ambientet e paraburgimit për mungesë të vendeve në burgje qëndrojnë të burgosur respektivisht nga janari i vitit 2003, 214 deri më 465 vetë, duke rënë me vënien në funksion të burgut të Peqinit në dhjetor në 140 vetë.

Ky fenomen flet për moszbatim sa dhe si duhet i të drejtave të individit (të burgosurve), të cilët vuajtjen e dënimit duhet t’a bëjnë në një nga institucionet e burgimit dhe ai aktualisht një pjesë të dënimit e bën në paraburgim, kur dihet se kushtet nuk janë me ato të burgjeve, por dhe përfitimet në bazë të ligjit nuk realizohen.

E parë në perspektivë ku aktualisht mbi 70 përqind e të dënuarve janë për krime të rënda kundër personit, tendencat e kriminalitetit në Shqipëri dhe infrastrukturën aktuale të burgjeve, ndonëse përmirësimet janë të dukshme në këto 3 vitet e fundit, mungesa e kapaciteteve është problem i cili duhet të vihet në rrugën e zgjidhjes afatmesëm e afatgjatë.

Moskalimi i sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë pengon realisht angazhimin e policisë në reformimin e shërbimeve, kjo nga se ajo është angazhuar në ruajtje, sigurim nga jashtë dhe në shoqërimin në seancat gjyqësore e të paraburgosurve.

Policia ka ekzekutuar të gjitha vendimet penale me burgim për të arrestuarit me qëndrim në ambientet e paraburgimit në varësi të Ministrisë së Rendit Publik.

Vështirësi vërehen në ekzekutimin e vendimeve për mjekimin të detyruar dhe mbylljen e detyruar.

Aktualisht për mbylljen e detyruar, për shkak të mos angazhimit



të Ministrisë së Shëndetësisë në marrjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Shëndetin Mendor, personat qëndrojnë në paraburgim, duke bërë të mundur vetëm mjekim në kushte ambulatorë.

Ky fenomen ka krijuar vështirësi në ambientet e paraburgimit si në trajtimin shëndetësor, por dhe në kushtet e mbajtjes së tyre, duke krijuar shqetësime dhe probleme në personelin e shërbimit, vështirësi në sistemimin e të paraburgosurve të tjerë për shkak të mbingarkesës që krijohet.

Mbajtja e tyre në mjediset e paraburgimit dhe mos trajtimi shëndetësor i specializuar sipas kërkesave të ligjit, përbën shkelje të të drejtave të kësaj kategorie personash.

Krahas problemeve që trajtohen në këtë konferencë kemi dhe mendimin:

1. Ligji ekzistues “Për ekzekutimin e vendimeve penale” duhet të ndryshohet, pasi është para miratimit të Kushtetutës dhe për saktësime të tjera e kompetenca të cilat duhen riparë.

2. Në situatën e mbingarkesave të sistemit të burgimit dhe mbipopullimin e burgjeve, për kundravajtjet penale do të ishte një zgjedhje e mundëshme zëvendësimi i masave të dënimit me burgim me dënime të tjera alternative të parashikuara nga Kodi Penal.

3. Nisur nga ngjarjet e rënda aksidentale me pasoja vdekjen, të ndodhura në fushën e qarkullimit rrugor, do të ishte efektive që gjykatat të kishin dhënë masa dënimi plotësuese të parashikuara në nenin 30 pika 3 (ndalimin për të drejtuar automjet), ashtu edhe për pikën 7 (ndalimin për të qëndruar në një ose disa njësi administrative) të Kodit Penal.

Kjo Konferencë, gjykoj se do t’i japë një shtytje të mëtëjshme problemeve që kanë të bëjnë me kuptimin dhe zbatimin në praktikë të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.



ROLI I PROKURORIT NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE DHE NË MBIKËQYRJEN E VUAJTJES SË DËNIMIT

KUJTIM LULI

Prokuror-Drejtor i Drejtorisë së Studimeve

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm

Në hyrje të referimit tim, dua të falenderoj dhe të përshëndes organizatorët, për iniciativën në organizimin e kësaj Konferencë Kombëtare, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të individit, një temë kjo mjaft aktuale, si për nga rëndësia që ka kjo fazë finale e procedimit penal, ashtu edhe nga problematika dhe shqetësimet që evidentohen, veçanërisht në praktikën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale dhe në mbikëqyrjen e vuarjes së dënimit.

A. Vlerësoj për të nënvizuar se, kuadri ligjorë, Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore kryesore në këtë fushë, në këto 13 vite, kanë sjellë zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm, si në sistemin e drejtësisë penale në përgjithësi, ashtu edhe në këtë fazë të rëndësishme të procedimit penal, në përfaqje me aktet ndërkombëtare të pranura dhe me standartet e sistemit modern penitenciarë, duke ju përgjigjur më në dinamik nevojave dhe kërkesave në rritje për ndryshime dhe reformime në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe vuarjes së dënimit në Shqipëri.

B. Duke u fokusuar tek dënimi penal, do të doja të theksoja se dënimi që duhet të vihet në ekzekutim është një nga format e shtrëngimit shtetërorë, që jepet me vendim të formës së prerë kundër personave fajtor që kanë kryer vepër penale.

Në analizë të thelbit të tij, mund të thuhet se ekzekutimi i vendimeve penale është një ndër hallkat e rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale, që finalizon kontributin e të gjithë aktorëve të këtij sistemi, në arritjen e synimeve:

- * për dhënien e drejtësisë;
- * për të shmangur kategori personash të dënuar nga mundësia e vazhdimit të veprimtarisë kriminale;



- * për të forcuar rendin dhe sigurinë për komunitetin, si dhe;
- * për të riedukuar dhe riintegruar të dënuarit në shoqëri.

Nuk do të kishte asnjë kuptim ndjekja penale që ushtron prokurori në hetimet paraprake dhe në ngritjen e akuzës në gjykatë, si dhe verdikti i gjykatës në të gjitha shkallët e gjykimit për dhënien e drejtësisë, në qoftë se vendimet gjyqësore të formës së prere nuk do të ekzekutoheshin, duke ngelur në sirtarët e organeve të urdhëruara për të kryer ekzekutimin, zyrat e përmbarimit gjyqësor apo të Policisë së Shtetit, ndërsa të dënuarit edhe për krime të rënda, deri dhe me burgim të përjetshëm të lëvizin lirshëm, duke krijuar pasiguri për komunitetin.

C. Në këndvështrimin e prokurorit, do të vlerësoja për të vënë theksin se është shumë i rëndësishëm vendi, roli, detyrat dhe përgjegjësitë e sejcilit aktor që merr pjesë në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe se ushtrimi i funksioneve ligjore dhe forcimi i partneritetit ndërinstucional, mund të jetë çelësi i vetëm i suksesit të tyre.

Prokurori¹, është një ndër aktorët, në cilësinë e promotorrit, në këtë fazë dhe ka detyra e përgjegjësi, për të vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale, duke urdhëruar organet e tjera, për vënien në ekzekutim të vendimit, si dhe për të mbikëqyr vuajtjen e dënimit.

Prokurori dhe të gjithë subjektet e tjerë, që ekzekutojnë vendimet penale, si: gjykata²; organet³ e ngarkuara me ekzekutimin, si: policia gjyqësore e Policisë së Shtetit, Policisë Ushtarake, etj, organet e përmbarimit gjyqësor; organet shtetërore ose subjektet e tjerë juridik shtetërorë ose privat, janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit.

Ata, duhet të njoftojnë prokurorin, për faktet dhe rrethana që ndikojnë në mënyrën dhe kohën e ekzekutimit të një vendimi penal⁴, si dhe për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit të vendimeve⁵.

Subjektet e lartpërmendur që ngarkohen me kryerjen e ekzekutimit të vendimit penal, mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe kur është rasti edhe penale, për mosvënie në ekzekutim, zvarritje ose ekzekutim të vendimit në kundërshtim me ligjin apo në cënim të të drejtave të personit.

Duhet vënë theksi se detyrat dhe përgjegjësitë e prokurorit janë veçanërisht të rëndësishme në këtë fazë. Prokurori, është i detyruar:

- * të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje



me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e ligjit;

- * të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit;
- * të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në

gjykatë:

- * për rivendosjen e ligjit dhe të së drejtës së shkelur, si dhe;
- * për vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë disiplinore deri dhe penale.

1. Në analizën e veprimtarisë praktike që i bëhet përgjegjësive të organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale vlerësoj për të parashtruar disa nënvizime të përgjithshme, siç janë:

* mosnjohja dhe moskuptimi sa e si duhet i ligjit dhe i rëndësisë së kësaj faze të procedimit, veçanarisht nga punonjësit e organeve që urdhërohen të ekzekutojnë vendimet penale, si dhe;

* mosushtrimi i funksioneve dhe moszbatimi me korrektësi i disponimeve ligjore prej tyre,

- në fillimin e ekzekutimit dhe në konfirmimin e vënies në ekzekutim,
- në mbikëqyrjen e ekzekutimit dhe vuajtjes së dënimit, deri dhe heshtje apo pajtim me gjendjen e paligjshmërisë, si dhe;

- në mosvënien e shkaktarëve para përgjegjësisë disiplinore apo penale.

Përmirësimi cilësor i punës nga të gjithë aktorët, përfshi dhe prokurorët, duke forcuar ndihmën dhe kontrollin e tyre, dhe trajnimet e nevojshme, për njohjen, zbatimin dhe unifikimin e praktikës së ekzekutimeve dhe mbikëqyrjes së tyre, si dhe forcimi i partneritetit institucional të tyre, çmoj se do të ishte një rekomandim i vlefshëm, për rritjen në të ardhmen, të efektshmërisë së ekzekutimit të vendimeve penale, në mbrojtje të të drejtave të individit.

D. Mbikëqyrja e ekzekutimit dhe e vuajtjes së dënimit me burgim është një proces shumë i rëndësishëm në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Mbikëqyrja, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore, në këtë fazë është një garanci për respektimin e të drejtave të të dënuarve, trajtimin e tyre me dinjitet, me ndjenjë humane dhe pa njëanshmëri apo diskriminim.

Duke u fokusuar në objektin e këtij referimi, do të theksoja se, prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin⁶ dhe/ose ai në territorin e të cilin ndodhet institucioni⁷, ka detyrimin të mbikëqyr, drejtëpërdrejt dhe pa paralajmërim, ekzekutimin e vendimeve me burgim, zbatimin e



ligjit dhe rregullave në institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

Prokurori, për të ushtruar funksionin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim⁸ përdor disa forma siç mund të jenë:

- * merr dhe shqyrton: informacione, ankesa dhe kërkesa të të dënuarve dhe/ose mbrojtësve të tyre; kërkesa nga persona që kanë statusin e vizitorit; ose të organeve shtetërore apo organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin e vuajtjes së dënimit me burgim;

- * kërkon informacione dhe kryen verifikimeve të drejtpërdrejta në objekte, pajisje dhe mjedise brenda dhe jashtë institucionit, që kanë lidhje me të dënuarit, me ndihmën edhe të specialistëve të fushave të ndryshme;

- * merr dhe verifikon njoftime për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe;

- * merr mendime dhe bashkëpunon me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi.

Për të rivendosur të drejtën e cënuar, prokurori ndërhyr në organet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit me burgim ose në organe të tjera kompetente, duke caktuar dhe afatet përkatëse, si dhe kur nuk ka pengesë ligjore, urdhëron rivendosjen e menjëhershme të ligjit dhe të së drejtës së shkelur. Kërkesa e prokurorit duhet të shqyrtohen detyrimisht nga organi kompetent, i cili duhet ta njoftojë për përfundimin.

Prokurori, gjithashtu, ka të drejtë ti kërkojë drejtorit të institucionit, nisjen e procedimit disiplinor, administrativ apo zhdëmtimin ndaj shkaktarëve, për konstatimet dhe për parregullsitë apo pengesat në drejtim të ushtrimit të funksioneve të tij⁹, si dhe fillon vetë procedimin penal ndaj shkaktarëve në rastet kur shkeljet përbëjnë vepër penale.

Në rastet kur rivendosja e ligjit, rregullit apo e të drejtës së shkelur është në kompetencë të gjykatës, prokurori i paraqitet kërkesë për shqyrtim gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni i vuajtjes së dënimit.

2. Vlerësoj për të nënvizuar, gjithashtu, se mbikëqyrja e prokurorit në ekzekutimin e vendimeve penale me burgim nuk është në nivelin e kërkesave që u theksuan më sipër, në përmbushjen e detyrimeve që ligji e ngarkon me ushtrimin e këtij funksioni.



Do të çmoja si rekomandim të punës sonë për të ardhmen, që prokurorët, më mirë se deri tani, duhet të synojnë përmirësimin cilësorë të punës së tyre në ushtrimin e këtij funksioni të rëndësishëm, duke marrë, rast pas rasti, masat e duhura:

* për të ushtruar kontroll në ekzekutimin e vendimeve, duke siguruar marrjen dijeni për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit, si dhe duke kërkuar informacion, verifikuar dokumentacionin përkatës ose verifikuar periodikisht, të paktën një herë në muaj, drejtpërdrejtë vendin e vuajtjes së dënimit dhe dhomat e paraburgimit;

* për të evidentuar, sipas veprave penale, personat e dënuar me burgim me vendime gjyqësore të formës së prerë të pa ekzekutuara dhe analizuar periodikisht shkaqet dhe përgjegjësit e mosekzekutimit të tyre nga Policia;

* për të kërkuar, në organet e emërtesës, vënien para përgjegjesisë disiplinore dhe administrative, të personave që shkelin ligjet “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe;

* për të vënë para përgjegjesisë penale personat që kryejnë vepra penale në shkelje të të drejtave të të dënuarve.

Krahas prokurorit, do të ftoja aktorët e tjerë të ngarkuar me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale siç janë: gjykata, Komisioni Mbikëqyrës, i cili akoma nuk funksionon, kontrolli i brendshëm, organet e tjera shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse, për të rritur efektshmërinë në ushtrimin e këtij funksioni të rëndësishëm, në mbrojtje të të drejtave të individit.

Të nderuar pjesmarrës,

Veç sa më sipër, në këndvështrimin e prokurorit, do të doja të ndalem, për të vlerësuar e nënvizuar edhe disa nga problemet më kryesore dhe imediate të kuadrit ligjorë, të praktikës gjyqësore dhe të praktikës së ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe të mbikëqyrjes së tij, duke parashtruar edhe disa rekomandime për të përmirësuar më tej në të ardhmen ekzekutimin e vendimeve penale në mbrojtje të të drejtave të individit, si vijojnë:

1. Në nenin 269/2 të K. Pr. Penale, parashikohet se, masa e kompensimit, mënyra e llogaritjes së tij për personat që kryejnë burgim të padrejtë dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen



me ligj të vecantë. Kanë kaluar tetë vjet dhe akoma ligjëvënësi nuk ka plotësuar këtë akt zbatues të këtij parimi.

Nevojë dhe detyrë urgjente mbetet hartimi dhe miratimi i ligjit “Për kompensimin për burgim të padrejtë”, si një ligj i posaçëm që do të rregullonte të gjitha anomalitë e krijura nga mungesa e tij.

2. Në analizë të zbatimit praktik të parimit të ekzekutimit vullnetar nga i dënuari, i cili është i standarteve bashkohore, vlerësohet se nuk funksionon si duhet, për mungesë të infrastrukturës së nevojshme dhe të realitetit në mentalitetin e personave të dënuar, që ashtu si në fazat e tjera të ndjekjes penale, në hetime paraprake dhe në gjykim, përpiqen për t’iu shmangur dënimit dhe për të mos u paraqitur në kohën dhe institucionin e caktuar për vuajtjen e tij.

Rekomandoj ndryshim të ligjit¹⁰, me synim që në nenin 24 të tij, të parashikohet kohëzgjatja maksimale e ekzekutimit vullnetar të dënimit, për të shmangur subjektivizmin në caktimin e këtij afati njoftimi nga organet kompetente.

3. Vlerësoj për të theksuar se jo në pak raste nuk funksionon siç duhet bashkërendimi i prokurorit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në përcaktimin e institucionit ku i dënuari duhet të vuaj dënimin. Në praktikën e urdhërave të ekzekutimit jo rrallë nuk caktohet institucioni konkret i vuajtjes së dënimit, sepse ka raste që prokurorët nuk i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për saktësimin e vendit ku do të vuhet dënimi, ashtu siç ka edhe raste që ky institucion nuk i përgjigjet në kohë dhe me korrektësi kërkesave të prokurorëve, çka krijon vështirësi për organet e urdhëruara për vënien në ekzekutim, në kohë, të vendimeve penale.

Në të ardhmen, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të respektojë kërkesat ligjore, për të konfirmuar institucionin ku i dënuari do të vuaj dënimin, për të lehtësuar zbatimin e vendimeve penale dhe shmangur praktikat në kundërshtim me ligjin.

4. Në analizë të gjendjes së punësimit të të dënuarve vlerësoj për të nënvizuar se të burgosurit nuk kanë mundësi punësimi përveç disa vendeve në shërbimet e pastrimit dhe të mirmbajtjes së burgut, duke përfshirë një numër tepër të kufizuar të dënuarish, si dhe shpërblimi i tyre për punën e kryer është simbolik. Krijimi i mundësive për punë mund të arrihet vetëm nëpërmjet krijimit të ambjenteve të punës jashtë territorit aktual të burgut. Përpjekje të tilla kërkojnë financime,



por çmuj për të nënvizuar se ofrimi i mundësisë për punë, siç p.sh. në bujqësi, është shumë e rëndësishme veçanërisht për të përmirësuar kushtet e të burgosurve që vuajnë dënime të gjata.

Lidhur me punësimin e të dënuarve me burgim, rekomandoj, që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, duhet të programojë dhe kërkoj fonde për krijimin e mundësisë së punësimit në të gjithë burgjet, me synim që cililtdo të burgosur që ka dëshirë, ti japet mundësia për të punuar, duke i realizuar këtë të drejtë të njohur me ligj dhe me aktet ndërkombëtare të pranuar. Gjithashtu, për punët që kryejnë të dënuarit duhet të ngrihet paga mujore ekzistuese e të burgosurve në një nivel më të pranueshëm¹¹.

5. Në praktikën gjyqësore dhe të ekzekutimit të lirit me kusht, vlerësoj për të nënvizuar se, ka raste që drejtuesit e institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim lëshojnë mendime për aplikim të lirit para kohe me kusht, pa arsyetuar dhe argumentuar mirë kërkesat ligjore. Gjithashtu, gjyqtarët e vetëm në disa raste nuk i kushtojnë kujdesin e duhur arsyetimit të vendimeve të lirit para kohe me kusht, për ekzistencën e kriterëve formale dhe materjale të zbatimit të tij.

Ky institut çmuj se mund të aplikohet më shpesh në praktikën e ekzekutimit të dënimeve me burgim, me synim riedukimin dhe riintegrimin e të dënuarve, duke përmirësuar:

* propozimet ose mendimet e drejtorive të institucioneve, të cilët duhet të jenë sa më objektive, në përmbushje të kriterëve formale dhe materjale të aplikimit të këtij instituti;

* shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve, për administrimin në gjykim edhe të dosjes së të dënuarit lidhur me njohjen e ecurisë së vlerësimeve të tij, si dhe për të siguruar pjesmarrja e tij në këtë gjykim, çka do ti shërbentë vlerësimit drejtpërdrejtë të kriterit subjektiv;

* arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për ekzistencën ose mungesën e kriterëve ligjore në pranimin ose rrëzimin e kërkesave të të dënuarve.

6. Gjithashtu, vlerësoj për të theksuar se aplikimi i një politike të drejtë dënimi, caktimi nga gjykata mbi kërkesën e prokurorit, në zbatim të kriterëve ligjore rigorozisht të përcaktuara në Kodin Penal, të alternativave të dënimit me burgim, do të ndikoj pozitivisht në uljen e mbipopullimin të institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe të sistemit të paraburgimit, si dhe në riintegrimin dhe risocializimin e personave të dënuar.



7. Në analizë të kuadrit ligjor dhe praktikës së ekzekutimeve të masave mjekësore, vlerësojmë për të nënvizuar shqetësimin lidhur me trajtimin e personave të papërgjeshëm që kanë kryer vepra penale, ndaj të cilëve është dhënë masë mjekësore nga gjykata, si vijon:

* Ministria e Shëndetësisë, nuk ka akoma institucione mjekësore për trajtimin e përbashkët të dënuarve me masë mjekësore;

* Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, për hartimin dhe miratimin e një Rregulloreje të Përbashkët¹², për masat e sigurimit që duhet të merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen personave me masa mjekësore;

* të burgosurit me masa mjekësore, mbahen në paraburgim pa ndonjë trajtim mjekësor psikiatrik specifik dhe në kushte të papërshtatshme për gjendjen e tyre mendore, etj.

Për këto arsye, çmoj se është e domosdoshme, marrja e masave në afate kohore sa më të shkurtëra:

* nga Ministria e Shëndetësisë, për të siguruar ambjente të përshtatshme për vendosjen e personave të dënuar me masa mjekësore;

* nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë, për hartimin e aktit normativ, Rregullore “Për trajtimin dhe ruajtjen e personave me masa mjekësore”;

* Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, deri në krijimin e një institucioni të posaçëm, të marr masa për të përmirësuar sa më shpejt kushtet e kësaj kategorie pacientësh dhe për transferimin e të dënuarve me masa mjekësore nga dhomat e paraburgimit në spitalin e burgut, për trajtimin e tyre më të denjë dhe human.

8. Në analizë të praktikës së ekzekutimeve vlerësoj për të nënvizuar se në parim, masa edukuese e mbylljes së një të mituri në një institucion edukimi është një masë mjaft e përshtatshme për këtë kategori të vecantë, të miturit, që kërkon trajtim të diferencuar në raport me të rriturit, por praktikishtë evidentohen problemet siç janë:

* masa edukuese nuk jepen nga gjykata sepse aktualisht nuk ka institucione të pavarura dhe të specializuara për zbatimin e masave edukuese;

** të dënuarit minoren e vuajnë dënimin me burgim në burgje që nuk janë posaçërisht të planifikuar për të burgosurit minoren dhe se ato nuk*



janë të vendosur plotësisht të veçuar nga të burgosurit e rritur.

Në këtë vështrim, mendoj që duhet të bëhen propozime për përmirësime dhe ndryshime, si vijojnë:

- * në K. Penal, nenin 46, të caktohen kritere rigorozisht të përcaktuara për dhënien e masës edukuese;

- * është emergjent krijimi i një institucioni edukues të posaçëm, për zbatimin e kësaj mase edukuese;

- * Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të vendosë të burgosurit minorenë në një bllok të veçantë për të garantuar një burgim plotësisht të veçantë nga të rriturit.

Duke përfunduar do të doja të theksoja se:

- * ushtrimi i funksioneve nga prokurorët në përputhje me kërkesat e ligjit,

- * forcimi i partneritetit me aktorë të tjerë që marrin pjesë në këtë fazë të rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale, si dhe;

- * shmangia e eksperiencave negative dhe procedimi disiplinorë, i atyre që shkelin ligjin, **çmoj se:**

- * do të përmirësojë më tej ekzekutimin e vendimeve penale;

- * do të zvogelojë gabimet e mundshme dhe shkeljet e ligjit,

- * duke garantuar të drejtat dhe lirit themelore të individit dhe të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit; si dhe;

- * do të ndikojë në rritjen e besimit:

- * në dhënien e drejtësisë dhe ndaj institucioneve që mbrojnë lirit dhe të drejtat e tyre.

¹ Shih, nenet 463 e vijues të K. Pr. Penale dhe nenet 9, 12, 52 e vijues të ligjit 8331 datë 21. 04. 1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, FZ Nr. 11, viti 1998".

² Shih, nenet 462 i K. Pr. Penale dhe neni 11 e vijues të ligjit 8331.

³ Shih, neni 29,30 e vijues i K. Penal dhe nenet 16, 17, 18 e vijues të ligjit 8331.

⁴ Shih, po aty, neni 10.

⁵ Shih, po aty, neni 20.

⁶ Shih, neni 52/1 i ligjit 8331.

⁷ Shih, neni 68/1 i ligjit 8328.

⁸ Shih, nenin 53 i ligjit 8331 dhe nenin 70 të ligjit 8328.

⁹ Shih, neni 56 i ligjit 8331.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Paga mujore për punët që kryhen në burg është vetëm 90 lekë në muaj e pamjaftueshme për të përballuar nevojat e të dënuarve.

¹² Shih, po aty, neni 42.



EKSPERIENCA DHE NDERHYRJET E AVOKATIT TE POPULLIT NE DREJTIM TE RESPEKTIMIT TE TE DREJTAVE PER TE BURGOSURIT.

HARALLAMB BANO

Institucioni i Avokatit te Popullit

U bë shumë mirë që mbahet kjo konferencë pse jam i sigurtë se ajo do të japi mesazhin e rëndësishëm se nuk është vetëm korrupsioni, një nga sëmundjet që dëmtojnë rëndë drejtësinë tonë. Por në radhë të parë drejtësia çenohet rëndë si rezultat i mosvënies në ekzekutim të vendimeve të marra prej saj.

Po bëhet një periudhë e gjatë kohe, që punonjësit e Zyrës së Avokatit të Popullit në punën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të burgosurve si orientim bazë ka patur nxitjen e Administratës së Burgjeve për të siguruar standarte të larta në punën e tyre për respektimin e paketës ligjore për burgjet.

Qëllimi ynë ka qenë dhe mbetet vendosja e një klime humane brenda burgjeve ku impenjimi kryesor të jetë edukimi dhe kthimi i të dënuarve shoqërisë më të mirë se ç'ishim më parë.

Ashtu si më parë edhe gjatë vitit 2003, stafi i Avokatit të Popullit ka vizituar të gjitha Burgjet që janë në efikasitet, si dhe disa institucione penale në rrethe të ndryshme të vendit.

Gjatë vizitave në këto institucione kemi marrë takim me shumë të burgosur të cilët janë ankuar kundër veprimeve të paligjshme, apo jo të drejta të Administratës së Burgjeve.

Nga analizat e bëra konstatojmë me kënaqësi se mirëbesimi ndaj Avokatit të Popullit i kësaj pjese të popullsisë që jeton në burgje është rritur ndjeshëm. Në përmbushje të misionit, ne përpiqemi që puna dhe sjellja jonë, të jetë në standarte më të larta se ato që kjo zyrë kërkon të vendosë në sektorin publik.

Ne mendojmë se organizimi i Konferencës "Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të individit Neni 142 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka një rëndësi të veçantë për vënien në lëvizje të mekanizmave që kanë zënë ndryshk. Gjetjen e llojit të vajit për t'ja hedhur këtyre



mekanizmave që ato të vihen në punë dhe të sigurojnë arritjen e standarteve të larta në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në përgjithësi dhe vendimeve të formës së prerë me burgim në veçanti. Duke e konsideruar si cënimin më të rëndë që i bëhet drejtësisë shqiptare duke mos vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore puna jonë në këtë drejtim ka patur vëmendjen kryesore.

Zyra jonë nëpërmjet ankesave të të burgosurve është ndeshur në shumë raste me shkeljen e të drejtave të të burgosurve që vijnë si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe që janë objekt i punës së konferencës sonë sot.

Që në fillimet e Institucionit të Avokatit të Popullit ai u ndesh me ankesat e të paraburgosurve si:

1. Për kushte jetese të papërshtatshme në dhomat e izolimit në rang vendi.

2. Për të burgosur që mbaheshin për periudha të gjata kohe në dhomat e izolimit dhe në gjendjen e përshkruar më lart, pasi vendimi i gjykatës kishte marrë formën e prerë.

3. Me ankesat e familjarëve të të burgosurve për të cilët gjykata kishte marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar, të cilët ngritën problemin se ata qëndrojnë më brenda sistemit të burgjeve në mënyrë të kundraligjshme, si dhe nuk kanë asnjë asistencë mjeksore për shëndetin mendor.

Në të gjitha këto raste Zyra jonë ndërmori hetimet e nevojshme nga ku lidhur me gjendjen e dhomave të izolimit doli se:

Gjendja e dhomave të izolimit ishte dhe mbetet nën minimumin jetik të jetesës së njeriut.

Mbipopullimi i vendeve të paraburgimit ishte i pranishëm në pjesën më të madhe të këtyre institucioneve.

Në disa raste mbipopullimi ishte bërë shkak edhe për grindje midis të paraburgosurve.

Higjiena dhe kujdesi shëndetësor linin shumë për të dëshiruar.

Kujdesi shëndetësor edhe sot mbetet formal.

Të miturit mbaheshin së bashku me të rriturit.

Ka munguar avokati që në momentin e arrestimit të tyre.

Takimet me familjarët nuk realizoheshin rregullisht.

Për eliminimin e situatës absurde të krijuar në sistemin e paraburgimit Institucioni i Avokatit të Popullit bëri rekomandimet



përkatëse si dhe hyri në një dialog konstruktiv me Ministrinë e Drejtësisë. Deri sa kohët e fundit me vendim të posaçëm të Qeverisë nr. 327 datë 15.05.2003 "Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë" sistemi i paraburgimit ka kaluar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo tregon për një arritje në drejtimin e duhur, lidhur me standarte më të larta në zbatimin e lirive dhe të drejtave të të dënuarve, por megjithatë mbetet shumë për të bërë deri në zbatimin një për një të kërkesave të vendimit të Qeverisë për kalimin përfundimtar të dhomave të izolimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë (deri tani është marrë vetëm paraburgimi në Komisaratin e Policisë së Vlorës.

Duke e parë si një nga mekanizmat kryesorë në roje të të drejtave dhe lirive të të dënuarve me burgim zyra jonë, ka bërë kujdes dhe vëmendje të veçantë për paketën ligjore për sistemin penitenciar. Nga shqyrtimi i këtij legjislacioni konstatoam se pas një pune serioze dhe voluminoze, ky sistem gradualisht i ishte afruar standarteve ndërkombëtare. Paketa ligjore e sistemit penitenciar ku përfshihen ligji nr.8328 datë 16.04.1998. Për të drejtat dhe Trajtimin e të dënuarve me burgim. Ligji 8321 datë 02.04.1998. Për policinë e Burgjeve me ndryshimet e mëvonëshme Ligji nr.8331 datë 21.04.1998 Për ekzekutimin e vendimeve penale, Rregullorja e Përgjithëshme e Burgjeve miratuar me vendimin nr. 96 datë 09.03.2000, Rregullorja e policisë së Burgjeve si dhe rregulloret e çdo institucioni është një realitet i prekshëm dhe konkret si mekanizma roje që mundësojnë arritjen e standarteve ndërkombëtare në ruajtje të të drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Në këtë kuadër në funksion të detyrës sonë për të bërë propozime për plotësim të ligjit kur shikojmë që është ai, që bëhet shkak për shkeljen e të drejtave të burgosurve apo bëhet pengesë për respektimin e të drejtave apo lirive të tyre zyra jonë ka bërë një sërë rekomandimesh për plotësimin e boshllëqeve në ligj.

Lidhur me përpjekjet tona për të plotësuar paketën ligjore për burgjet si më të rëndësishme po ju paraqesim rekomandimet e mëposhtme:

1. Rekomandimi për plotësimin e Legjislacionit procedural penal. "Per përgatitjen e ligjit për zhdëmtimin e personave të dëmtuar nga veprimtaria e paligjshme apo e parregullt e punonjësve të Administratës



Publike.

2. Rekomandimi për plotësimin e Ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" për nxjerrjen e vendimit të qeverisë "Për shpërblimin e punës së të dënuarve.

3. Rekomandimi "Për plotësimin e kërkesave të Ligjit 8092 datë 03.02.1996 "Për shëndetin mendor, për të nxjerrë Rregulloren "Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar".

4. Rekomandimi për plotësimin e Ligjit 8609 "Për kodin zgjedhor i cili ju mohon praktikisht të dënuarve të drejtën e votimit.

5. Rekomandimi drejtuar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut që të dënuarve që kanë qëndruar në komisarate pas marrjes së vendimit formën e prerë, kjo kohë do t'ju njihet 1 ditë para burgim 1,5 ditë burgim siç parashikon neni 57 i K.Penal.

6. Rekomandimi për krijimin e Këshillit Mbikqyrës për ekzekutimin e vendimeve penale.

7. Për rekomandimin e parë Ministria e Drejtësisë ka bërë projektin përkatës, kurse për rekomandimet e tjera nuk kemi dijeni të jenë bërë hapa konkret.

Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve, të zbulimit dhe korigjimit të shkeljeve të ligjit mendojmë se i ka të qarta objektivat e punës së tij.

Angazhimet dhe përpjekjet tona në verifikimin e ankesave dhe njoftimeve të paraqitura dhe rekomandimet tona për marrjen e masave të menjëherëshme për rivendosjen e të drejtës së shkelur, kanë qenë të mëdha, për këtë kemi mendimin se edhe rezultatet kanë qenë të dukshme.

Para një dhjetorit të vitit në vazhdim 2003 në dhomat e izolimit në gjithë vendin të burgosur që me vendim të formës së prerë qëndronin në dhomat e izolimit kanë qenë rreth 400 persona. Me hapjen e burgut të Peqinit u bë i mundur të brenda një jave pothuajse të gjithë janë zhvendosur nëpër burgje ashtu siç urdhëron ligji.

Po cila ka qenë eksperiencia jonë në lidhje me arritjen e zbatimit të ligjit për këtë kontigjen të dënuarish:

Më konkretisht mbi ankesën e disa të burgosurve për të cilët vendimet e gjykatës kanë marrë formën e prerë zyra jonë, duke parë



se Ligji organik nr.8331 datë 21.04.1998 Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në nenin 50 të tij ka përcaktuar se të paraburgosurit për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë, dhe ata me masë mjeksore vendimet duhet të ekzekutohen brenda 48 orëve, nuk gjente zbatim në praktikën e punës së përditshme, i ka dërguar disa rekomandime Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve duke kërkuar zhvendosjen e këtyre të dënuarve, nga dhomat e izolimit në burgje.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministrisë së Drejtësisë ka marrë angazhimin se do të bënte zhvendosjen e tyre dhe në fakt e ka bërë.

Në shumë raste të veçanta, kur këta të burgosur kanë aplikuar pranë Zyrës sonë ne kemi gjetur gjithmonë mirëkuptimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e cila ka bërë zhvendosjen e tyre kështu ka ndodhur për të dënuarit B.Karameta, R.Mile, A.Fufi etj.

Na duket pozitiv fakti që Zyra jonë mbi ankesën e disa të burgosurve që kanë pretenduar që periudha që kanë qëndruar në dhomat e izolimit t'ju llogaritet 1ditë paraburgim me 1,5 ditë burgim edhe pasi vendimi ka marrë formën e prerë. Pasi pamë se vetë ligji për hyrjen në fuqi të Kodit Penal bëhej pengesë për të fituar këtë të drejtë gjithë të paraburgosurit Zyra jonë kërkoi pranë Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë ndërmarrjen e një inisiative ligjore për të mundësuar fitimin e kësaj të drejte.

Ndonëse problemi i zhvendosjes së të burgosurve të dënuar pothuajse ka marrë zgjidhje mbetet prioritet respektimi i të drejtave të të paraburgosurve për të cilët mendojmë se mbetet shumë për të bërë.

Do të ishte i metë ky diskutim nëse nuk do të paraqisim situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me masë mjekësore të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar si dhe eksperiencën e punës së Zyrës sonë në këtë drejtim.

Familjarët e personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale dhe gjykata ka vendosur masën mjekësore të mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor, kanë bërë ankim në Institucionin e Avokatit të Popullit, duke pretenduar me të drejtë, se të afërmit të tyre, mbahen në Spitalin e Burgut Tiranë për periudha të gjata kohe në kundërshtim me ligjin.

Zyra jonë mbi këtë bazë ndërmori një proces hetim ku rezultoi



se: Në të gjitha rastet që gjykata ka vendosur ndaj të sëmurëve psikikë mjekimin e tyre të detyrueshëm në një institucion mjekësor, këta persona janë dërguar në Spitalin e Burgut. Aktualisht në Spitalin e Burgut ndodhen 35 persona për të cilët është marrë masa e mjekimit të detyruar. Disa prej këtyre personave qëndrojnë në këtë gjendje për periudha të gjata kohe deri në 5 vjet.

Dërgimi i këtyre personave dhe mbajtja e tyre në Spitalin e Burgut Tiranë është haptazi e padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin procedurialo-penal. Në vështrim të nenit 45 të ligjit nr.8331datë 21.04.1998 Masa mjekësore e mjekimit të detyruar ekzekutohet në një institucion mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e Prokurorit.

Për ndërprerjen e shkeljes së ligjit, Zyra jonë ka kërkuar nëpërmjet rekomandimit nxjerrjen e rregullave të përbashkëta ashtu siç e përcakton ligji të dy Ministrive, asaj të Drejtësisë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë për ruajtjen e këtyre personave.

Duke parë se nuk po merreshin masa për hapjen e vendeve për këta të dënuar u kërkuar edhe fillimi i ndjekjeve penale, por Prokuroria vendosi pushimin e hetimeve me arsyetimin se është caktuar që pas trazirave të vitit '97 ky do të jetë vendi ku do të vendosen këta të dënuar. Jemi në ndekje të problemit, pasi në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë kohët e fundit, mbi inisiativën e Kryeministrit është përgatitur një material ku propozohen edhe mënyrat e zgjidhjes së këtij problemi.

Ligji nr.8328 datë 16.04.1999 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim"

Prokuroria dhe gjykata në ekzekutim të vendimeve penale me burgim.

Rregullat për trajtimin e të burgosurve të përcaktuara në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, të plotësuarat tashmë me aktet nënligjore zbatuese sigurojnë zbatimin në çdo kohë të të drejtave dhe lirive të të dënuarve me burgim.

Pjesa e pestë e ligjit "Mbikqyrja në ekzekutim" inkurajon të burgosurit që t'ju sigurohet e drejta për t'i drejtuar prokurorisë ankesat, si një nga të drejtat themelore të tyre. Ligji ka përcaktuar një procedurë, e cila lejon të burgosurin të mund të bëjë ankesa konfidenciale me shkrim apo me gojë një autoriteti të jashtëm të



pavarur nga administrata e burgut siç është Prokurori apo Gjyqtari.

Pra përveç mekanizmave të brendshme, ligji njih gjithashtu mekanizma të jashtme për vëzhgimin, mbikqyrjen dhe inspektimin e administratës së burgjeve, kjo në përputhje me parimin 29 të rregullave standart minimum. Për të mbiquyrur respektimin e ligjit dhe rregullave përkatëse, në burgje ato vizitohen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë, të ngarkuar nga Prokuroria, si një autoritet i ndryshëm nga autoriteti përgjegjës drejtpërsëdrejti për administrimin e vendit të ndalimit ose të burgimit.

Prokuroria si autoritet i jashtëm, për të ushtruar mbikqyrjen në burgje është ngarkuar edhe nga neni 2 i Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë.

Vëzhgimet e bëra dhe praktika e punës së përditshme tregojnë se në këtë drejtim ka boshllëqe të theksuara, që për mendimin tim vijnë kryesisht si rezultat i mosnjohjes së ligjit. Por edhe në ato raste kur ligji njihet, neglizhohet zbatimi i tij.

E ilustruj këtë, me bisedën e bërë me disa prokurorë, të cilët para se të njiheshin me ligjin, "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim", për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim ishin mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit dhe se çfarë bëhej më tej nuk tregonin asnjë interes. Më pas tregojnë ata pasi kemi lexuar me vëmendje ligjin "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" filluam të ngrejmë një farë infrastrukture për të organizuar mbikqyrjen në burgje sepse e ndiejmë përgjegjësinë.

Shikoni çfarë situatë jemi, në një kohë kur prokurori me ligj konsiderohet autoriteti i jashtëm fuqiplotë për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të dënuarve, në shumë raste e gjejmë prapa kangjellave të dyerve të burgut për të marrë leje për të hyrë në burg.

Kush është fajtori edhe këtu po të pyesësh Prokurorinë s'ka fajtor, por kjo ka lidhje me mënyrën e konceptimit të problemit, eksperiencia e vendeve ku jemi mbështetur për hartimin e draftit të ligjit na mëson se pranë çdo burgu, është caktuar një prokuror i ngarkuar posaçërisht për mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, në burgjet e sigurisë së lartë këta prokurorë caktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Po le të shikojmë konkretisht, çfarë e bën të domosdoshëm një organizim dhe një respektim rigoroz të ligjit për ekzekutimin e



vendimeve penale dhe mbikqyrjen e prokurorit në burgje.

Le të marrim vetëm eksperiencën tonë të këtyre viteve duke vënë në dukje gabimet e bëra gjatë ekzekutimit të vendimeve penale, ku në disa raste të dënuarit janë mbajtur në burg me ditë apo muaj tej kohës së përcaktuar në vendimin e gjykatës. Më flagrant ka qenë rasti i të dënuarit E.Dervishi. Prokurori i ngarkuar me këtë çështje duke e parë këtë detyrë me syrin e njerks, pa asnjë lloj përgjegjësie në vend që të vinte në ekzekutim vendimin e gjykatës, ka vënë shënimin të arshivohet.

3 muaj pasi vendimi i dënimit ish kryer E.Dervishi ankohet në Drejtorinë e Burgut 313 se i ka kaluar afati i vuajtjes së dënimit. U desh ndërhyrja e avokatit për të nxjerrë vendimin e arshivuar dhe liruan nga burgu të dënuarin E.Dervishi. Unë mendoj se po të ushtrohej sipas ligjit mbikqyrja e prokurorit në burgje një shkelje e tillë do të ishte kapur në kohë gjatë inspektimeve që ky prokuror duhet të organizojë në burgje dhe jo më të mjaftohet vetëm me nxjerrjen e një urdhëri të ekzekutimit.

Deri para pak kohësh në Prokurori ishte krijuar mendimi se vendimet për ekzekutim duhet që t'i dërgonte vetëm gjykata, kjo për shkak se ecej sipas një praktike të gabuar pa parë ligjin që detyron edhe prokurorin të tërheqi këto vendime. Praktika tregoi se i burgosuri Sh.D nderi në burg tej afatit të dhënë në vendimin e gjykatës për neglizhencë të prokurorit që nuk organizoi punën të tërheqi këtë vendim në gjykatë dhe ta vërë në ekzekutim.

Natyra e ankesave të të dënuarve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale është e shumëllojshme, aty gjen:

1. Ankesa për moszbatim të drejtë të ligjit për amnistinë,
2. Përlllogaritje të gabuara të kohës së vuajtjes së dënimit
3. Përlllogaritje të gabuar të ditëve të punës
4. Diferencime në dhënien e lejeve të dënuarve
5. Marrjen e masave disiplinore arbitrare,
6. Keqtrajtme nga policia e burgjeve etj. e shumë probleme të tjera të cilat janë objekt i punës së prokurorit të ngarkuar me mbikqyrjen në burgje.

Pse janë objekt i punës së prokurorit të ngarkuar për mbikqyrjen në burgje, shumë thjesht, i ka ngarkuar ligji.

Neni 68 i ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me



burgim përcakton:

Ushtrimi i Mbikqyrjes

Zbatimi i ligjit dhe i rregullave në institucionet e vuajtjes së dënimit. Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të të dënuarve mbikqyret nga prokurori i caktuar posaçërisht në prokurorinë e territorit në të cilin ndodhet institucioni. Në burgjet e sigurisë së lartë mbikqyrja bëhet nga prokurorë të autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Në të gjitha kategoritë e institucioneve për zbatimin e ligjit dhe të rregullave përkatëse, të drejtën e kontrollit e ka edhe Këshilli Mbikqyrës, krijuar në bazë të Ligjit "Për vënien në ekzekutim të vendimeve penale. Mbi bazë kërkesë, ankese apo kryesisht ai ka të drejtë të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme dhe mbi bazën e tyre, të kërkojë marrjen e masave nga drejtoria e institucionit, t'i rekomandojë prokurorit ushtrimin e kompetencave ose t'i paraqesë kërkesa drejtpërsëdrejti gjykatës kompetente.

Neni 69 përcakton:

Prokurori duhet të mbikqyrë drejtpërsëdrejti, periodikisht ose pa paralajmërim institucionet e ekzekutimit me burgim, duke u shoqëruar, kur është rasti nga specialistë të fushave përkatëse.

Nuk janë vetëm këto por dhe një varg dispozitash të tjera të ligjit, që ngarkojnë me detyra konkrete prokurorin gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim. Si të tilla mund të përmend nenet 60, 55, 50, 43, 33, 15, 14, 13 etj. të Ligjit "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim".

Se çfarë rëndësie ka roli i prokurorit më lejoni t'ju përmend dy shembuj. Në disa raste të dënuarit me rastin e ngjarjeve si vdekje, martesë, etj. në familjet e tyre i bëjnë kërkesë drejtorit të burgut për t'i dërguar pranë familjes, por çfarë ndodh në shumicën e rasteve këto leje refuzohen. Me ligj i dënuari ka të drejtë t'a ankimojë këtë vendim tek prokurori, por kjo nuk ndodh, pse ligja nuk njihet edhe pse ky rol është inekzistent.

Po kështu ndodh edhe kur një i dënuar i plotëson kushtet për të kaluar nga një kategori burgu në një burg të sigurisë së ulët, i cili bëhet me urdhër të prokurorit.

Një mekanizëm i fuqishëm për drejtimin pozitiv të burgut ligji ka përcaktuar edhe gjykatën, e cila me një politikë të drejtë të paanëshme, profesionale ndikon që të burgosurit t'i kthehen shoqërisë më të mirë se ç'ishin më parë.



Në nenet 71, 72, 73 të ligjit në fjalë është përcaktuar shprehimisht: Gjykata në teritorin e të cilës ndodhet Institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit ose të kërkesës së prokurorit, me përjashtim të rasteve për të cilat në K.Pr.Penale është përcaktuar kompetenca.

Kështu në nenin 63 të Ligjit "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" është përcaktuar në mënyrë eksplicite: Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtarinë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojë një ose disa ulje, deri në 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri në 45 ditë në vit.

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës mbi kërkesën e të dënuarit të prokurorit ose të drejtorit të institucionit, pra ligjvënësi ka vendosur se është e drejtë e gjykatës të ulë dënimin në bazë të Nenit 63 të kësaj ligje, deri në 45 ditë në vit në burgjet e sigurisë së lartë dhe deri në 3 muaj në vit në burgjet e tjera. Po në këtë dispozitë është përcaktuar edhe e drejta e prokurorit të bëjë një kërkesë të tillë, është e qartë besoj se po nuk u ushtrua roli nuk ka se si të zbatohet ligji, që në vetvehte përbën një shkelje të të drejtave dhe lirive të të dënuarve.

Por si zbatohet kjo dispozitë në praktikën e punës së përditshme dhe çfarë probleme kanë dalë lidhur me zbatimin e saj edhe nën dritën e ankesave të të dënuarve për këtë problem.

Disa të dënuar janë ankuar se Gjykata e Rrethit të Burrelit bënte uljen e dënimit vetëm me 45 ditë duke abuzuar me faktin se Burgu i Burrelit është burg i sigurisë së lartë, por çfarë doli pasi u ballafaquan me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë, i cili kishte bërë dy kategorizime një seksion burg të sigurisë së lartë dhe një seksion burg të sigurisë së zakonshme.

Si përfundim zbatimi i ligjit është mekanizëm efikas për të realizuar sa më mirë objektivat e burgut dhe të trajtimit.

Të gjithë personave që u është hequr liria duhet të trajtohen në



mënyrë njerëzore dhe me respekt për dinjitetin e natyrshëm të qënies njerëzore.

Shteti bën shpenzime kolosale për ruajtjen dhe trajtimin e të dënuarve.

Nuk është në interesin e asnjë shteti apo shoqërie që të ketë shërbime apo të mos funksionojnë shërbime që të lëshojnë në shoqëri individë të zemëruar, hakmarrës ose të shqetësuar.

Prandaj është në interesin tonë të veprojmë sa më parë që të kufizohet dëmi që bëhet gjatë burgimit duke vënë në lëvizje të gjitha mekanizmat e caktuara për riintegrimin e të dënuarve.



EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE TË FORMËS SË PRERË NË VENDET E VUAJTJES SË DËNIMIT. PROBLEME DHE PERSPEKTIVA

ARJAN BYLYKBASHI

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Në një system demokratik të bazuar në ligj, ushtrimi i autoritetit karakterizohet nga respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që duhet të garantohet nga një sistem legjislativ që i përgjigjet parimeve të tilla. Në këtë kuadër, organizimi, funksionimi i sistemit të burgjeve merr një pozicion qendror. Në realitet, burgu është vendi ku karakterizohen normat juridike dhe funksionimi i drejtësisë, në një situatë ku filozofia e sistemit të përgjithshëm të shtetit dhe administrimit të drejtësisë dëshmon një realitet të preکشëm që konsiston në privimin e lirisë dhe në mbrojtjen e individit.

Në vitet e fundit, drejtimi i institucioneve të vuajtjes së dënimit është karakterizuar nga dukuria paralele e liberalizimit dhe sofistikutimit të kushteve të regjimit të burgut dhe vështirësitë në rritje të drejtimit praktik. Të dy këto procese janë stimuluar ose penguar nga natyra në ndryshimin e personave në burg, rritja e interesit shoqëror dhe kërkimet shkencore e akademike mbi problemet penale.

Në praktikë, administrata jonë ka arritur të bëjë përpara një hap cilësor në drejtim të respektimit të të drejtave dhe lirive që njeh legjislacioni ynë lidhur me të dënuarit.

Kështu në këndvështrime të tilla esenciale, si: E drejta e kërkesës dhe ankesës, e drejta e informimit, e drejta e korespondencës dhe kontakteve me familjarët, e drejta e mbrojtjes, e drejta e ushtrimit të besimit dhe riteve fetare, e drejta e arsimit, punësimit, ndalimi i përdorimit të dhunës etj, gëzon në realitet nga të gjithë të dënuarit në burgjet tona pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, kombësisë, bindjeve fetare, statusit social-ekonomik dhe pikëpamjeve politike.

Në këndvështrimin e Nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore një rëndësi specifike për vetë nga natyra që trajton



ky ekzekutim ka ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë në vendet e vuajtjes së dënimit.

Ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë në vendet e vuajtjes së dënimit bëhet nga Prokurori nëpërmjet urdhërit të ekzekutimit.

Urdhëri i ekzekutimit i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet. Për shkak të kësaj dinamike, mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë.

Aktualisht, aktiviteti dhe praktika e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të formës së prerë, në vendet e vuajtjes së dënimit bazohet në një paketë ligjesh, dalja e së cilës pati si qëllim, që veç të tjerash, të plotësojnë mungesat e vërejtura në këtë drejtim. Në këtë kuptim, ajo merr një vlerë të veçantë, pasi për herë të parë përdoret një instrument i veçantë legjislativ.

Kjo paketë përbëhet nga:

* Ligji Nr.8328 "Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", pjesa e pestë "Mbikqyrja në ekzekutim".

* Ligji Nr.8331 "Mbi ekzekutimin e vendimeve penale".

* Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

* V.K.M. Nr.63 datë 09.03.2000 në pjesë të veçanta.

Në këto ligje janë të përcaktuara deri në detaje si bëhet ekzekutimi i vendimeve që përmbajnë burgim, ku kufizohen vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë sa e përcakton vendimi penal.

Po kështu përcaktohet ekzekutimi i vendimeve penale për të miturit dhe gratë.

Po kështu përcaktohen afatet e vënies në ekzekutim të vendimit penal të formës së prerë dhe dërgimi i të dënuarit në vendet e vuajtjes së dënimit.

Por zbatimi i këtij ligji në praktikë, ka pasur problemet e veta, kështu po t'i referohemi një situatë para 1 muaji kishim në Komisariate të Policisë rreth 350 të dënuar me vendim të formës së prerë, të cilët vuanin dënimin në Komisariate Policie, duke ju shkelur një të drejtë të rëndësishme të tyre, ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë në vendin e vuajtjes së dënimit.

Kjo gjë e rëndë erdhi si pasojë e mbipopullimit të burgjeve.

Hapja dhe funksionimi i burgut i Peqinit zgjidhën këtë situatë dhe



sot jemi në një situatë premtuese, duke mos pasur asnjë të dënuar me vendim të formës së prerë që të vuajë dënimin në Komisariate Policie.

Praktika e punës në sistemin e burgjeve po evidenton forma të reja të punës me elementë të dënuar e të paraburgosur. Produkt dhe rezultat mbetet efikasiteti i punës së personelit të burgjeve. Në uljen e kriminalitetit në njërën anë, si dhe përpjekjeve të shtetit nga ana tjetër.

Kështu, kërkesat imperative të kohës për një sistem modern të vuajtjes së dënimit, kërkon një reformim tërësor të sistemit të burgjeve, i cili duhet me qëllim ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë në vendet e vuajtjes së dënimit.

Krijimin, ndërtimin dhe përshtatjen e burgjeve me parametra optimale për kushte jetese konformë standarteve evropiane.



EKZEKUTIMI I DENIMEVE PLOTESUESE DHE GJOBAVE NGA ZYRA E PERMBARIMIT

EDMOND ADEMI

Inspektor prane Drejtorise se Pergjigthshme te permbarimit

Në kuadrin e forcimit të shtetit të së drejtës, të forcimit të Institucioneve dhe të organizimit e menaxhimit sa më eficient të tyre, janë ndërmarrë një varg masash për rritjen e shkallës së ekzekutimit, nëpërmjet një reforme të thellë e të detajuar, në bashkëpunim me Ekspertët e Këshillit të Evropës dhe specialistët e Bankës Botërore, duke patur si qëllim të vetëm, kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë, në kalimin nga një mjedis i turbullt dhe me elemente korruptive në një mjedis me hapësira sa më të ngushta, të plotësuar prej vakumit ligjor dhe nënligjor të krijuar më parë, si dhe në një imazh gjithmonë e në rritje të kredibilitetit dhe ndërgjegjesimit të vetë qytetarëve të vlerave që mbart ky institucion, si pjesë integrale e dhënies së drejtësisë.

Edhe ky seminar, mendoj se do të kontribuojë në një mirëkoordinim, respektim të të drejtave dhe bashkëpunim të ndërsjellë nëpërmjet subjekteve që marrin pjesë në këtë natyrë ekzekutimi, për të evidentuar qartë ndërthurjen e kompetencave ndërmjet tyre.

Duke e kuptuar shërbimin përmbarimor si një hallkë të ndërmjetme me misionin e vetëm të ekzekutimit të titujve ekzekutivë e çmoj të rëndësishme të përcaktoj rolin pra të drejtat e secilit subjekt, në këto ekzekutive, bazën ligjore ku mbështeten veprimet e tyre dhe zgjidhjen e problemeve të hasura në praktikë.

Ekzekutimi i vendimeve penale mbështetet në Ligjin me Nr.8331 dt.21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

Në pjesën e parë të këtij ligji parashikohen kuptimi dhe parimet e përgjithshme mbi të drejtat e të dënuarit, me një vendim penal të formës së prerë dhe sanksionohen parimet e barazisë, trajtimit të të miturve dhe grave dhe të drejtave të tjera të parashikuara nga ligji.

Thelbësore në ekzekutimin e këtyre vendimeve është zbatimi i



urdhërimeve që përmban vendimi penal, i cili kufizon vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë sa përcakton vendimi, duke respektuar të drejtat e njohura ligjërish dhe për organet e ekzekutimit përcakton se kanë për detyrë që të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit dhe në të njëjtën kohë mbajnë përgjegjësi disiplinore, por edhe penale për mosvënien, zvarritjen ose ekzekutimin e vendimit në kundërshtim me ligjin apo të drejtat e personit.

Dhe është me vend të përmendim nenin 10 të ligjit mbi detyrimin për njoftimin e fakteve dhe rrethanave, prokurorit, të cilat ndikojnë në mosekzekutimin e vendimit penal, e cila në rast të kundërt përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet më deri në 100 mijë lekë.

Këto parime të përgjithshme zbatohen në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me ekzekutimin e një vendimi penal dhe kryesisht duke i referuar objektit të këtij seminary edhe ekzekutimit të vendimeve të parashikuara në Kreun III të këtij Ligji “Ekzekutimi i vendimeve me gjobë”.

Në nenin 17 të këtij ligji përcaktohet se “Organet përbarimore ekzekutojnë dënimet me gjobë, dënimet plotësuese të parashikuar nga pika 2 e nenit 30 dhe nenit 63 të Kodit Penal për shpenzimet gjyqësore, si dhe detyrimin civil të caktuar në vendimin penal.

Vënia në ekzekutim e një vendimi penal me gjobë, bëhet nga prokurori në bazë të urdhërit të ekzekutimit dhe ekzekutimi kryhet nga organi përbarimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari, në bazë të rregullave të Kodit të Proçedurës Civile.

Për ekzekutimin e këtyre vendimeve nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përbarimor Gjyqësor, janë hartuar dhe janë bërë të detyrueshme për zbatim, një sërë modularësh për të unifikuar praktikën përbarimore, mbi të gjitha veprimet e përbaruesit gjyqësor që duhet të ndërmerren dhe që kanë pasur për mbështetje ligjore ligjin e mësipërm, Kodin e Proçedurës Civile, Kodin Civil dhe Ligjin “Për Taksat në Republikën e Shqipërisë”.

Duke i referuar edhe problemeve që kanë dalë gjatë ekzekutimit të këtyre vendimeve, mendojmë se problem përbën kuptimi i ndryshimit të vendbanimit të të dënuarit dhe në ligj kjo rrethanë parashikohet qartë dhe konkretisht:

Në paragrafin III të nenit 32 parashikohet se i dënuari duhet të



njoftojë ndryshimin e vendbanimit dhe ekzekutimi i vendimit transferohet në organin përmbarimor të vendbanimit të ri”, si dhe në paragrafin II të nenit 33, i cili përcakton shprehimisht “Kur nuk respektohen afatet e pagimit ose nuk njoftohet ndryshimi i vendbanimit me kërkesë të prokurorit gjykata e vendit të ekzekutimit vendos zëvendësimin e gjobës së mbetur me burgim sipas Kodit Penal.

Pra si konkluzion: Nga ana e përmbaruesit gjyqësor me konstatimin e faktit të ndryshimit të vendbanimit prej të dënuarit dhe të mosnjoftimit prej tij apo prej përfaqësuesit të tij ligjor apo prokurorit në cilësinë e palës kreditore kur ai është në dijeni, përmbaruesi gjyqësor ka për detyrë të njoftojë prokurorin mbi këto fakte dhe mënyrën e konstatimit të tyre dhe të pushojë ekzekutimin e vendimit me kërkesë të prokurorit, pasi çështja do t’i kalojë gjykatës për zëvendësimin e gjobës me burgim.

Pra prokurori me vënien në dijeni, duhet të kërkojë me kërkesë nga përmbaruesi gjyqësor pushimin e ekzekutimit të dënimit me gjobë dhe të paraqesë para gjykatës, kërkesën për konvertimin e dënimit me burgim.

Një problem tjetër që shfaqet në praktikën e përditshme të Zyrave Përmbarimore në ekzekutimin e vendimeve me gjobë përbën dhe sqarimi i paragrafit I të nenit 33 pra kur ekzekutimi është i pamundur tërësisht apo pjesërisht dhe për këtë fakt duhet të njoftohet përsëri prokurori.

Në këtë pikë të ligjit është parashikuar se prej përmbaruesit gjyqësor duhet të kryhen të gjitha veprimet e parashikuara në Kodin e Proçedurës Civile dhe afatet e parashikuara aty dhe vetëm me konstatimin e pamundësisë likujduese të gjendjes pasurore, duke verifikuar atë në të holla, në sende të luajtshme e të paluajtshme të dilet me vendimin përkatës të parashikuar në nenin 616 të Kodit të Proçedurës Civile dhe të vërë në dijeni palën kreditore pra prokurorin.

Probleme të tjera që dalin në ekzekutimin e këtyre vendimeve janë dhe rasti i konstatimit për debitorin e larguar jashtë shtetit dhe duke mos pasur marrëveshje ndërkombëtare për këtë qëllim është udhëzuar praktikimi i caktimit të përfaqësuesit nëpërmjet kërkesës që bën përmbaruesi gjyqësor në gjykatën e vendit të ekzekutimit.

Pra kontradikta që vihet re në rrugën proçeduriale që do të ndiqet,



në krahasim me sa thamë më lart mbi ndryshimin e vendbanimit e gjen zgjidhjen në Kodin Civil në nenin 12 të tij që përcakton se:

“Një person nuk mund të ketë më shumë se një vendbanim njëkohësisht dhe se banimi është vendi ku personi për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës”.

Dhe meqenëse në nenin 522 të Kodit të Proçedurës Civile parashikohet caktimi i përfaqësuesit ndaj debitorit që nuk i dihet banimi, në varësi të sa përmendëm më lart nga ana e përbaruesit gjyqësor gjen zgjidhje si më efektive dhe e bazuar më lart, qëndrimi i përbaruesit për njofimin e prokurorit dhe të pushimit të çështjes me arsyetimin se konstatohet ndryshimi i vendit ku personi qëndron zakonisht apo të shumtën e kohës.

Një problem tjetër është dhe dënimi me gjobë ndaj personave që nuk janë shtetas shqiptarë dhe përsëri mendojmë se konstatimi i përbaruesit gjyqësor për këtë shkak, si dhe konstatimi se personi nuk gjendet në territorin shqiptar (dhe bëhet fjalë kur personi i huaj nuk është publik që të merret leja e Ministrit të Drejtësisë), me njofimin e prokurorit, proçedura ekzekutive e titullit ekzekutiv duhet të pushojë.

c)Përsa i përket mënyrës së mbajtjes së taksës dhe llogaritjes së saj, duke pasur për bazë ligjin në fuqi për sistemin e taksave është arritur të unifikohet praktika nëpërmjet udhëzimit të shpërndarë për këtë qëllim të gjitha zyrave dhe financierëve lokalë, e cila duhet të llogaritet mbi bazën e masës së gjobës, pasi në ligjin për taksat, kjo gjë nuk përjashtohet dhe kjo gjendet e shprehur në gërmën B në pikat nga 1-5 në Taksat për veprimet dhe shërbimet që kryen nga Administrata Gjyqësore etj.

Natyrisht ky detyrim është i mirëfilltë civil dhe buron nga Ligji për Taksat dhe si i tillë nuk mund të konvertohet kjo vlerë leku me burgim në rast njoftimi të prokurorit dhe pushimit të ekzekutimit.

Detyrimi për pagimin e taksës duke qenë alternative pra i varur nga ekzekutimi i plotë civil i detyrimit të masës së gjobës penale, shuhet në rast të konvertimit të dënimit nga gjykata në burgim dhe përbaruesi gjyqësor me administrimin e këtij vendimi në dosjen përbarimore, pushon ekzekutimin mbi detyrimin e pagimit të



taksës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv me objekt të vleftësueshëm.

Nga organet përbarimore ekzekutohen gjithashtu në zbatim të nenit 40 të Ligjit me Nr.8331 dt.21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" edhe dënimet me konfiskim të mjeteve dhe përfitimeve të rrjedhura nga vepra penale, duke iu referuar vendimit të gjykatës për to dhe duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe duhet thkesuar se duke qenë se prokuroria si organ përfaqëson shtetin edhe veprimet përfundimtare pra të kalimit të shumave të sekuestruara apo të mjeteve, apo të gjobave të ekzekutuara kryhen në favor dhe në llogari të Buxhetit të Shtetit nëpërmjet veprimeve me Degën Lokale të Thesarit.

Objekt ekzekutimi për organet përbarimore janë sipas po të njëjtit ligj dhe nenit 47 të tij, edhe vendimet për masat penale ndaj personave juridikë dhe detyrimi i organit përbarimor është njoftimi i organit financiar ku është rregjistruar personi juridik pra Degën Lokale të Tatim-Taksave dhe Zyrën e Rregjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke ju përmbajtur vendimit të Gjykatës.

Dënimet e tjera plotësuese sipas këtij ligji, me urdhërin e prokurorit ekzekutohen nga vetë organet përgjegjëse, pra subjektit që i drejtohet urdhëri dhe jo nga Zyrat e Përbarimit.

Duke ju falenderuar për vëmendjen shpreh edhe njëherë se ky seminar ndihmon shumë në ndërgjegjësimin dhe rritjen e efikasitetit të veprimtarisë ekzekutuese të shërbimit përbarimor.



PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET E KONFERENCËS KOMBËTARE

"EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË, NË MBROJTJE TË DREJTAVE TË INDIVIDËVE"





Në mbyllje të punimeve të Konferencës, pasi u shqyrtuan dhe u patën në konsideratë të gjitha fjalimet, diskutimet dhe propozimet e pjesëmarrësve, dolëm me këto konstatime dhe përfundime:

1. Organizimi i konferencës lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një detyrim kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve, bëhet në një moment kur ky problem shqetëson një pjesë të mirë të shoqërisë shqiptare dhe si rrjedhojë paraqet një problem serioz para shtetit shqiptar. Prandaj të gjitha institucionet shtetërore shqiptare që lidhen me këtë çështje si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Rendit, Organet e qeverisjes vendore janë të interesuara dhe detyrohen të angazhohen të gjenden zgjidhjet për të minimizuar këtë fenomen negativ. Prandaj dhe Kryeministri me Urdhërin Nr.98 Datë 14.07.2003 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për evidentimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me palë Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe për marrjen e masave për fillimin e ekzekutimit të këtyre vendimeve, të kryesuar nga Zëvendësministri i Financave dhe me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Avokatura e Shtetit. Kjo sepse në shtetin e të drejtës, një element i rëndësishëm i sistemit gjyqësor është ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Duke patur parasysh kërkesat e Konventës Europiane të të drejtave të njeriut dhe në veçanti njohjen që i bën kjo konventë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përfshirë dhe afatet e ekzekutimit, trajtimi i kësaj çështjeje (ekzekutimit të vendimeve) duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e të drejtës për të patur një proces gjyqësor të paanshëm, ashtu siç parashikohet nga Neni 6 i Konventës. Shembull negativ është rasti i çështjes së parë nga Shqipëria që Gjykata e Strasburgut ka pranuar për gjykim, nga ku pritet që shteti shqiptar të dënohet për mosekzekutim të një vendimi të Gjykatës së Tiranës.



2. Dihet se organi i ngarkuar me ligj për ekzekutimin e vendimeve janë përmbaruesit gjyqësor, të cilët duhet që me profesionalizimin dhe përkushtimin e tyre të arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për realizimin e të drejtës së individit. Por përmbaruesi, pothuaj në çdo çështje konkrete ndodhet para disa pengesave dhe presioneve nga të cilat vlen të vihen në dukje:

Trysnia e parë është ajo që transmeton kreditori me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim, i cili pas një stresi dhe kalvari të gjatë seancash gjyqësore për disa vite, shpesh gjykimesh e rigjykimesh në të tre shkallët e gjyqësorit, gjatë të cilave ka konsumuar pjesën më të madhe të durimit, pret ekzekutim sa më të shpejtë të të drejtës së fituar.

Por nga ana tjetër përmbaruesi ndeshet me mungesën e vullnetit të debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të tij. Shpesh ka presione dhe kërcënime, ndërhyrje të personave të ndryshëm, me veprime ose mosveprime që mundohen ta pengojnë atë, duke mos pranuar e njohur vendimin e gjykatës. Rreth 40-50% e vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil që janë në favor të personave që kanë Statusin e Nënpunësit Civil nuk zbatohen. Për fat të keq kjo ndodh edhe me funksionarë të organeve të Administratës Publike, si për mungesë të formimit të tyre juridik, ashtu dhe mos marrjes së mendimit të juristëve të tyre që punojnë pranë tyre. Këta kundërshtojnë veprimet e përmbaruesit, duke patur në shumë raste edhe "ndihmën" e gjykatës që pezullon ekzekutimin, me apo pa të drejtë shpesh atë ditë që ka caktuar përmbaruesi për veprim. Pengesa janë edhe largimi nga vendi i banimit i debitorit, fshehja e pasurisë së luajtëshme e të paluajtëshme me lloj-lloj marifetesh që çojnë në pamundësinë financiare të shlyerjes së detyrimit, etj. Një shmangie sado e vogël e përmbaruesit në fazën e ekzekutimit çon në zgjatjen disa mujore të veprimeve të mëtejshme. Kjo gjendje ka bërë që përmbaruesit të zbatojnë në mjaft raste sanksionet me gjobë ose në rreth 80 raste kallëzimin në prokurori si mjete detyruese.

Shpesh ka edhe vështirësi që dalin gjatë procesit të ekzekutimit, si psh. difektet që përmban vetë dispozitivi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke qenë në kontradiktë llogjike me përmbajtjen e vendimit.



3. Transparenca gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe informimi i personave ndaj të cilave është dhënë një vendim si elementë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në funksionimin dhe vlerësimet e zyrave të përmbartimit, nuk janë në nivelin e duhur. 16.2 % e publikut të intervistuar mendojnë se zyrat e përmbartimit janë transparente, 57.84% thonë se janë disi transparente, ndërsa 21.6% thonë se janë aspak transparente.

4. Korrupsioni është një ndër problemet e ndeshura gjatë ekzekutimit të vendimeve. Nga intervistimi i publikut, 27% e tyre e pranojnë ekzistencën e këtij fenomeni tek përmbartuesit.

5. Situatë e vështirë që është krijuar prej kohësh është ajo për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga entet, organet dhe institucionet buxhetore, me argumentin se mungojnë fondet e duhura. Prej vitesh nuk po gjen zgjidhje ky problem i mprehtë jo vetëm ligjor, por edhe social, i shoqëruar edhe me rënien e besimit ndaj organeve përmbartimore dhe që shpesh sjell edhe situata konfliktuale me të. Në pushtetin vendor situata është më e rëndë. Bashkitë kanë ekzekutuar vetëm 30%, kurse komunat vetëm 20% të shumave që ju detyrohen shtetasve sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Debiti i krijuar ndaj kreditorëve buxhetore është në shuma jo të vogla. Për këtë shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të gjyq-fituesve, shumë struktura shtetërore kanë përgjegjësitë e tyre ligjore. Janë planifikuar 250 milion lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2004, që janë rreth 100 milion më shumë se në vitin 2003, Kjo paraqitet si diçka pozitive në këtë proces.

6. Në dosjet përmbartimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore rezultojnë shtyrje pafundësisht të afateve të ekzekutimit vullnetar të detyrimit. Ka mosveprime edhe kur detyrimet janë në vlera të vogla, sidomos në rastet e detyrimeve për ushqim. Nga anketimi i publikut 69% e të intervistuarve thanë se ekzekutimi i tyre zvarritet 1 muaj deri në 1 vit; 22.4% pohuan se kjo zvarritje ishte prej 1-5 vjet dhe 3.9% e personave të intervistuar thanë se kishin mbi 5 vjet dhe vendimi nuk ishte ekzekutuar ende.



Më flagrante janë rastet kur nga kqyrja e dosjeve përbarimore gjatë procesit të verifikimit të ankesave, del se është vendosur pushimi i ekzekutimit për pamundësi pagimi ose të mos gjetjes të pasurive të debitorit, pa bërë verifikime dhe pa patur asnjë konfirmim zyrtar, nga Zyrat e Taksë-Tatimeve, nga Bankat e nivelit të dytë, apo organe të tjera nga ku mund të merren të dhëna të sakta për pasurinë e luajtëshme e të palujtëshme që mund të ketë debitori.

7. Problematike paraqitet edhe situata lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj personave juridikë e fizikë privatë. Rreth 90.6% e të intervistuarve pranojnë se kanë ndeshur pengesa për ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj personave fizikë e juridikë privatë. Vështirësitë në më të shumtën e rasteve kanë qenë për shkak të mungesës së të ardhurave dhe pasurive të këtyre të fundit, ndërkohë që dhe mungesa e të dhënave rreth adresës së saktë të debitorëve është mjaft problem gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Kjo e fundit përbën një detyrim për gjykatën që në vendimin e dhënë prej saj të jepin saktë gjeneralitetet dhe adresa e saktë e te debitorit apo të dënuarit.

8. Nga të dhënat e anketimit të përbaruesve paraqitet problematik niveli jo i kënaqshëm i bashkëpunimit midis organit përbarimor dhe organeve të tjera të Administratës Shtetërore dhe Publike. Kjo situatë dëmton tepër punën, duke patur parasysh se në shumicën dërrmuese të rasteve debitorë janë pikërisht këto organe. Në antitezë me këto rezulton se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë janë në nivele të kënaqshme.

9. Institucioni i Avokatit të Popullit që në fillimet e punës së tij, si dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kanë patur në vëmendje trajtimin e problemit të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë. Nuk kanë qenë të pakta rastet kur qytetarë të ndryshëm me vendime të gjykatave të formës së prerë janë ankuar për këtë ose atë organ të administratës, që shpërfill vendimin e dhënë nga gjykata, duke mos e ekzekutuar atë dhe duke shkelur kështu në mënyrë flagrante të drejtën e qytetarit të garantuar nga Neni 143 i



Kushtetutës dhe akte të tjera ligjore. Qysh në vitin 2001, Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Ministrit të Financave dhe atij të Drejtësisë, për marrjen e masave për nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton VKM nr.335, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit". Ky rekomandim është ngritur në të gjithë raportet vjetore të paraqitura para Parlamentit. Në të njëjtën kohë të dhënat e anketimit të përmbauesve tregojnë se 95.8 % e të intervistuarve e pranojnë dhe evidentojnë si pengesë kontraditat e ligjit me udhëzimet e Ministrisë së Financave si dhe mungesën e fondeve.

10 . Një konstatim tjetër është mungesa e Rregullave të hollësishme për funksionimin e shërbimit përmbaues gjyqësor, detyrim që rrjedh nga pika 2 e Nenit 10 të Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbauesit Gjyqësor". Kjo mungesë ka sjellë që të mos ketë uniformitet në dosjet përmbauese, sepse akoma nuk janë përcaktuar se cilat duhet të jenë aktet e domosdoshme që duhet të ketë një dosje përmbauese, procedurat për të mundësuar kalimin për vazhdimin e ekzekutimit të dosjes nga një përmbaues tek tjetri brenda të njëjtës zyrë, si do ndërtohen marrëdhëniet përmbaues-përgjegjës i zyrës, etj. probleme që lindin gjatë praktikës së përditshme.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, nëpërmjet ankesave të të burgosurve të bëra tek Avokati i Popullit del se shumë raste të shkëlqes së të drejtave të të burgosurve vijnë si rezultat i mosekzekutimit si duhet të vendimeve gjyqësore penale dhe të mungesës së kushteve të përshtatshme në burgjet apo në dhomat e izolimit pranë Komisariateve të policisë.

Ankesat e të paraburgosurve dhe të burgosurve kanë të bëjnë kryesisht me:

1. Kushtet e jetesës janë të papërshtatshme në dhomat e izolimit në të gjithë Komisaritet e Policisë në Shqipëri.
2. Të burgosurit që mbaheshin për periudha të gjata kohe në dhomat e izolimit dhe në gjendjen e përshkruar më lart, pasi vendimi



i gjykatës kishte marrë formën e prerë, për shkak të mungesës së vendeve në burgje. Aq më keq sepse koha që mbahen në këto dhoma nuk ju llogaritet si paraburgim, një ditë e gjysëm dite burgu.

3. Familjet e të burgosurve të sëmurë mendërisht për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar, vazhdojnë të ankohen se ata qëndrojnë brenda sistemit të burgjeve në mënyrë të kundraligjshme, si dhe nuk marrin asistencë mjeksore të duhur për shëndetin mendor.

4. Nuk është ngritur Komisioni Mbikqyrës për ankesat e të burgosurve, i cili duhej të funksiononte qysh në vitin 1999.

5. Nuk përfitojnë sa duhet nga puna që bëjnë në burg për shkak se dispozitat përkatëse janë të vjetra, qysh para vitit 1990.

Për eliminimin e situatës së pakënaqshme të krijuar në sistemin e paraburgimit Institucioni i Avokatit të Popullit bëri rekomandimet përkatëse si dhe hyri në një dialog konstruktiv me Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu herë pas here Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka treguar publikisht si dhe i është drejtuar me rekomandime Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë Shqiptare, duke kërkuar përgatitjen e bazës ligjore për pagesën e punës së të dënuarve.

Mbi bazën e përfundimeve të mësipërme Konferenca doli me këto rekomandime:

1. Situata aktuale lidhur me ekzekutimet e vendimeve gjyqësore cënon rëndë parimet e shtetit të së drejtës dhe në veçanti të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të mbrojtura si nga Kushtetuta Shqiptare, ashtu dhe nga të gjitha Konventat dhe normat e tjera ndërkombëtare të pranura nga Republika e Shqipërisë. Prandaj nevojitet krijimi i një koncepti më të drejtë lidhur me domosdoshmërinë e zbatimit në çdo rast dhe pa asnjë kusht të vendimeve gjyqësore nga çdo autoritet apo organ i Administratës Publike.



2. Të punohet sa më shpejt për plotësimin dhe përsosjen e legjislacionit dhe në veçanti të akteve nënligjore të nevojshme në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë rast duhet të mbahet parasysh përputhja e këtyre të fundit me Kushtetutën, në mënyrë që individi, i cili pretendon shlyerjen e detyrimit të mos ndihet i diskriminuar në raport me organin e administratës.

3. Nga Ministria e Financave duhet të qartësohet situata në lidhje me faktin, nëse ky organ duhet të nxjerrë udhëzime të përbashkët me Ministrin e Drejtësisë për vendosjen e kriterëve dhe procedurave për zbatimin e vendimeve gjyqësore që përballohen nga buxheti i vetë institucionit. Ky detyrim rrjedh nga VKM Nr.355 datë 2.6.1998, i cili ende nuk është përmbushur, apo duhet që në zbatim të Nenit 589 të K.Pr. Civile, Ministri i Financave duhet të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimeve në të holla të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.

Roli i Ministrisë së Financave për të mbrojtur buxhetin me akte nënligjore nuk duhet të çenojë Kushtetutën që parashikon që vendimet gjyqësore janë detyrimsht të zbatueshme. Aktet e Ministrisë së Financave duhet të parashikojnë kriteret dhe procedurat që duhet të respektohen nga organet buxhetore përkatëse, të cilët nuk mund të gjykojnë në lidhje me bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore. Vetëm në këtë mënyrë do të rritet transparenca e organeve në këtë proces dhe do të eliminohen në maksimum elementet korruptive.

4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga 85 Komunitet të deklaruar të varfra me Vendim të Këshillit të Ministrave mund të bëhet i mundur duke u bërë buxheti i tyre drejtëpërdrejtë nga buxheti i shtetit nëpërmjet akordimit të fondeve për këtë qëllim. Vetëm në këtë mënyrë mund të bëhet i mundur ekzekutimi i vendimeve nga këto të fundit.

5. Duhet rritur më tej përgjegjësia në punën e çdo përbaruesi, rritja e shkallës së përkushtimit ndaj detyrës, zbatimi e respektimi rigoroz i ligjit. Të gjitha këto do të konvergojnë në rritjen e forcimit të autoritetit të organit, si dhe të respektimit e besimit në opinionin



publik. Rugët për të arritur këtu mund të jenë të ndryshme, por nga më kryesoret janë ridimensionimi i organizimit të punës brenda Zyrës së Përmbartimit. Duhet të zënë shumë vend seminarët zonale, analizat për zëra të veçantë pune, studimet e përgjithësimet për praktikën përmbartimore në shkallë rrethi apo më gjerë. Rol kryesor ka Kryetari i zyrës, i cili duhet të ketë autoritetin e duhur, shpirtin e veprimit e të kërkesës së llogarisë, sidomos për aftësimin profesional të punonjësve të shërbimit përmbartimor.

6. Gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përmbartuesit gjyqësorë duhet të kenë parasysh zbatimin në të njëjtën kohë dhe të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, sidomos respektimit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve për pension ushqimor dhe të drejtës për takim. Ka jo pak raste kur me veprimet e tyre përmbartuesit i cënojnë këto të drejta. Në këto kushte nevojitet një sensibilizim i strukturave kompetente në drejtim të respektimit të të drejtave themelore të individit, dhe në veçanti të fëmijëve, mbrojtja e interesave të të cilëve nga ligji duhet të jetë në nivele të larta. Në ekzekutimet e vendimeve rreth konflikteve familjare duhet studjuar gjithashtu nevoja e pranisë së punonjësit social për problemet familjare

7. Për të motivuar më tej punën e përmbartuesit gjyqësor, mund të shikohet mundësia që për ekzekutimin e detyrimeve të veçanta, ose për një vëllim të caktuar çështjesh të ekzekutuara gjatë vitit, përmbartuesi të shpërblehet me shtesë page. Ministria e Drejtësisë mund të studiojë e të paraqesë aktet e nevojshme nënligjore.

8. Për realizimin me sukses të detyrës së tyre përmbartuesit gjyqësorë duhet të kenë infrastrukturën e nevojshme, pasi 89.6% e të intervistuarve mendojnë se nuk e kanë këtë gjë, ndërsa 81.3% mendojnë se mungesa e saj ul shpejtësinë dhe cilësinë e punës së tyre. Të punohet për plotësimin e nevojave aktuale të tyre për zyra, me ambiente për mbajtjen e sendeve të sekuestruara, me kanceleri, kompjutera dhe mjete lëvizëse etj, të cilat janë mëse të domosdoshme.



9. Gjykatat shqiptare duhet të kenë më mirë parasysh që në vendimet e tyre të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara nga ligji lidhur me gjeneralitetet e personave debitorë apo të dënuar, adresat e sakta të tyre, me qëllim që të mundësohet ekzekutimi i vendimeve të ndryshme gjyqesore.

10. Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, kryesisht për transferimin e të dënuarve nga vendet e paraburgimit në burgje, është e nevojshme që të përshpejtohet procesi që ka filluar dhe të respektohet grafiku i këtij transferimi siç është caktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave. Gjithashtu nevojitet që Ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale" të përmirësohet duke përcaktuar qartë dhe saktë afatet e transferimit, kurse për personat, të cilët kanë vuajtur dënimin në paraburgim, t'u përlogaritet dënimi i vuajtur 1 ditë paraburgim baraz me 1.5 ditë burg.

11. Ministria e Drejtësisë duhet të përgatisë projektligjet dhe aktet nënligjore për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim. Gjithashtu të marrë masa për të vënë në funksionim Komisionin Mbikqyrës për ekzekutimin e vendimeve me burgim dhe të përgatite vendimin për shpërblimin e punës së të dënuarve sipas kushteve të reja.

12. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë të marrin masa për trajtimin e personave të sëmurë psikik të cilët mbahen padrejtësisht në spitalin e burgut ose në komisariate, për në institucione të posaçme, të veçanta nga burgjet.

13. Prokuroritë e rretheve duhet të kryejnë më mirë detyrën e tyre e të kontrollojnë me rigorozitet ekzekutimin e vendimeve penale si dhe të vënë më shumë para përgjegjësisë penale ata punonjës të organeve përgjegjës, të cilët shkelin ligjet dhe pengojnë për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore.



AVOKATI I POPULLIT

KONFERENCA KOMBETARE
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQESORE
TE FORMES SE PRERE
NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE
TE INDIVIDIVE

© copyright AVOKATI I POPULLIT 2004

Adresa:

Blv. "Dëshmorët e kombit. nr. 3 -
Tiranë - SHQIPËRI

Tel: ++ 355 4 232 462

Fax: ++ 355 4 226 095

E mail: ap@avokatipopullit.gov.al